



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 10 QERSHOR 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
10. JUNA 2010. GODINE**

**QERSHOR -JUNI
2010**

E enjte, 10 qershor 2010, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj në sallë janë të pranishëm 67 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me shefat e grupeve parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, ne sot duhet ta kemi edhe një pikë shtesë, pas pyetjeve parlamentare: Ratifikimi i Marrëveshjes së nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim për financimin e Projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e Projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër.

Shkojmë me një votim formal. Kush është “për”? Faleminderit!

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Ju njoftoj se në bazë të nenit 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi i deputetëve deri në 3 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar, në 5 minuta.

Në bazë të nenit 47.3, deputetët e lajmëruar dhe të cilët kanë mbetur pa diskutuar, u jepet fjala në fillim të mbledhjes plenare të radhës.

Në seancën e kaluar kanë mbetur pa diskutuar këta deputetë: Gani Geci, Flora Brovina, dhe Gjylnaze Sylja. Nëse donë, ta marrin fjalën!

Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarët e Republikës së Kosovës, po edhe unë si deputet po e kam vështirë për t'i kuptuar deklaratimet e Qeverisë që, në njërin anë thuhet se askush s'është mbi ligjin, ndërsa në anën tjetër krijohen fonde për t'i mbrojtur ata që e kanë shkelur ligjin.

Gjithashtu, dikush po e kërcënon Bashkësinë Ndërkombëtare, por edhe qytetarët e Republikës së Kosovës se nëse arrestohen ata që e kanë shkelur ligjin, mund të destabilizohet Kosova.

Të nderuar,

Populli i Kosovës po kërkon që ata që kanë vjedhur, ata që kanë plaçkitur, ata që kanë reketuar, vendin e kanë në burg.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Populli i Kosovës po kërkon që ata që kanë vrarë, ata që kanë maltretuar, ata që kanë kërcënuar në këto 10 vitet e fundit, vendin e kanë në burg, jo në institucionet e Republikës së Kosovës. Prandaj, nuk do të ketë kurrfarë destabilizimi, ashtu ka thënë edhe kryeministri, ashtu ka thënë edhe presidenti, nëse arrestohen ata që kanë bërë vepra kriminale, asnjëherë, nuk do të ketë as tash.

Të nderuar qytetarë,

Unë në një emision televiziv, ku prezentë ishin profesor Muhamet Mustafa, dhe ministri i Financave, zoti Ahmet Shala, e kam parë, edhe pse nuk jam profesionist në këtë lëmi, që u tha se GDP-ia në Republikën e Kosovës është rritur për 800.000.000 euro, ndërsa në anën tjetër varfëria është rritur 3 deri 4%, gjithashtu edhe papunësia është rritur 3 deri 4%. Doemos dua ta shtroj pyetjen, ku janë paratë, në xhepa të kujt janë, në cilët thasë kanë hyrë, sepse nëse ngrihet GDP-ia dhe qytetari nuk i prek ato para, atëherë doemos shtrohet pyetja se paratë janë diku, kanë hyrë diku, janë në të zezën apo edhe ndoshta kanë shkuar jashtë Kosovës.

Unë, me të drejtë gjatë luftës e kam pas shtruar një çështje shumë të rëndësishme, që hajnat nuk kanë fe as atdhe. Tash kjo po del që hajnat s'kanë as parti politike, sepse edhe partinë politike hajnat e prishin, cilado çoftë ajo.

Unë kam pas thënë atëherë, sepse kam pasur argumente, sepse hajnat i shesin armët që bliheshin për të luftuar armikun. M'i kanë pas shitur edhe mua, por nuk po dua t'i përmend.

Të nderuar qytetarë,

Pas luftës hajnat e bastarduan Ushtrinë Çlirimtare të komandantit legjendar Adem Jashari dhe ne nuk e ngritëm zërin. Ata që e ngritën zërin, i sulmuan

KRYETARI: Flora Brovina, e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Çështja për të cilën do të diskutoj, i nderuar kryetar, i nderuar kryeministër, Qeveri dhe kolegë e kolege, është shënimi i Ditës ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve, që ishte më 1 qershor. Nuk është vonë dhe nuk është asnjëherë asnjë datë e mirëpritur që të diskutojmë për të drejtat e kësaj kategorie më të ndjeshme dhe më të respektuar të popullatës sonë.

Me rastin e 1 qershorit, anembanë Kosovës u mbajtën manifestime të ndryshme, u kënduan këngë dhe u vallëzua, por askush nuk debatoi për pozitën dhe gjendjen e fëmijëve në Kosovë. Përkundrazi, UNICEF-i doli me një raport për varfërinë e fëmijëve, në të cilin u dha një dhënë shumë shqetësuese për të gjithë ne, për institucionet dhe për njerëzit, në përgjithësi për prindërit dhe shoqërinë se 48.6% e popullatës, domethënë të fëmijëve prej moshës 0 deri 19 vjeç, jetojnë në varfëri në Kosovës. Kjo duhet të na shqetësojë.

Në raport theksohen edhe kategoritë më të ndjeshme, e që janë familjet që nuk kanë të punësuar, familjet që jetojnë me asistencë sociale, familjet të cilat kanë nivel të ulët të arsimimit dhe ata që kanë shumë fëmijë. Kosova ka një strukturë të re të popullatës, ku më shumë se gjysma e saj janë fëmijë dhe rini. Kjo strukturë për çdo vend do të ishte një pasuri e madhe edhe kombëtare dhe, natyrisht, çdo shoqëri do të lakmonte një strukturë të tillë. Fëmijët janë e ardhmja e vendit.

Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë ligje jo diskriminuese edhe për të drejtat e fëmijëve, por nuk është debatuar asnjëherë në këtë Kuvend në veçanti për pozitën dhe gjendjen ekonomike të fëmijëve të Kosovës. Këtu vënia në rend dite e kësaj çështjeje në Kuvendin tonë është kërkesë e imja për ju, zoti kryetar, dhe për Kryesinë e Kuvendit.

Interesimi për rritjen, edukimin, shkollimin shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve është një kosto e pakthyeshme për çdo shoqëri. Andaj, kërkoj që ne t'i kushtojmë një vëmendje më të madhe kësaj.

Lufta kundër varfërisë duhet të jetë në rend dite, sidomos lufta kundër varfërisë së fëmijëve. Qytetarët e varfër nuk janë qytetarë të lirë të një vendi....

KRYETARI: Fjalën e ka Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar qeveritarë,

Deputetë të nderuar,

Po filloj së pari me Rregulloren. Kryetar, kjo është koha për deklarime të deputetëve jashtë agjendës dhe jo koha për pyetje parlamentare. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në këtë seancë ngrit një çështje serioze – shkeljen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të ligjeve nga Qeveria.

Dy vite më parë në seancën e 19 qershorit 2008, Kuvendi ka refuzuar kërkesën e Qeverisë për ridestinimin e mjeteve nga projekti kapital – Kompleksi i ri në projektin e renovimit të Pallatit të Mediave në shumën prej afro 7 milionë e gjysmë euro. Po e citoj vendimin e Kuvendit, të cilin e ka lexuar vetë kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi. “Konstatoj se kërkesa për ridestinimin e mjeteve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për investime kapitale nga projekti – Kompleksi i ri qeveritar për projektin e renovimit të Pallatit të Mediave nuk kalon”. Vendimi i Kuvendit është bazuar në fakte serioze lidhur me pronësinë e objektit, sepse sipas ligjit, titullari i pronës shoqërore dihet se është Kuvendi i Kosovës, kurse administrimin e bën Agjencioni.

Po ashtu, ekzistonte kontesti gjyqësor mes kompanisë “Çlirimi” dhe Qeverisë. Vetë ish zëvendësudhëqer i atëhershëm përgjegjës për ndërmarrjet shoqërore dhe ministri aktual, zoti Ahmet Shala, pati kërkuar në emër të AKM-së ndërprerjen e punimeve në objekt, sepse objekti do të privatizohet dhe Qeveria nuk mund të llogariste në këto investime. Përkundër këtyre fakteve të rëndësishme, Qeveria e shkelë vendimin e Kuvendit dhe shpall tenderin në vlerën prej 15 milionë euro, nëse merret parasysh se 2.760.000 euro tjera i janë paguar kompanisë “Çlirimi” si dëmshpërblim për shkeljen e kontratës dhe se procesi i gjykimit nuk është përmbyllur ende, del se renovimi i këtij objekti ka iu kushtuar qytetarëve të Kosovës afër 18 milionë euro.

Po të merret parasysh se vendosja e ministrive në Pallatin e Medies “Rilindja” është e përkohshme, sepse ajo do të privatizohet, dëmi i shkaktuar buxhetit është i madh. Qytetarët e Kuvendit nga ky investim nuk kanë përfutur asgjë, të vetmit të cilët kanë përfutur janë qeveritarët dhe kontraktuesit.

Të nderuar deputetë,

Arroganca, injorimi i vendimeve të institucionit më të lartë të vendit – Kuvendit të Kosovës nga kryeministri dhe ministrat është mosrespektim i sovranit – qytetarëve të Kosovës.

Ky është fakt se Qeveria nuk ka punuar në interes të vendit për çka është zgjedhur. Kërkesa jonë sot është që Kuvendi të mos lejojë të trajtohet me mospërfillje, respektivisht që qytetarët e Kosovës të mos trajtohen me përbuzje nga Qeveria.

Të nderuar deputetë,

Me këtë veprim, Qeveria ka keq qeverisur, sepse ka shkel Kushtetutën e Kosovës, ka...

KRYETARI: Në seancën e kaluar nuk ka qenë e lajmëruar në emër të Grupit, prandaj mund të shkosh në vend!

Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

Sot nuk e ke fjalën në emër të grupit, ju lutem, deputetët e dinë, opinionin që na ka përcjell e di, në emër të grupit në seancën e kaluar deputeti Ardian Gjini e ka shfrytëzuar kohën, ti ke qenë e lajmëruar si deputete dhe, të lutem, shko në vend.

(Gjylnaze Syla, reagim nga salla, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYETARI: Nuk je lajmëruar në emër të grupit, po je lajmëruar në emrin tënd personal.

Tani në emër të grupit është lajmëruar deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Investimet e huaja janë të mirëseardhura dhe besoj se edhe më tutje duhet të punohet për krijimin e një klime të volitshme për investitorët e interesuar qofshin ata vendorë, qofshin të huaj, sepse çon në rritjen ekonomike të vendit. Në këtë drejtim e shoh edhe përrurimin e fillimit të punimeve të depove për karburante të naftës, të cilën e ndërtojnë “Petrol Oti Slovenia” nga Prishtina dhe “Petrol Lubjana”. Në këtë manifestim, siç dihet, mori pjesë edhe ministri për Punë të Jashtme të Sllovenisë, i cili, për fat të keq, nuk pati një përvojë të mirë me pritjen që iu bë nga zyrtarët e lartë të vendit.

Të nderuar kolegë,

Unë me këtë rast dua të shfaqë shqetësimin jo vetëm timin, por të gjithë banorëve të fshatit Miradi e Epërme, vend në të cilin do të ndërtohet depoja për derivate të naftës me kapacitet prej 7000 tonëve, e cila do të paraqes rrezik të përhershëm për jetën e banorëve të atij fshati. Leja për ndërtimin e kësaj depoje është dhënë, nëse është dhënë, në kundërshtim me të gjitha normat e përcaktuara, andaj do të isha shumë i interesuar që të mësojmë se kush e ka lejuar ndërtimin e kësaj depoje vetëm disa dhjetëra metra larg shkollës, i ndanë vetëm rruga, në të cilën mësojnë rreth 300 nxënës dhe në afërsi të shtëpive të banimit. Por, dua t’ua përkujtoj Udhëzimin administrativ për licencimin e subjekteve afariste për tregtinë me gazin e lëngëzuar të naftës dhe të gazrave të tjera.

Neni 17, “Depot për gazra të lëngëzuara dhe rezervarët bartës nuk mund të vendosen në afërsi të objekteve ku banojnë, qëndrojnë apo kalojnë një numër i madh i njerëzve, banesat, shkollat, spitalet, stacionet e të ngjashme, si dhe në hapësirat në të cilat ka rrezik nga vërshimet”.

Shteti është i obliguar që të mbrojë dhe të sigurojë jetët e njerëzve dhe jo t’i rrezikojë ato në çdo moment. Besoj, të gjithë nga ne i kemi akoma të freskëta pamjet nga tragjedia e Gërdecit dhe dikush këtu me qëllim po do të përsërisë një Gërdec të ri. Depoja e tillë jo vetëm që është e rrezikshme për shkak të lirimimit të gazrave që shkakton, por edhe për shkak të mundësisë së përhershme për ndonjë eksplozim.

Në emër të banorëve të fshatit Miradi, kërkoj që të ndërpritet vazhdimi i punimeve dhe depos t'i gjendet një lokacion i cili nuk paraqet rrezik për qytetarin. Përndryshe, në rast të ndonjë tragjedie, dikush duhet të bartë përgjegjësinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tash në emër të grupeve s'kemi të lajmëruar. Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nganjëherë po hamendem të flas apo të mos flas. Për të folur, duhet propozuar që të punojë Qeveria. Kur punon Qeveria, gjithmonë stigmatizohet pse po punon.

I nderuar kryetar,

Brenda harkut kohor prej një muaji në komunën e Malishevës dhe të Rahovecit kanë vdekur 3 qytetarë, në mesin e të cilëve edhe një fëmijë 11 vjeçar nga ethet hemorragjike si pasojë e pickimit të rriqrave. Duhet theksuar se në territorin e këtyre komunave, por edhe në komunën e Klinës, të Suharekës dhe të Drenasit ka me qindra qytetarë të pickuar nga rriqrat dhe disa pacientë thuhet se janë në gjendje kritike. Shkaktarët e etheve hemorragjike në këtë pjesë të Kosovës paraqiten çdo vit dhe thuhet se çdo vit marrin jetëra njerëzish. Duke pasur parasysh këtë fakt, si dhe duke i pasur parasysh përpjekjet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe të infektologëve të Kosovës, të cilët nuk kanë dhënë ndonjë rezultat të madh në preventivë dhe në zvogëlimin e pranisë së rriqrave në këtë pjesë të vendit, unë propozoj që të formohet një grup pune ndërministror nga ministritë e Shëndetësisë, të Bujqësisë dhe Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, i cili në koordinim me institutet shkencore, jo vetëm vendore, por edhe me institutet relevante ndërkombëtare, të trajtojnë seriozisht dhe të hulumtojnë mënyrën e shfarosjes së shkaktarëve të etheve hemorragjike, gjegjësisht të rriqrave, apo sigurimin e masave mbrojtëse. Konsideroj që nuk ka nevojë për ndonjë elaborim apo arsyetim më të gjerë të këtij propozimi, ngase fakti që çdo vit qytetarët e kësaj pjese të vendit tonë ballafaqohen me këtë problem serioz dhe thuaj se tërë stinën e verës e kalojnë në ankth, duhet të na shtyjë që këtë problem të trajtojmë seriozisht dhe mos t'i lëmë vetëm në nivelin lokal. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Ka kohë që tentoj ta ngriti një çështje shumë me interes, e cila ka të bëjë lidhur me shumë dyshime për korrupsionin në Qeveri.

Kryeministri, siç e dimë, tashmë e bëri rikonfigurimin, e bëri riformatizimin e Qeverisë, i ndërroi disa ministra për ta përmirësuar qeverisjen. Po ashtu, zoti kryeministër javën e kaluar deklaroi se ai është prijësi, është komandanti i luftës kundër korrupsionit dhe tha se kishte filluar luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar i pari, shumë përpara EULEX-it.

Por, ajo që kurrë nuk na e shpjegoi zoti kryeministër, është pse i largoi nga posti zotin Idriz Vehapi, zotin Zenun Pajaziti, apo zotin Valton Beqiri dhe të tjerët. Me çka konkretisht ishin korrumpuar ata, sa shumë e kishin menaxhuar apo keqpërdorur paranë publike ministrat e nderuar, sa shumë e patën dëmtuar buxhetin e Kosovës me punën apo mos punën e tyre. Ne, qytetarët e Kosovës ende nuk e kemi të qartë arsyen pse u larguan ata. Sigurisht se, zoti kryeministër, nuk i

ndërruar sa për të thënë, domethënë pa ndonjë arsye të madhe apo veç pse ke mundur, sepse kjo nuk është në stilin e lidershit tuaj. Andaj, arsye tjetër s'ka, pos asaj se ministrat e lartpërmendur u ndërruan për keqmenaxhim dhe keqpërdorim të postit, por po e përsëris, zoti kryeministër, ju asnjëherë nuk na treguat sa keqpërdorën dhe keqmenaxhuan, po them kështu, sepse zoti kryeministër ju jeni i njohur për transparencë, jo vetëm që mbledhjet e Kabinetit qeveritar i mbani para kamerave, por edhe kur jepni me koncesion ndërmarrje publike kryesore, si bie fjala, Aeroportin, këtë e bëni para kamerave. Por, vetëm nuk na dhatë arsyen e ndërrimit të ministrave. Them kështu, sepse arsye tjetër nuk mund të ketë. Bie fjala, në aspektin profesional askush nuk po e vë në dyshim, sepse çdo kush që i përcjell gjërat, e di shumë mirë se, bie fjala, ta marrim zotin Lutfi Hazirin, dihet se zoti Lutfi Haziri është shumë më i ngritur, shumë më i përgatitur profesionalisht në fushën e kulturës dhe të artit se sa zoti Valton Beqiri, këtë çdo kush e di. (qeshje në sallë). Mos qeshni more, as deputetët s'po besojnë! Kështu që, po them, këtu dyshim s'ka. Apo se zoti Blerand Stavileci është më i përgatitur profesionalisht shumë më shumë në fushën e bujqësisë se sa zoti Idriz Vehapi. (po thonë Milka ata mbrapa, xhelozët. E kanë prej xhelozisë, se vet s'janë bërë ministra).

Prandaj, po e shfrytëzoj këtë kohë që mundësisht, zoti kryeministër, si gjithmonë, si komandat i luftës kundër korrupsionit, që jeni, të na tregoni, kuptohet nëse dëshironi, se sa ishin të korrumpuar ministrat e ndërruar dhe sa do të përfitojë Kosova në përgjithësi, pra edhe buxheti i Kosovës nga ndërrimet që i ke bërë? Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Ja sam želeo da izlažem jedno pitanje i u osobno ime, ali i u ime Parlamentarne grupe, koje se tiče jednog pitanja od društvenog značaja. Radi se o Pećkoj Banji i o kompleksu Zavoda za fizikalnu rehabilitaciju ili Instituta za fizikalnu rehabilitaciju. Jedno pitanje kojim se bavimo već više od 5 ili 6 godina i koje nažalost počinje sve više da zastareva i da se marginalizira. Kao što je poznato, Kompleks Pečke Banje je izuzetno važan zato što sadrži četiri hotelska kompleksa, hotel „Oniks“, „Termal“, Stacionar I i hotel „Ilidža“ sa ukupno 37.000 kvadratnih metara i 670 ležajeva. Ono što želim da istaknem sada je da nakon obavljene privatizacije, odnosno proglašene privatizacije 2004 ili 2005. godine, prošlo već 4 - 5 godina i ta vrlo važna kosovska ustanova, koja je od nacionalnog značaja, nema nikakav status. Ljudi su kao čardak, ni na nebu, ni na zemlji, ostalo je 136 radnika koji se tamo snalaze kako znaju u umiju, koji održavaju taj Centar za fizikalnu rehabilitaciju, a njihov status je i dalje nerešen. Bio sam u u prilici da ovih dana razgovaram sa radnicima koji su preostali, tih 136 radnika, da razgovaram takođe sa predstavnicima sindikata ali i da vam iznesem takođe stavove cijele regije i cijeloga Kosova s obzirom da se radi prevashodno o medicinskoj instituciji, a ne turističkoj.

Na osnovu jasnih podataka koji postoje, 70% usluga koje se pružaju u kompleksu hotela u Pećkoj Banji su zdravstvene usluge, ne hotelijerske, 10% su tehničke usluge, samo 20% su hotelijerske usluge. S obzirom da se radi o jednoj ustanovi, kao što rekoh, od nacionalnog značaja koja pruža izvanredne usluge iz oblasti ortopedije, reumatologije, neurologije, dermatologije, smatram da je krajnje vreme da se na ozbiljan način pristupi ovom pitanju jer je, moram to napomenuti, najveći broj tih ljudi koji tamo rade i kosovska javnost velikim djelom su izgubili povjerenje uspešnosti procesa privatizacije, posebno sa aspekta medicinskih ustanova. Verujte da i u tom kraju i na celom Kosovu izlazi kao da bi privatiziranje Pečke Banje bilo gotovo jednako katastrofalno ili dramatično kao privatiziranje Hirurškog bloka ili Bloka za intenzivnu negu i reanimaciju u Kliničkom centru u Prištini. Znači, radi se o jednom vrlo važnom kompleksu i smatram da je krajnje vreme da se obrati pažnja. Ja bih dao i nekoliko

predloga i kao čovjek koji se i sam bavio prije nekoliko godina ovim pitanjem, ali kao građanin Kosova, naravno u dogovoru sa njima, naravno sa podsećanjem da....

KRYETARI: T'i vazhdohen edhe 2 minuta.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti kryetar!

S obzirom da se radi samo o jednom prijedlogu koji bih dao i jednom ozbiljnom predlogu, ja bih ovo želeo da predstavim ne kao polemiku između toga „za“ ili „protiv“ privatizacije, ali bih predložio upravo rukovodiocima vlade, gospodinu premijeru, odgovarajućim ministrima da bi se moglo razmisliti o dva predloga koja bih danas dao. Ja bih zamolio da budno prate i da ovo zabilježe i da pokušaju da primjene. Dakle, imamo loše iskustvo sa privatizacijom i ozbiljno se sumnja da bi ponovljena privatizacija, koja je na redu ovog meseca ili narednog meseca, dala dobre rezultate. Smatramo da bi bilo veoma dobro da vlada uloži određenu količinu novca, najmanje 10 do 20 miliona eura u obavljanje ovog kompleksa, koji je jedinstven možda u ovom djelu Balkana, ima toplu vodu, odnosno termalnu vodu, lekovitu vodu, temperature 49 stepeni koja izvire od 17 litara u jednoj sekundi. I takođe bi moglo se razmisliti oko toga da u okviru procesa decentralizacije stvaranja novih opština, Pećka Banja sa nekoliko sela i naselja koja su okolo bi mogla biti jedna uspešna i održiva mala opština u tom delu Dukadina i Kosova. Hvala vam lepo!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,
Kabinet qeveritar,

Duke pasur parasysh që kjo qeveri ka problem serioz me shtrirjen e kushtetutshmërisë në vend, si dhe kjo qeveri nuk është në gjendje që t'ia garantojë kufijtë shtetëror vendit të vet, sot Lidhja Demokratike e Dardanisë ngrit si çështje urgjente kufirin Kosovë – Mali i Zi. Para dy vitesh, më se 30 fshatrave të Dukagjinit iu ndalohet nga policia e Malit të Zi që të dalin në bjeshkët e veta. Qytetarët e komunës së Pejës dhe të Deçanit pengohen që të shfrytëzojnë bjeshkët e veta me bagëtitë e tyre. Këta qytetarë kanë dalë për 2 vite me radhë në protesta, kanë ngritur këtë çështje duke iu drejtuar edhe Qeverisë, por kjo Qeveri asnjëherë nuk iu është përgjigjur këtyre qytetarëve dhe nuk ka ndërmarrë asgjë. Ne kemi dëshmi se ky territor gjithmonë ka qenë pjesë e Kosovës. Përveç dokumentacionit që dëshmon këtë gjë, atje janë varrezat e familjarëve të këtyre qytetarëve. Duke parë, pra, që kjo Qeveri nuk ka vullnet politik, aftësi..., nuk ka as kredibilitet që të mbrojë as territorin e Kosovës dhe as interesat e këtij populli, kërkojmë, pra nuk mund t'i themi kësaj Qeverie t'i ndihmojë ose të kujdeset për kufijtë, por realisht kërkojmë që kjo Qeveri të shkojë sa më shpejt dhe vendi t'i shpall zgjedhjet e parakohshme. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Përshëndetje, kryetar!

Kolegë të nderuar,

Kryeministër, zëvendësministra, ministra,

Unë sot do ta ngrejë një çështje, sot është dashur që Kuvendi i Kosovës të jetë në ditën e festës në Prizren, më datën 10 qershor, për Ditën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ndërsa ne sot vazhdojmë seancën e rregullt të Kuvendit. Kjo ditë nuk e identifikon Kosovën as Shqipërinë veç e veç, kjo datë, 10 qershor 1878, tregon identitetin tonë shqiptar, tregon burimin e frymëzimit të shtetit shqiptar, por edhe burimin dhe frymëzimin e luftërave për çlirim dhe liri dhe për Kosovën

shtet. Kjo datë duhet të na bashkojë, si në Kosovë, si në Shqipëri, si në Maqedoni, kudo në Ballkan. Por, kjo datë, unë propozoj, duhet të jetë festë e shqiptarëve në Ballkan. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit, edhe prej teje!

Edhe kjo pikë e rendit të ditës u harxhua.

Vazhdojmë me pikën e radhës. Kemi filluar në 10:25 minuta, ora është 10:55 minuta, kështu që ne vazhdojmë me rendin e ditës.

Koha e deklarimeve shkoi.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 27 maj 2010

Pyes, kush ka vërejtje në procesverbal? Nuk ka. Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 27 maj 2010.

Tani kemi pikën:

3. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrajnë më së shumti 2 pyetje, kështu që ata që kanë parashtruar më shumë pyetje, s'mund t'i lexojnë dhe të marrin përgjigje.

Fillojmë. Për shkak se ministri Bajram Rexhepi ka për të udhëtuar, po shkojmë po i lexojmë pyetjet.

(Ndërhyrje e kryeministrit)

Jeni vonuar. Ke kohë, po kemi hyrë në rend të ditës, përndryshe e ke të drejtën të flasësh. Nëse do, merre fjalën! Kryeministri e ka fjalën!

(Reagim nga salla)

KRYETARI: Lexojeni Rregulloren, kryeministri në çdo kohë ka të drejtë ta marrë fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë dëshiroj të theksoj edhe sot para jush të gjithëve, para qytetarëve të Republikës së Kosovës, se periudhës së pavarësisë së mbikëqyrur, siç parashihet nga Plani i presidentit Ahtisari, po i vjen fundi edhe sfida jonë në të ardhmen do të jenë sfida këto për të ecur drejt anëtarësimit edhe në NATO, edhe në Bashkim Evropian, pra në realizimin e aspiratave tona.

Është edhe synim i imi, i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i yni, i përbashkët se gjatë vitit 2010, pas fazës së hershme të pavarësisë, t'i konsolidojmë sukseset e shtetit tonë. Sot Kosova ka ndërtuar kapacitetet e plota, kuptimi politik edhe legjislativ, por edhe ekonomik që të përballlet me implementimin e suksesshëm në bazë të Kushtetutës dhe të ligjeve të veta për implementimin e kriterëve demokratike. Pra, ne do të vazhdojmë të përmirësojmë rritjen ekonomike, duke forcuar sundimin e ligjit dhe në këtë drejtim do t'i dyfishojmë përpjekjet tona dhe pres

bashkëpunim nga të gjithë, nga i gjithë spektri, jo vetëm nga partnerët e koalicionit, por nga i gjithë spektri politik, qytetarët, shoqëria civile dhe mediat.

Ne po ulim pjesëmarrjen e Qeverisë në ekonomi për të stimuluar sektorin privat dhe kjo është edhe arsyeja pse ne po i privatizojmë edhe asetet në KEK, por edhe në PTK. Gjithashtu, kemi përmbyllur me një sukses të jashtëzakonshëm, të paparë në rajonin tonë për transparencë, dhënien me koncesion të Aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës, një ndërmarrje prestigjioze për 20 vitet e ardhshme dhe ky është mesazhi më i mirë që kemi dërguar për biznesin vendor dhe ndërkombëtar se është krijuar atmosferë dhe klimë e besim nga investitorët për të investuar në Republikën e Kosovës.

Duke larguar praktikën e vjetra të qeverisjes, pra ndikimin e Qeverisë në ndërmarrjet publike ne, më në fund, po promovojmë sektorin privat dhe po përqendrohemi në agjendën që duhet ta ketë Qeveria në ndërtimin, forcimin dhe mirë funksionimin e institucioneve demokratike të shtetit tonë.

Gjithashtu, në një transparencë maksimale, projekti i ndërtimit të autostradës Vërmicë – Prizren – Prishtinë në drejtim të Merdarit ka filluar. Edhe pse është një krizë globale ekonomike dhe financiare, ne po realizojmë projektin më madhor me investim mbi 700 milionë euro, që po hapen mbi 4000 vende të reja të punës.

Gjithashtu, jemi të vetëdijshëm për sfidën e madhe, si shtet dhe si shoqëri, si institucione që e kemi për sektorin energjetik. Këtë vit po fillon definitivisht realizimi i projektit “Kosova e Re”, që do të sigurojë për qytetarët e Kosovës 24 orë energji pa ndërprerje. Në të njëjtën kohë, po vazhdohet me procesin e sistemit të shpërndarjes, në mënyrë që ky sistem të privatizohet dhe në këtë drejtim kemi krijuar bazën e sigurt për investimet e huaja.

Por, edhe në të njëjtën kohë për t’i lehtësuar punën biznesit, për të lehtësuar punën për të ardhmen, për të siguruar një klimë tepër të favorshme për biznesin, kemi ulur shkallët tatimore më të ulëta në rajon. Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, ne po e zhvillojmë një strategji të re dhe moderne për bujqësinë, në një kriter të ri, në një model të ri të qeverisjes, duke dizajnuar modelin që bujqit tanë të kalojnë në standardet e shekullit 21. Pra, e gjithë kjo do të mënjanojë zhagëtimet, praktikën e vjetra, të dëmshme të qeverisjeve.

Në të njëjtën kohë, të nderuar deputetë, qytetarë të Kosovës, kemi instaluar dhe po vazhdojmë të punojmë maksimalisht për një qeverisje që nuk do të toleronte çfarëdo keqpërdorimi të pozitës. Një proces i tillë ka filluar të ndihet ndjeshëm në të gjitha institucionet, nga niveli më i lartë deri në nivelin më të ulët. Në institucione përfshihet i gjithë spektri politik dhe duhet të ketë reflektime në gjithë spektrin politik. Siguroj edhe sot se nuk do të tolerohet as edhe një lloj korrupsioni, keqpërdorimi, apo krimi të organizuar.

Unë dhe Qeveria që udhëheq e ka thyer heshtjen 10 vjeçare apo mbulimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar dhe kjo betejë nuk e ka një adresë, kjo betejë ka shumë adresa.

Institucionet e Kosovës do të vazhdojnë të jenë në ballë të kësaj beteje. Jam i bindur, i sigurt se edhe këtë betejë do ta fitojmë, sepse unë dua të besoj se kjo betejë do të tejkalohet çdo kornizë politike apo partiake. Këtu është interesi shtetëror për ndërtimin e shtetit demokratik dhe të sundimit të ligjit. Ju kam ftuar dhe ju riftoj edhe sot për mbështetje të plotë, të mos politizohet ky proces, por të punojmë të gjithë për sundimin e ligjit. Ne jemi duke punuar maksimalisht që të sigurojmë një sistem gjyqësor, që punon pa ndërhyrje politike.

Të nderuar deputetë,

Ne po punojmë me EULEX-in dhe me partnerë tjerë ndërkombëtarë në ndërtimin e një sistemi të drejtësisë, me qasje të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe të gjithë qytetarët e Kosovës janë të barabartë para ligjit. Në këtë drejtim e kemi mbështetjen e plotë ndërkombëtare. Drejtësia do të jetë në dispozicion të të gjithëve, në nivel të barabartë, e në të njëjtën kohë ligjshmëria do të shtrihet në gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe nuk njeh qasje politike, parti politike, etni apo pjesë të territorit dhe do të bindeni! Kushtetuta e Republikës së Kosovës do të zbatohet në mënyrë të barabartë përgjatë gjithë territorit të vendit tonë.

Të nderuar deputetë, qytetarë të Republikës së Kosovës, ne po ecim bashkërisht me Bashkimin Evropian, me angazhimet tona shtesë të cilat i kemi marrë dhe me formimin e Ministrisë për Integritet Evropian, që gjatë kësaj vere të fillojmë dialogun për liberalizimin e vizave dhe ky do të jetë përfitimi i parë i kësaj përpjekje madhore.

Derisa KFOR-i po përmbyll misionin e tij të suksesshëm, sot institucionet e vendit janë duke ndërtuar të gjitha kapacitetet e tyre të sigurisë, në mënyrë që të funksionojmë definitivisht si shtet. Kosova është duke punuar dhe është mirëkuptimi edhe ndërkombëtar që sa më parë të anëtarësohet në partneritetin për paqe dhe që, përfundimisht, të hyjmë në planin e veprimit për anëtarësim.

Ne po punojmë shumë ngushtë me gjithë komunitetin ndërkombëtarë, me partnerët tanë për një të ardhme të qartë për Forcat e Sigurisë së Kosovës.

Në të njëjtën kohë, të nderuar deputetë, Kabinet qeveritarë, i nderuari kryetar i Parlamentit, të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, ne jemi edhe para një sfide të re të gjithë, para një sfide që duhet të gjejë forma të reja të bashkëpunimit me të gjitha vendet e rajonit dhe, natyrisht, e njohim edhe natyrën e veçantë rajonale të Mitrovicës veriore, duke ruajtur tërësinë e saj territoriale të plotë, të Kosovës pra, në përputhshmëri të plotë me Kushtetutën dhe me ligjet tona.

Në të njëjtën kohë, dua të potencoj se të gjitha këto angazhime duhet të jenë ato prioritetet të cilat na bashkojnë të gjithëve. Këto vendime që do t'i marrim në të ardhmen e afërt, ky vizion për këto vendime nuk përsëriten ndonjëherë për shtetin tonë, për vendin tonë, për qytetarët tanë. Prandaj, secili duhet të ngrihem mbi disa interesa të ngushta partiake, në shërbim të vendimmarrjeve madhore që hyjnë drejtpërdrejt në interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Pra, ne jemi një shtet i ri, por me një të ardhme të sigurt.

U dëgjuan këtu, të nderuar deputetë, i nderuar kryetar i Parlamentit, nëse më lejohet, edhe adresime në drejtim të Qeverisë.

Unë do t'ju ftoja, sinqerisht, të gjithë juve, çdo grup parlamentar, me mirëkuptimin më të lartë dhe përgjegjësinë më të lartë kushtetuese dhe ligjore që... okej, kjo pjesa e parë e Parlamentit u bë tash vetëm që të merret mikrofoni dhe të shpalosen akuza ndaj njëri tjetrit, gjë që mendoj që, para së gjithash, vetë qytetarët nuk e meritojnë një fjalor të tillë, por do të dëshiroja që nëse keni mirëkuptim, do të ishte me interes që të ngrihen për debat të gjitha çështjet që ju mendoni, qoftë për zhvillimin ekonomik në Kosovë, qoftë për sundimin e ligjit, qoftë për gjendjen në arsim, qoftë për gjendjen në shëndetësi, për Forcën e Sigurisë së Kosovës, për politikën e jashtme, për të gjitha angazhimet të cilat i ka Qeveria dhe i kemi ne të përbashkëta. Unë, së bashku me Kabinetin tim, jam në dispozicion të këtij debati, natyrisht, korrekt, konstruktiv, debatues dhe krahasues.

Ndërsa, përsëri parashtroj pyetje për kryetarin e Parlamentit, nëse më lejohet, unë do të prezantoja edhe disa të arritura dhe punën e Qeverisë në sektorët të cilët u shprehën opinione të lira, por ndaj këtyre opinioneve të lira të flasë me shifra dhe fakte.

Faleminderit, kryetar!

Në vitin e parë të pavarësisë, në vitin 2008, shënuam rritje ekonomike prej 5.4%, në vitin 2009, shënuam rritje prej 4.4%, për vitin 2010 do të shënojmë rritje prej rreth 6%. Ndërsa, kemi rritur performancën ekzekutimit të shpenzimeve kapitale, prej nga përfitojnë direkt qytetarët e Kosovës.

Nga 155 milionë euro në vitin 2007, në vitin 2008 kemi realizua 347 milionë euro investime, një ngritje mbi 120%. Në vitin 2009 kemi investuar mbi 400 milionë euro, ndërsa në këtë vit planifikojmë të investojmë rreth 500 milionë euro. Krahasuar me vitin 2007, kjo shënon një rritje mbi 320%. Përmes reformave në politika fiskale, kemi ulur normat e tatimeve direkte për 50%, siç është norma tatimi në fitim të korporatave, që është ulur nga 20 në 10%. Për tatime në të ardhura individuale, shkalla maksimale është ulur nga 20 në 10%, këto janë shkalla tatimore më të ulët në rajon.

Sa i përket arsimit, dëshiroj të theksoj se edhe fëmijët, edhe prindërit, edhe mësimdhënësit i vlerësojnë të arriturat dhe përkushtimi ynë që nga fillimi ka qenë që të kemi një sistem arsimor model për rajonin. Jemi duke punuar në këtë drejtim dhe është arritur sukses i vlerësuar, por as kjo nuk duhet të na kënaqë, por pa tjetër duhet të arrijmë standardin më të lartë përëndimor.

Kemi rritur pagat, të nderuar deputetë, të mësimdhënësve universitarë për 100%, ndërsa punëtorët e arsimit fillor dhe mesëm deri në 47% në bazë të gradimit. Në të njëjtën kohë, jemi të përkushtuar për të ngritur standardin e shërbimit të përkujdesjes mjekësore në vendin tonë. Kemi rritur buxhetin për shëndetësinë, kemi përmirësuar furnizimin me barëra esenciale, kemi ngritur pagat e punëtorëve mjekësorë deri në 60%.

Jemi zotuar për ndërtimin e rrugëve të reja dhe auto-rrugëve me standarde ndërkombëtare. Kemi ndërtuar rreth 600 kilometra rrugë të reja, e kemi filluar autostradën. Në të njëjtën kohë, jemi duke punuar, siç e përmenda edhe për sektorin e energjisë, ndërsa dëshiroj të theksoj se vetëm në sektorin e energjisë kemi furnizim me energji elektrike mbi 40% më tepër se në vitin 2007 e mbi 13% më tepër furnizim.

Ndërsa, për Policinë e Kosovës, siç e dini, kemi rritur paga deri në 40%, për zjarrfikësit 50%, shërbyesit civilë marrin paga më të mëdha për mbi 20%, ndërsa që nga viti i ardhshëm pra përmes Ligjit për shërbyesit civilë do të kenë statusin e tyre të rregulluar për paga më të mira. Kompensimet për kategoritë sociale janë rritur në total deri në 13%. Në forcën e Sigurisë së Kosovës kemi vendosur sistem të dinjitetshëm të pagave prej 260 deri 1000 euro. Invalidët e luftës sot marrin pra paga prej 30 deri 100% më shumë, varësisht nga kategorizimi invalidor dhe do të miratojmë edhe Ligjin për vlerat e luftës. Ndërsa, në sektorin e bujqësisë kemi sot një investim në kuptimin e buxhetit deri në 40% më tepër. Këto dhe angazhimet tjera të cilat i ka Qeveria, të cilat nuk dëshiroj që sot t'ju humbi edhe shumë kohë, por dëshiroj që për secilën çështje, nëse mendoni, mund të diskutojmë.

Pra, edhe një herë ju faleminderit shumë për debatin shumë korrekt dhe shumë konstruktiv. Faleminderit shumë për vëmendje!

KRYETARI: Nejse, përfunduar pikën e deklarimeve të lira edhe të deputetëve, edhe të Qeverisë. Vazhdojmë me rendin e ditës.

Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti ministër, duke qenë se rregullimi i kufijve me fqinjët është një ndër standardet e shumta për çështjen e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, Kosova ende nuk ka përcaktuar vijën kufitare, demarkacionin me Republikën e Malit të Zi. Kohë më parë janë paraqitur edhe problemet me këtë kufi me këtë vend, si ato të vendosjes së tabelave nga ana e shtetit Malazez në pjesën e territorit të Kosovës.

Zoti ministër,

Kur pritet që institucionet e shtetit, të prira nga Ministria e Punëve të Brendshme, të fillojnë punën dhe bisedat me institucionet e Malit të Zi për definimin e qartë të vijës kufitare mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Malit të Zi? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti Abdyl Ymeri,

Natyrisht që është një brengë e të gjithëve dhe ditë më parë disa fermerë nga ajo pjesë janë pranuar nga ushtruesi i detyrës së drejtorit të Përgjithshëm të Policisë në lidhje me shfrytëzimin e pronave të tyre dhe, sa vijon, unë do t'i bëjë shpjegimet edhe në lidhje me demarkacionin edhe me kërkesat e këtyre qytetarëve.

Në mes të pikës së kalimit të kufirit Kullë dhe pikës së kalimit në Republikën e Malit të Zi është zonë kufitare ende e pa shënuar fizikisht ose e demarkuar. Kjo zonë është kontestuese dhe në një të ardhme të afërt duhet të përcaktohet me komisionet e demarkacionit, të cilat duhet të krijohen në mes të dy autoriteteve shtetërore. Vitin e kaluar, përkatësisht në shkurt dhe në nëntor 2009, Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës përmes kanaleve zyrtare i është drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme të Malit të Zi duke shprehur gatishmërinë për fillimin e procesit të shënimit fizikë të vijës kufitare, demarkacionit mes të dyja vendeve.

Autoritetet në Podgoricë deri më tani nuk kanë shfaqur ndonjë interesim për shënimin fizik të vijës së kufirit me Republikën e Kosovës. Përkundrazi, me veprimet e njëanshme, si ajo e vendosjes së shenjës: Crna Gora, Montenegro, Welcome, kanë vështirësuar këtë proces. Kjo ka bërë që shumë qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilët kanë prona përreth zonës kufitare, të kenë vështirësi në qasjen ndaj këtyre pronave për të punuar dhe kultivuar produktet e tyre.

Javën e kaluar i kam dërguar një tjetër shkresë ministrit të Punëve të Brendshme të Republikës së Malit të Zi, ku kam kërkuar që deri në fillim të shënimit fizik të vijës së kufirit, qytetarëve të cilët kanë prona në zonën kufitare t'ju mundësohet qasja e lirë dhe pa pengesa nga autoritet kompetente të Malit të Zi. Po, sikurse edhe më herët, edhe kësaj radhe nuk kemi marrë ndonjë përgjigje nga autoritetet kompetente në Podgoricë.

Po ashtu, mosdefinimi i vijës së kufirit ka pamundësuar zbatimin e një projekti të Komisionit Evropian për menaxhimin e integruar të kufirit që synonte ndërtimin e objekteve të përbashkëta për kontrollin dhe mbikëqyrjen e ...

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, ke pyetje shtesë? Nuk ke. Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Sikundër dihet, hetimet kundër 4 ish zyrtarëve të hekurudhave të UNMIK-ut dhe 2 personave përfaqësues të dy kompanive private për abuzime dhe spekulime mbi 3 milionë euro gjatë shitblerjeve të kundërligjshme të 311 vagonëve të hekurudhave kosovare, sikundër të kishin qenë hekurishta, zgjasin mbi 5 vjet, por asnjë komunikatë, as transparencë, të mos theksohet ndonjë rezultat. Denoncimi juridik penal kundër entiteteve të theksuara më sipër është bërë më 2 shkurt të vitit 2005, por deri më sot me bazë prezumohet se kundër atyre autoritetet e prokurorisë publike nuk kanë proceduar dot.

Shkurtimisht, zoti ministër Rexhepi, çfarë të dhënash dispononi ju dhe çfarë është opinionin juaj dhe i ministrisë të cilën ju e menaxhoni? Ju falënderohem!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Do të provoj, me aq sa kemi ne informata, të përgjigjem në pyetjen e juaj. Njësia rajonale për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit, në Prishtinë, ka zhvilluar hetimet për rastin numër 3/16557 për dyshim se janë bërë keqpërdorime nga disa persona zyrtarë në Ndërmarrjen e Komunikacionit Hekurudhor në Fushë Kosovës. Pas hetimeve të zhvilluara, në konsultim me kryeprokurorin e Prokurorisë Publike të Qarkut, në Prishtinë, është ushtruar kallëzim penal kundër 6 personave të dyshuar, 5 prej tyre shtetas të Kosovës, ndërsa një shtetas i huaj. Kallëzimi penal është ngritur për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale – shpërdorim të detyrës zyrtare. Kallëzimi penal është dorëzuar në Prokurorinë e Qarkut me datën 2.2.2005. Prej dorëzimit të rastit në Prokurorinë Publike të Qarkut, në Prishtinë, Policia e Kosovës nuk ka pranuar ndonjë kërkesë për vazhdim të hetimeve apo kërkesë për plotësim të kallëzimit penal. Pra, nga ajo kohë rasti mbetet në përgjegjësinë e Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, ke pyetje shtesë? Urdhëro!

Regjia, fjalën deputetit Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Kam konsiderata për përgjigjen e juaj, zotëri ministër, edhe për prezantimin korrekt. Po e shfrytëzoj këtë oportunitet për ta shprehur një indinjatë të thellë referuar Prokurorisë Publike, e cila zhagjit procedurën a me qëllim, po edhe nëse nuk është qëllimi, rezulton dyshimi i bazuar se në ato mosveprime ka komponente korruptive. Në qoftë se nuk është pengesë eventuale për çështjet zyrtare, kisha pasur dëshirë t'i prezantoni edhe emrat e këtyre personave të cilët, po e zëmë, janë të kamufluar, kur është iniciuar procedura penale dhe është zhagjit apo është pezulluar krejtësisht. Ju faleminderit!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Natyrisht, ju e kuptoni, aty ne nuk kemi mundësi më tutje në çështjet e prokurorisë, ndërsa ata që kanë qenë në hetime dhe është dërguar lënda në prokurori, janë Gani Lahu, Fitim Shala, Haki Sallahu, Nazmi Kajtazi, Sadri Hajra dhe Stefan Riçard.

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, pyetje tjera nuk ka për ju, mund të shkoni në detyrë. Deputetja Mimoza Ahmeti, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar. Deputetja s'është këtu. Vazhdojmë. Deputeti Rexhep Hoti, pyetje për kryeministrin. Nuk është këtu as kryeministri, as Rexhep Hoti.

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Enveri nuk është këtu.

Vazhdojmë. Deputetja Njomza Emini, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi apo ministrin Besim Beqaj, as njëri, as tjetri nuk janë këtu.

Vazhdojmë. Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministren Justina Pula Shiroka. Deputeti është këtu, ministria s'është këtu.

Vazhdojmë. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Blerand Stavileci, ndoshta vjen ndërkohë, se ka lajmëruar se vjen pak më vonë.

Deputeti Basri Musmurati, pyetje për ministrin Skender Hyseni. I kemi të dytë këtu, deputet e ke fjalën!

BASRI MUSMURATI: Faleminderit, zoti kryetar!

Republika e Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë ka hapur një numër relativisht të mirë të ambasadave nëpër shumë vende të botës. Kjo nuk do të thotë se duhet të jemi të kënaqur me këtë ritëm të hapjes së ambasadave. Dihet se në kohën kur u bë përzgjedhja e ambasadorëve, në disa gazeta të Kosovës u bë shumë zhurmë duke cenuar personalitetin gati të secilit ambasador të emëruar, u dashtë që të shkruajnë edhe gazetat e jashtme për të treguar personalitetin real dhe të çmueshëm të disa ambasadorëve. Më duket se institucionet e Kosovës nuk gabuan me rastin e përzgjedhjes së ambasadorëve, pasi që puna e tyre e mirë për Kosovën dita – ditës po vërehet.

Pyetja: Zoti ministër, kohët e fundit sërish ka filluar një lloj devalvimi nga ndonjë gazetë ditore, këtu në Kosovës, i punës së disa ambasadorëve tanë në botë. Kjo duket edhe më shqetësuese kur informatat denigruese dalin nga stafi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe u shpërndahen disa gazetave. Kur kihet parasysh se një gjë e tillë dëmton imazhin e Kosovës dhe të diplomacisë së saj, ju lutem të njoftoni Kuvendin e Republikës së Kosovës se a jeni në dijeni për këto veprime të dëmshme të ndonjë zyrtari të Ministrisë, që e udhëhiqni ju, dhe nëse po, a keni ndërmend të merrni masa të nevojshme ligjore ndaj atyre që zbehin imazhin e diplomacisë edhe ashtu të re të Republikës së Kosovës?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti deputet Musmurati për pyetjen! Po të përgjigjem shkurt. Nuk jam në dijeni dhe nuk do të spekuloj për të ashtuquajtura burime anonime, fantome që i krijon dikush për të mbuluar veprime konkrete, në këtë rast, për të spekuluar.

Unë, si ministër i Jashtëm, u i referohem ekskluzivisht burimeve zyrtare, publike të cilat flasin në emër të Ministrisë dhe kushdo që përdor të ashtuquajtura burime anonime për të spekuluar në ndonjë rrafsh, nuk bien në fushëveprimin tim dhe s'dua as të merrem me to.

Ndërkohë, sa i përket ritmit të vendosjes së misioneve diplomatike të Kosovës, është çështje të cilën mund ta debatojmë. Ne mund të themi që Kosova për një kohë relativisht të shkurtër ka hapur misione mjaftueshme edhe diplomatike, edhe konsullore. Ndërkaq, nuk do të komentoj, po ashtu, shkrimet në media. Mediat janë të lira të shkruajnë dhe të vlerësojnë, ndërkohë që

Ministria e Punëve të Jashtme, si institucion shtetëror, në kohën e duhur do të bëjë vlerësimin e performancës së secilit pjesëtar të shërbimit, qoftë diplomatik, qoftë konsullor të Republikës së Kosovës. Dhe, këto vlerësime do të jenë periodike. Absolutisht, deri më tash nuk ka vlerësime të tilla dhe nuk ka intencë të asaj që ju po i referoheni. Duhet thënë dhe, besoj, këtu pajtohem me të gjithë që Shërbimi Diplomatik dhe Konsullor i Republikës së Kosovës është një shërbim në ngritje e sipër dhe gjithsesi një shërbim të ri dhe të ndjeshëm, siç është ky, e përcjellin edhe vështirësi të caktuara dhe këto vështirësi shihen shumë rrafshë, por janë vështirësi të arsyeshme dhe të cilat nuk mund të evitohen shpejt. Punë e madhe po bëhet që këto të evitohen.

Në të njëjtën kohë, unë dua ta theksoj që dihet procedura e qartë e emërimit të ambasadorëve dhe e shkarkimit të tyre dhe në kohën e duhur, Ministria, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, instancat relevante, presidentin e Kosovës, që është autoriteti kryesor, qoftë për emërimin, qoftë për shkarkimin sipas rekomandimeve që i bëjnë institucionet përkatëse dhe unë kujtoj se duhet t'ua lëmë punën e vet ta bëjnë mediat, ato janë të lira, edhe kur gabojnë, janë të lira të gabojnë, më mirë se sa të kontrollohen. Ndërkohë që institucionet do ta bëjnë punën e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë? Fjalën e ka deputeti Basri Musmurati.

BASRI MUSMURATI: Ne, si deputetë, para do kohësh i patëm në vizitë kështu disa deputetë të parlamentit Zviceran, në mesin e tyre ishte deputet dhe kryetar i Partisë së të Gjelbërve dhe ata, përveç bisedave tjera, ngrehën edhe këtë shqetësim. Unë, të them të drejtën, ne si deputet u zëmë ngushtë, sepse në diplomacinë tonë nuk kemi pasur ndonjë skandal prej se janë emëruar ambasadorët, do të thotë është vlerësuar puna e tyre, është parë komunikimi që kanë pasur ata edhe me institucionet e vendeve ku janë, edhe më gjerë, bile, bile është për t'u çmuar edhe ai lobimi i tyre për pavarësinë e Kosovës që e kanë bërë. Po, ishte shqetësuese kur këta kërkojnë nga ne, si deputetë, të japim një përgjigje çka është me këtë intervenim të juaj të brendshëm për ambasadorët tanë. Ata e kishin drejtpërsëdrejti për ambasadorin e Kosovës në Zvicër, sepse është një njeri i cili ka një autoritet...

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI SKENDER HYSENI: I nderuar deputet Musmurati, Unë nuk do të lëshohem sot në vlerësimin, profilizimin e secilit ambasadorë të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës vërtet ka ambasadorë të shkathtë, të zotët dhe përfaqësues të denjë dhe këtu nuk do të them asgjë më shumë, sepse u takon të tjerëve ta bëjnë vlerësimin më shumë, ndërkohë që Ministria do të bëjë vlerësim institucional dhe në kohën e duhur do të bëjë veprime konkrete për rivendosjen e ambasadorëve, sepse është praktikë e njohur ndërkombëtarisht që një ambasador qëndron në të njëjtin vend minimumin dy vjet, maksimumi 4 vjet dhe këtë praktikë do ta instalojë edhe Republika e Kosovës. Nuk duhet të shihet asgjë e keqe në këtë proces, si proces normal. Ndërkohë, ju siguroj që nga institucione zyrtare, nga Ministria e Punëve të Jashtme nuk ka spekulime të tilla. Unë nuk mund të mbyllë të ashtuquajtura burime anonime, sepse të përpiqesh të merresh me to, është njësoj si të përpiqesh të luftosh me mullinj të erës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi. Nuk është ministri, deputeti është këtu. Deputeti Naim Rustemi, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Deputeti është këtu, zëvendëskryeministri s'është këtu. Do ta lexosh pyetjen, deputet? Naim Rustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Do ta lexoj pyetjen sepse u pa që debat është, unë po flas, t'i dëgjo. Nëse është ashtu, edhe unë po bëj pyetjen dhe ai ka mundësi të më dëgjojë diku prej televizionit dhe le të përgjigjet lidhur me manipulimet e qëllimshme me opinionin publik në seancën para kësaj seance, kur tha se kemi pasur të drejtë në nxjerrjen e udhëzimit administrativ për amendamentimin e ligjit a sido që e kanë quajtur, se s'kanë pasur të drejtë të nxjerrin udhëzim administrativ që e rregullon fushën e prokurimit publik.

Në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2010, Qeveria e Kosovës miratoi udhëzimin administrativ në fushën e prokurimit publik, i cili përcakton mënyrën e nënshkrimit të kontratave publike me vlerë të mesme dhe të atyre me vlerë të lartë.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik është përgjegjës për përgatitjen dhe shpalljen e masave të hollësishme zbatuese, përfshirë udhëzimet administrative për zbatimin e Ligjit të prokurimit publik. Pyetja parlamentare që është drejtuar ka qenë a mund të tregoni bazën ligjore që u lejon të nxirni udhëzime administrative për zbatimin e Ligjit të prokurimit publik? Unë e di që Qeveria ka profesionalizëm të mjaftueshëm, sa e di që s'ka të drejtë, por po mendoj që e ka bërë në mënyrë të qëllimshme, në mënyrë të qëllimshme që të arsyetojë veprimet e veta, herë – herë edhe jo të mira, ndoshta edhe shpeshherë jo tumira. Për atë edhe ia kam drejtuar pyetjen dhe kam dëshirë që Qeveria ta marrë seriozisht pyetjen time dhe ta tërheqë udhëzimin e vet administrativ, sepse s'ka të drejtë ta bëjë një gjë të tillë dhe të kërkojë falje publike që tentoi të manipulojë opinionin javën e kaluar.

KRYETARI: Deputeti Driton Tali, pyetje për ministren Justina Pula Shiroka, apo ministrin Ahmet Shala. Ministren e parë nuk e kemi këtu, të dytin e kemi, urdhëro, bëje pyetjen, deputet!

DRITON TALI: Pasi që ka të bëjë pyetja me paranë, e kemi këtu personin e duhur.

Zoti ministër,

Sipas Raportit të ZRE-së, në vitin 2009 KEK-u ka importuar rrymë me çmim mesatar 75 euro e 77 centë, që është çmimi më i shtrenjti në rajon. Bie fjala, më shtrenjtë se EEX pra Bursa Evropiane e Energjisë, ku çmimi mesatar ishte 44 euro e 4 centë, KEK-u ka importuar rrymë pra me 75.77 euro, apo më shtrenjtë se në Rumani, pra kemi shifrat e Opicom-it, për 117% më shtrenjtë, që do me thanë se në vend të paguani një sasi të njëjtë të rrymës elektrike për 21.350.000 euro, ne kemi paguar 46.300.000 euro, pra më shumë se dyfish. Apo APX-in, tash po t'i lexoj të gjitha, që është Bursa Energjetike e Britanisë së Madhe, Holandës dhe Belgjikës, çmimi mesatar ka qenë 39,20 euro, domethënë 36,57 euro më shtrenjtë apo 93.3% më shtrenjtë, domethënë në vend se të paguajmë 27.800.000 euro për sasinë e njëjtë të rrymës së importuar, KEK-u ka importuar rrymë me 46.300.000 euro, pra më shtrenjtë 18 milionë e gjysmë.

Ngjashëm ishte, tash të mos hyjë edhe më shtrenjtë se IPX-i apo Bursa e Energjisë së Italisë edhe me, ndonëse s'di pse e kenë qitur atë, po mendoj Greqia e tjera e tjera, e mos të flasim me Shqipërinë ku, siç dihet, një pyetje e pata pas bërë vjet, KEK-u prej të njëjtit furnizues pati blerë rrymë më shtrenjtë, pra, dyfish, saktësisht 2.33%, dyfish pati blerë rrymë më shtrenjtë se KESH-i, pra Korporata e Energjisë së Shqipërisë, prej EFT-së, Kompanisë, siç e dini, të Vuk Hamoviqit dhe Svetislav Bullatoviqit për të njëjtën periudhë kohore...

KRYETARI: Ministër, a po e dini për çka është fjala?

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar deputet Tali,
I nderuar kryetar i Parlamentit,
Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë të përgjigjem në këtë pyetje, edhe pse jam i sigurt që ministrja Pula do ishte edhe më koncize në këtë, megjithatë më lejoni që t'i jap disa informacione apo të përpiqem të përgjigjem në pyetjen e deputetit Tali.

Pyetja ishte, të paktën kështu e kam shkruar, edhe pse u elaborua mjaft mirë, a na tregoni pse Kosova gjithmonë importon rrymë elektrike me çmim më të lartë në rajon. Kështu ishte përafërsisht, apo.

Nën një, Kosova importon rrymë për arsyen e thjeshtë se nuk ka mjaft rrymë për të prodhuar për tregun vendor.

Dhe, e dyta, Kosova fatkeqësisht harxhon më shumë rrymë, mbase edhe se sa i nevojitet për arsyen se një pjesë e qytetarëve të Kosovës nuk e paguajnë dhe, natyrisht, harxhojnë më shumë se sa që i duhet, fatkeqësisht. Megjithatë, janë bërë përmirësime të mira në këtë drejtim dhe arsyeja në pyetjen konkrete – pse paguan Kosova rrymë më shumë, nëse më lejon t'u kisha lutur Driton Tali, unë po të dëgjoj me shumë vëmendje, janë të shumta.

Nën një, Sistemi Energjetik i Kosovës është sistem termo i bazuar në prodhimin termo dhe, si i tillë, nuk ka fleksibilitet në zvogëlimin apo ngritjen nëpër kohët pik, pra, si thonë dhe që ka goxha një veçanti sa u përket tregjeve tjera në regjion. Dhe, shtetet në regjion, siç është Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria e të tjerë, mund të blejnë çmime, si quhen, në Ban, jo vetëm në Pik apo Emergjente dhe dihet që rryma në këto dy pika të fundit, siç është në Pik dhe në Emergjente është shumë më e shtrenjtë se sa në dy etapat e tjera.

Po ashtu, më vjen keq që Kosova, në fakt ndërmarrjet publike të Kosovës importin e energjisë elektrike, në këtë rast KEK-u, është i obliguar ta bëjë përmes Ligjit të prokurimit, ndërsa të gjitha korporatat energjetike të regjionit kanë ligj tjetër të prokurimit për ndërmarrjet dhe për korporatat. Ky është një disavantazh dhe ne kemi kërkuar që ky Ligj i prokurimit të përmirësohet dhe besoj që ky do të ndihmojë që rryma të furnizohet me afat më të gjatë. Në këtë kërkesë e kemi bërë me kohë, kemi kërkuar edhe nga KEK-u, në fakt, që të jetë më agil në drejtim të aspekteve të furnizimit të energjisë elektrike.

Edhe një çështje tjetër, faktikisht, është se KEK-u ballafaqohet me probleme serioze gjatë tregtimit të energjisë në regjion për shkaqe të problemeve që i sjell Serbia gjatë transmisionit të rrymës....

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

Fjalën deputetit, Driton Tali.

DRITON TALI: Po, unë kisha për t'ju këshilluar atje që në Qeveri që po thoni se mirë i keni punët, të bisedoni në mes veti kur ta jepni përgjigjen, të jeni të akorduar. Ja, çka thotë zonja ministre Justina Shiroka Pula: "Aranzhimin për pagesën e importit e bëjnë KEK-u dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave". Ne nuk jemi të interesuar të kontrollojmë aranzhimet e importit të rrymës, qëllimi im është që të sigurojmë në pjesën e parë. Në pjesën e dytë, si është e mundur atëherë në Pik të blejë edhe më shtrenjtë KEK-u se sa në atë kohën tjetër modulare, domethënë e qet posht atë se KEK-u blen, është më i kufizuar se sa të tjerët, për shkak se edhe çmimin e PIK-ut e keni shumë më të shtrenjtë se sa kohën modulare. Puna e Serbisë, Arben Gjuka i thotë kështu: "Serbia konsideron rrjetin e Kosovës si të saj, si treg të brendshëm dhe ajo vendos se sa rrymë... e tjera e tjera, prandaj çmimi i importit të rrymës është, po ju krejt bleni rrymë prej Serbisë, o burri i dheut, atëherë logjikisht duhet të keni çmimin...

KRYETARI: Si duket, po e trajton jo si vend, po si shtet. Faleminderit, e kryem, deputet. Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete, mund t'i shfrytëzoni minutat për pyetje!

GJYLNAZE SYLA: E para, kryetar, i ke vetëm 4 ministra këtu, ku janë ministrat që të mund të kemi mbarëvajtje për t'u përgjigjur në pyetjet parlamentare. Ku e ke kryeministrin, erdhi e na bëri repete të mbrëmshme, të fjalimit të mbrëmshëm të tij që e dëgjuam, ia dhamë minutat derisa opozitën nuk po e lë të flasë. Kjo është vërejtje për ju, mocion për ju, meqë nuk m'u dha rasti për të folur, atëherë po e shfrytëzoj foltoren.

Pasi që çështja është shumë e rëndësishme dhe duke marrë parasysh përgjegjësinë totale dhe sjelljen totalitare edhe të juaj, në këtë rast, edhe Qeverisë, unë do ta pres kryeministrin të vjen dhe të përgjigjet, të jetë llogaridhënës ndaj Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe prej teje!

Dhe, e përfunduam, ata sa janë, të mitë janë dhe të Kuvendit, kështu që unë nuk e mbaj në xhep Qeverinë as të tjerët.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës

Regjia, le t'i bie ziles për deputetët që kanë dalë për të pirë kafe.

Unë po e kritikoj mungesën e deputetëve në sallë, shefat e grupeve po thonë – jo, krejt në rregull jemi!

(Ndërprerje e incizimit)

Vazhdojmë. Pasi i kemi 62 deputetë në sallë. Present, sipas kartelave janë 83 deputetë, po fizikisht janë 64 deputetë.

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale apo raportuesin e komisionit që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime, nëse e do fjalën. Fjalën e ka deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedniče!

Funkcionalna komisija je radila na ovom zakonu, radila je svoje amandmane, mada je bio i amandman koji je uradila Komisija za prava i interese zajednica, nije dobio podršku funkcionalne komisije, taj amandman je bio zajednički sa poslanikom Rizom Smakom, to se odnosi na prvi amandman. Takođe je i Parlamentarna grupa „7+“ imala svoj amandman. Odnosi se na naslov ovoga nacarta zakona i u daljem tekstu Komisija za prava i interese zajednice, podržana od Komisije za budžet tražila je da se u naslovu i u celom tekstu tamo gde se pominje Crveni krst, dodaje još i Crveni polumesec. Međutim, ovaj amandman nije dobio podršku funkcionalne komisije. Mi iz Parlamentarne grupe, a i iz Komisije za prava i interese zajednice tražili smo da podržimo ovaj drugi pod „b“, znači ono što je od Komisije za prava. Inače, funkcionalna komisija kojom predsedavam, nije dala podršku ovoj izmeni, nego je ostala pri nacrtu koji je bilo u početku, samo da budem korektan. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Amendamentin 1 të komisionit funksional.

Konstatohet se me 42 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 1 të komisionit funksional.

Dy të tjerat janë pa objekt.

Amendamenti 2.

Edhe amendamenti 2 ka variantin nën “a” dhe nën “b”. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe deputeti Riza Smaka, pa përkrahjen e komisionit funksional. Ne shkojmë e votojmë për amendamentin e komisionit funksional. Votojmë tash:

Konstatohet se me 61 vota “për”, 3 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2. i komisionit funksional.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Edhe këtu kemi dy variante të amendamentit, mirëpo tani na mbetet vetëm varianti i amendamentit të komisionit funksional, pasi deputeti Riza Smaka e tërhoqi amendamentin e vet.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, një “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota “për”, 4 “kundër” dhe një abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, një “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota “për”, një “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, një “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9, i fundit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, një “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Tani votojmë ligjin në tërësi, me amendamentet e votuara, votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, 3 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e Emblemës së Kryqit të Kuq, të emblemeve të tjera dalluese dhe të sinjaleve

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e Emblemës së Kryqit të Kuq, të emblemeve të tjera dalluese dhe të sinjaleve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin dhe amendamentimin e propozuar. Nëse e do fjalën kryetari i komisionit? Nuk e do.

Amendamenti 1.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, pa përkrahjen e komisionit funksional. Votojmë tash:

Konstatoj se me 15 vota “për”, 44 “kundër” dhe 4 abstenime, nuk miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Të komisionit funksional. Votojmë tash:

Konstatoj se me 54 vota “për”, 5 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 47 vota “për”, 2 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 50 vota “për”, 4 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 3 “kundër” dhe një abstenim, miratohet amendamenti 5 dhe i fundit.

Tani votojmë ligjin në tërësi. Votojmë tash:

Konstatoj se me 58 vota “për”, 6 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për përdorimin dhe mbrojtjen e Emblemës së Kryqit të Kuq, të emblemeve të tjera dalluese dhe të sinjaleve. Faleminderit!

Vazhdojmë pikën e radhës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetarja e komisionit, nëse e do fjalën? Nuk e do. Atëherë vazhdojmë me miratimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Ju njoftoj se të gjitha amendamentet janë të komisionit funksional.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 69 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Me 63 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Me 65 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Me 65 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Me 67 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7, i fundit

Votojmë tash:

Me 64 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 7.

Tani votojmë Ligjin në tërësi. Votojmë tash:

Konstatohet se me 70 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik dhe Kuvendi i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Kryetarja e Komisionit, nëse e do fjalën? Nuk e do. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Me 61 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 1.

Kam parë me vonesë, deputetja Nerxhivane Dauti e ka fjalën. Regjia, fjalën deputetes Nerxhivane Dauti!

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Në cilësinë e udhëheqëses së Grupit punues për hartimin e amendamenteve të këtij Projektligji desha t'i them disa fjalë, mirëpo regjia nuk ma dha fjalën me kohë. A ka mundësi?

KRYTARI: Votimi i amendamentit 1 ka shkuar, mund ta merrni fjalën për të tjerat, nëse keni.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, në cilësinë e komisionit funksional e ka shqyrtuar Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit në kibernetikë dhe është kufizuar në vërejtjet parimore të leximit të parë.

Komisioni ka vlerësuar se Ligji në kuptimin përmbajtjesor është në nivel dhe nuk e ka parë të arsyeshme që të bëjnë ndryshime të të njëjtës natyrë. Komisioni ka miratuar gjithsej 13 amendamente. Esenca e ndërhyrjeve ka të bëjë me plotësimin dhe qartësimin e normës juridike, aplikimin e terminologjisë juridike, përcaktimin e minimumit të dënimit për vepra penale dhe në tentativë, si dhe me qartësinë dhe thjeshtësinë e normës, pa e ndryshuar përmbajtjen.

Komisioni, gjithashtu, edhe për disa shkelje në tentativë të kryerjes së veprës penale, për të cilat është paraparë dënimi më i lartë se sa për kryerjet e veprës së njëjtë penale, ka qenë i kujdesshëm dhe ka propozuar dënim më të ulët. Sa për informim, gjatë shqyrtimit të Projektligjit janë konsultuar edhe ekspertët e së drejtës penale, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë për Tregti Industri, të cilët kanë mirëpritur ndërhyrjet e lartshënuara dhe amendamentimin e Projektligjit të cilin e kemi sot në shqyrtim. Ftoj deputetët që të votojnë amendamentet në vijim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Vazhdojmë votimin:

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Me 67 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Me 66 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Me 69 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 13.

Tani votojmë Ligjin në tërësi. Votojmë tash:

Me 65 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik. Ju faleminderit!

Kemi një kërkesë për pauzë. Nëse jeni dakord, shkojmë në një pauzë për kafe. Urdhëroni!

(Daut Beqiri: Ramë Buja e ka kërkuar fjalën)

KRYETARI: E kemi një kërkesë nga shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, urdhëro Ismet Beqiri, në emër të...?

(Reagime, qeshje)

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Sikur të kishe thënë për Ramë Bujen, që ka qenë në LDK, hajde, hajde, por unë nuk kam qenë asnjëherë në PDK. Ju faleminderit për fjalën!

Zoti kryetar,

Ne biseduam. Meqenëse pika e radhës është pikë që mund të ketë shumë diskutues, pa paragjykuar, nëse e bëjmë pauzën, duhet ta bëjmë për drekë dhe jo pauzë vetëm sa për të dalë.

Nëse e bëjmë, e bëjmë për drekë, nëse jo, e vazhdojmë deri në kohën që ju e shihni të arsyeshme për drekë.

KRYETARI: Jo, Rama është deklaruar, por unë e ngatërrova me Ramën. A jeni dakord ju? Atëherë, po e bëjmë pauzën deri në ora 14:00. A jeni dakord?

Vazhdimi i seancës pas pauzës

Ju njoftoj që në sallë janë 58 deputetë, por sipas Rregullores së re, debati mund të zhvillohet edhe me më pak se 1/3 e deputetëve, megjithatë ne vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit, ka shqyrtuar Raportin financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin për Ekonomi dhe Financa, zotin Ahmet Shala që ta marrë fjalën.

AHMET SHALA: I nderuari, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit,

Të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj,

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që sot para jush të paraqes Raportin vjetor të buxhetit të Republikës së Kosovës, raport financiar, i cili në bazë të Ligjit të financave publike, nr. 03-L-048, ministri i Ekonomisë dhe i Financave paraqet raportin vjetor për shpenzimet dhe të hyrat, si dhe performancën e institucioneve që janë nën patronatin, përkatësisht nën mbikëqyrjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës.

Ky raport, përveç të arriturve përmbajtjesore në strukturën e buxhetit të aprovuar në dhjetor të vitit 2009, ka një veçanti të veçantë, sidomos në prezantimin e nivelit të lartë, efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve së Republikës së Kosovës në fushën e menaxhimit të financave publike.

Në dhjetor të vitit 2008, Kuvendi i Kosovës aprovoi Ligjin e buxhetit për vitin 2009, ndërsa në korrik rishikoi Ligjin e buxhetit të Republikës së Kosovës, nr. 03-L-167 për ndarjet e reja buxhetore dhe, si të tillë, unë sot e paraqes në disa pika.

Plani buxhetor i pranimeve vjetore për vitin 2009, ka qenë 1.156.500.000 euro. Plani buxhetor i të dalave vjetore, ka qenë 1.423.929.000 euro, duke përfshirë të hyrat vetanake të bartura nga viti 2008, të cilat nuk janë planifikuar në Ligjin për ndarjet buxhetore.

Veçoritë e këtij raporti: ngritja substanciale e nivelit të të hyrave, tejkalim i planit për të hyra në disa kategori, ngritje kuantitative dhe kualitative në kategori të investimeve kapitale, ngritje përkundër rritjes së numrit të institucioneve të reja dhe zgjerimit të dukshëm të fushëveprimit të tyre, institucionet e Kosovës kanë një ngritje simbolike të shpenzimeve në kategoritë e mallrave dhe të shërbimeve, që konsideroj se do të shpjegohen më në detaje pak më vonë.

Në vazhdim, më lejoni të paraqes një përmbledhje sipas kategorive. Rranimet apo të hyrat: Të hyrat e grumbulluara për vitin 2009, duke mos përfshirë lëndët e përcaktuara të donatorëve, kanë qenë 1.146.817.000 euro dhe paraqesin 99.2% të planit të përgjithshëm vjetor. Kjo tregon se realizimi ka qenë në nivel të planit vjetor, ndërsa kemi një rritje prej 22% krahasuar me vitin paraprak.

Rritja prej 22%, krahasuar për vitin 2008, në kohën kur e tërë ekonomia botërore, pothuajse pësoi tronditjen më të madhe në 70 vitet e fundit, vërtet tregon për një performancë të shtetit të Kosovës. Performancë ekonomike, financiare dhe tregues i qëndrueshmërisë të saj të vizionit të qëndrimit politik. Nuk dua të përmend këtu raste kur shtetet në regjion kanë reviduar të hyrat, siç është Sllovenia, Maqedonia, besa edhe Shqipëria, edhe pse në vend qëndron, konsideroj pas Kosovës, sipas shifrave e dyta, prapëseprapë kanë reviduar, Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet e Kosovës, qytetarët e Kosovës, kanë treguar një pjekuri politike, pjekuri qytetarie dhe respektim të vizioni për qëndrueshmërinë dhe stabilitetin ekonomiko-fiskal të vendit.

Të hyrat e mbledhura në kufi, arrijnë 55% të hyrave të përgjithshme dhe kapin shumën prej 634.146.000 euro. Krahasuar me vitin paraprak, kemi një rritje të arkëtimit 5% për këtë kategori dhe është shumë me rëndësi të theksohet se trendi i rritjes, i pjesëmarrjes së të hyrave nga kufiri është në rënie, pra nga doganat dhe TVSH-ja që mbledhet në kufi, ndërsa trendi i të hyrave nga vjeljet e brendshme është në rritje dhe kjo tregon përforcimin e institucioneve të brendshme të Republikës së Kosovës, të cilat kanë qenë edhe objektiv i ynë. Dhe, të gjitha këto janë arritur këto në kohën kur taksat për Republikën e Kosovës janë zvogëluar për 50%.

Të hyrat e brendshme të mbledhura nga Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës, arrijnë 16% të hyrave të përgjithshme dhe janë në shumë prej 181.659.000 euro. Në këtë kategori të të hyrave, është tejkaluar plani për 3%. Por, prapë po them, 5% ngritje në doganë dhe 3% ngritje në Administratën Tatimore tregon për një performancë, do të doja të thosha të shkëlqyer karshi, se të hyrat karshi me vitin paraprak kanë qenë 22% më të mëdha, ndërsa të krahasuarit në vitin 2007, pothuaj se e ka humbur edhe kuptimin e krahasimit.

Të hyrat komunale në totalin e përgjithshëm të të hyrave marrin pjesë për 4%, në shumën prej 48 milionë, ndërsa në krahasim me vitin paraprak ka një rritje prej 13%. Me këtë rast, dua ta shfrytëzoj rastin t'i përgëzoj kryetarët e komunave, qytetarët e të gjitha komunave për një performancë të ngritur karshi me të gjitha vitet paraprake. Karshi me vitin 2007, në fakt, kjo është një ngritje diku për 87% dhe kjo është një tregues se komunat kanë filluar ta kuptojnë, ta marrin veten dhe të ngrisin institucionet e veta qeverisëse, si dhe qytetarët e Kosovës kanë kuptuar se pagimi i taksave është në të mirën dhe në shërbimin e tyre.

Të hyrat vetanake të nivelit qendror, në totalin e përgjithshëm këto të hyra marrin pjesë për 3% dhe janë në shumë prej 29.657.000, ndërsa krahasuar me vitin paraprak, ka një rritje prej 2%.

Të hyrat jotatimore, qeveritare paraqesin 5% të të hyrave të përgjithshme dhe janë në shumë prej 83.062.000 euro dhe paraqesin një tejkalim të planit buxhetor për 6%.

Të hyrat e arkëtuara nga dividendat e PTK-së, në bazë të vendimit, pra të Qeverisë, janë në shumë prej 200.000.000 euro, e dini dhe paraqet 17% të të hyrave të përgjithshme të nivelit qendror.

Të gjitha të hyrat edhe në dogana, edhe në Administratën Tatimore, edhe të hyrat në komuna, edhe të hyrat nga niveli qendror, në kohën kur bota, e thashë, u trondit nga kriza ekonomike, ku

shtetet në region dhe në Evropë me kulturë dhe traditë 100 vjeçare të shtetësisë së tyre, kanë redukuar, pothuaj se janë para kolapsit ose janë kolapsuar totalisht, Qeveria, përkatësisht shteti i Kosovës qëndroi fuqishëm. Ju, të nderuar deputetë, bashkë me ne i treguat botës se ne mund dhe e bëjmë atë që të tjerët deri më sot nuk e arritën.

Të dalat, në vitin 2009, duke mos përfshirë granadet e përcaktuara të donatorëve, si dhe fondet në mirëbesim, kanë qenë 1.232.339.000 euro dhe paraqesin 86, 5% të planit të përgjithshëm vjetor.

Me vitin paraprak shihet një rritje kualitative vjetore dhe duhet të theksoj dhe të përsëris, ngritje kualitative vjetore, ose investime prej 30%, kryesisht në kategoritë e investimeve kapitale, që janë 15% më të larta se një vit më vonë. Kjo është ajo ngritja kualitative që desha ta them.

Shpenzimet në kategorinë e pagave dhe të mëditjeve janë 264.396.000 euro ose 21% të të dalave të përgjithshme, përkatësisht janë realizuar për 95%. Shpenzimet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë 151.763.000 ose 12% të të dalave të përgjithshme, me realizim 85% të planit vjetor.

Shpenzimet nga kategoria e shërbimeve komunale janë në shumë prej 19.225.000 ose 2% të të dalave të përgjithshme, ndërsa realizimi ndaj planit është prapë 85%.

Subvencionet e transferet, kategori shumë e ndjeshme për shërbyesit për të pamundurit, janë 256.900.000 euro ose 21% e shpenzimeve të përgjithshme. Krahastuar me vitet e kaluara, një ngritje, një realizim vjetor prej 98% dhe një ngritje substanciale, sidomos të kategorive, të invalidëve të luftës, të veteranëve dhe të familjeve të dëshmorëve. Kjo tregon për politikën sociale të kësaj ngritje në këtë aspekt.

Shpenzimet kapitale, 400.380.000 ose 32% e shpenzimeve të përgjithshme, realizim vjetor 80%, ndërsa krahasuar me vitin paraprak – 15% ngritje. Duhet të theksoj këtu se një karakteristikë esenciale e operimit për buxhetin e vitit 2009 ishte kursimi i vazhdueshëm i parave, i cili ndërlidhej me kujdesin e shtuar që kemi pasur për të rritur efektet e mundshme të krizës ekonomike globale.

Dua të shtoj se Buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës, janë bërë edhe disa pagesa të tjera, të cilat e kanë ngritur performancën e qëndrueshmërisë së shtetit në relacion me obligimet e veta, karshi institucioneve financiare ndërkombëtare.

Pagesat për anëtarësimin e Bankës së Republikës së Kosovës në Bankën Botërore, në shumë prej 17.030.000 euro dhe pagesa në emër të borxhit të Republikës së Kosovës ndaj Bankës Botërore prej 43.850.000 euro, ku me rëndësi duhet të theksoj se në formë donacioni për këtë qëllim direkt, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka paguar 84.118.439 euro dhe Unioni Evropian 5.000.000 euro dhe, me këtë rast, dua para jush dhe në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe para opinionit të falënderoj edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe Unionin Evropian për ndihmë substanciale për pagesën ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare, obligim i cili është përmbushur pikë për pikë ashtu siç janë, pra rreth 120.000.000 euro janë kryer obligime ndaj institucioneve financiare në kohën e krizës ekonomike dhe nuk kemi ndalur investimet publike. 120.000.000 euro janë paguar obligimet tona, e thashë cirka, ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare.

Nga Buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2009 janë bërë pagesa edhe në emër të kredisë së KEK-ut prej 78.829.000 euro.

Grandet e përcaktuara të donatorëve. Fondi i përgjithshëm i grandeve të përcaktuara të donatorëve për vitin 2009, duke përfshirë edhe bartjet për vitin 2008, ishte në shumë prej 27.955.000 euro. Nga ky fond, gjatë vitit 2009 janë shpenzuar 19.394.000 euro dhe gjendja e fondeve të grandeve të përcaktuara të donatorëve më 31 dhjetor të vitit 2009, ishte 8.561.000 euro, të cilat fonde janë bartur në vitin fiskal 2010.

Gjendja e fondeve me 31.12.2009, në total do të ishte sipas kategorive, si vijon:

- Fondi i donatorëve..... 8.561.000 euro,
- Të hyrat vetanake.....25.128.000 euro,
- Fondet tjera..... 8.233.000 euro dhe
- Totali neto, duke mos përfshirë këtu..., është383.853.000 euro.

Në bazë të kësaj, shihet se gjendja e fondeve në Buxhetin konsoliduar të Kosovës, më 31 janar 2009, është në shumën prej 341.930.000 euro, që tregon për një qëndrueshmëri të gjendjes bankare të Republikës së Kosovës, që ka qenë edhe kërkesë e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe fond i cili është ngritur dhe do të mbahet edhe në vitet e ardhshme.

Rezerva buxhetore e planifikuar ishte 200.000.000 euro, aq sa ishim zotuar edhe ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare. Fondi në shërbimin e borxheve 12.000.000 euro, i pa shpenzuar gjatë vitit 2009, ndërsa huaja për KEK-un 21.000.000 euro, e pa tërhequr gjatë vitit 2009 dhe këtë e konsiderojmë një kursim të rëndësishëm për Buxhetin e vitit 2010.

Në vitin 2009 është zbatuar politikë e re kontabël lidhur me Fondin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe Fondi i Privatizimit, duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësive, neni 2.8, në mënyrë eksplicite parasheh që paratë dhe pasuritë financiare të mbajtura në mirëbesim nga ana e këtij agjencioni, nuk janë para publike të menaxhuara nga Ministria e Financave dhe, si e tillë, janë paraqitur në pasqyrat financiare primare, pra njëjtë trajtohet edhe Fondi i Trustit të Pensioneve.

Në fund, i nderuar kryetar, të nderuar deputetë, më lejoni të them se raporti është edhe një tregues i qartë i sukseseve të institucioneve të Republikës së Kosovës në këtë periudhë raportuese, si dhe një dëshmi e pakontestueshme për qasjen adekuate proaktive dhe të përgjegjshme në rrugën e forcimit të vazhdueshëm të shtetit të Kosovës dhe ngritjes së mirëqenies së qytetarëve tanë.

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në fund, po ashtu, të potencoj se ky raport financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009, pasqyron realizimin e plotë të objektivave dhe të programeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, objektiva këto të përcaktuara qysh në fillim të punës të kësaj Qeverie. Besoj se është e qartë për të gjithë se indikatorët e përmendur më lartë tregojnë pikë për pikë, jo vetëm për tregues pozitiv kuantitativ, sidomos në raport me qeveritë e kaluara, por mbi të gjitha për një kualitet të ri qeverisës që bazohet në planifikim të mirëfilltë, koordinim institucional dhe përgjegjshmëri në menaxhimin e financave publike.

Krejt në fund, dua t'i falënderoj të gjitha institucionet, pra edhe Kuvendin, edhe ministrinë, edhe komunat për një bashkëpunim të sinqertë dhe koperues për të përmbyllur vitin 2009 me sukses

dhe uroj dhe kërkoj që i njëjti raport të aprovet dhe të debatohet në frymën e një kolegjaliteti, profesionalizmi dhe shkëmbimi i dialogjesh, të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e raporteve tona. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit për prezantimin! Para se t'ua japim fjalën shefave të grupeve, unë e kam një propozim, 10 minuta për shefat e grupeve, 5 minuta për deputetët. A jeni dakord? Kush është “për”?

(Reagime nga salla)

Kuvendi ka të drejtë, jo unë. A ka “kundër”? Shumica janë që debati për shefat e grupeve të jetë 10 minuta, për deputetët 5 minuta. Ju falënderoj shumë!

(Reagime nga salla)

Unë e kam propozuar, Kuvendi ka vendosur. Kjo është e drejtë e imja, shikojeni Rregulloren. Fjalën e ka kryetari i komisionit funksional ose raportuesi, në këtë radhë është deputeti Hajdin Abazi.

(Reagim nga salla)

Atëherë, shkojmë në emër të grupeve. Ju falënderoj për kursimin që po na e bëni!
Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Hajdin Abazi e ka fjalën.

HAJDIN ABAZI: Përsëndetje, zoti kryetar!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Sot kemi para vetes Raportin e Qeverisë lidhur me menaxhimin dhe realizimin e buxhetit për vitin 2009, dhe unë mund të them nga përvoja ime, që nga fillimi në Komisionin për Buxhet dhe Financa, është një raport me një performancë vërtet që është i lakmueshëm dhe ka paraqitur të gjitha të dhënat, që ne si deputetë do të na duhet ta dimë se si ka qenë ndarja e buxhetit, si është menaxhuar ai, ku është realizuar dhe, mbi të gjitha, duke treguar edhe trendet e rritjes, trendet pozitive që kanë qenë. Dhe, për t'i konstatuar këto, pa hyrë fare më tepër në detaje, do të mjaftonte për ta shikuar vetëm tabelën e parë të pasqyrës së të hyrave dhe të dalave.

Partia Demokratike e Kosovës, përkatësisht Grupi Parlamentar i saj e ka shqyrtuar me vëmendje të posaçme raportin dhe ne faktikisht kemi arritur të konstatojmë në këto përfundime. E para, është se Raporti i përmbush të gjitha kriteret sipas Ligjit për menaxhimin e parasë publike edhe është hartuar konform tij, prandaj edhe i përmbush të gjitha predispozitat që ai të aprovet dhe do të ishte në nderin e Kuvendit tonë dhe të gjithë kolegëve deputetë, që ta pranojnë këtë realitet dhe ta votojnë sepse këtu e kemi interesin e shtetit dhe janë rrjedhat që do të na çojnë edhe më tepër përpara gjatë këtij viti dhe viteve të ardhshme.

Ajo çka që bie në sy menjëherë, është në fakt një ngritje substanciale e të hyrave, një ngritje e cila në përqindje shkon deri në 22% dhe kjo shihet edhe në shifrat të cilat i ka prezantuar Qeveria, përkatësisht Ministria për Ekonomi dhe Financa, ku fare lehtë mund të bëhet krahasimi midis të hyrave që ka qenë prej 1.146.000.000 euro dhe që pastaj kjo është ngritur në rreth 1.400.000.000 euro dhe, përveç kësaj, duke arritur që edhe ta kursej fondin prej 200.000.000 euro, që është ai fond i kërkuar dhe që ne kemi pranuar ta kemi si një rezervë për nevojat e ndryshme, raste emergjente, kriza apo diçka që mund të paraqitet.

Gjithashtu, Qeveria gjatë vitit 2009, në të gjitha segmentet e veta ka treguar një performancë sa i përket edhe nivelit lokal, duke shënuar ngritje gjithashtu në të hyrat, por edhe në një kontroll më të avancuar të realizimit të projekteve për të cilat janë zotuar komunat dhe në përgjithësi vërehen, do të thotë, të dhënat se ky proces ka kaluar mirë dhe ka kaluar me një sukses të dukshëm, që nuk ka krahasim me vitet tjera paraprake.

Mirëpo, në këtë kuadër, përveç në aspektin shifror, vërehet edhe një ngritje si në aspektin sasior, ashtu edhe në aspektin cilësor. Në aspektin cilësor, sepse ka shkuar duke rënë pjesa hyrëse nga doganat dhe duke u bartur kjo tek pjesa hyrëse tek administrata tatimore, gjë që tregon se funksionet për vjeljen e të hyrave janë duke u bartur brenda vendit, përkatësisht te organet administrative dhe njëherësh kjo ka ndikuar edhe në rritjen e vetëdijes së qytetarëve që tregon edhe shifra e ngritjes së saj për t'i kryer obligimet e veta ndaj Administratës Tatimore dhe kështu për ta shtuar edhe buxhetin e Republikës së Kosovës.

Vetë fakti i projekteve të realizuara, projekte të cilat në detale janë paraqitur në raporte tremujore që na kanë ardhur, tregon në vazhdimësi se buxheti është realizuar me sukses, buxheti është menaxhuar mirë dhe unë e di, jam i vetëdijshëm se edhe në komision është debatuar që do të ketë ndonjë vërejtje, do të ketë ndonjë sugjerim, mirëpo duke qenë se ne flasim për buxhetin me interes shtetëror, vërejtjet, sugjerimet do të ishte mirë të jenë të sakta në shifra, në zëra të caktuar ose në linja të caktuara, ashtu që të mundet Qeveria në ndonjë segment eventualisht të përmirësohet, por folur në përgjithësi, duke përmbyllur paraqitjen në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, them se Qeveria, me këtë raport që na ka paraqitur për vitin 2009, vërtet tregon një performancë që meriton më tepër lëvdata dhe respekt, se sa kritika, pasi që ne duhet ta dimë se ishte viti i parë dhe buxheti i parë që ne e kemi bërë vet, si viti i parë i buxhetit pas pavarësisë që e kemi aprovuar dhe e kemi realizuar dhe me të gjitha ato ndërmarrje të reja dhe shtime të projekteve që janë bërë gjatë rishikimit dhe megjithatë ato të gjitha janë realizuar dhe madje në shumë aspekte, ani pse në mënyrë simbolike, por janë tejkaluar. Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK-së do ta votojë Raportin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për Buxhetin e vitit 2009. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së i ka shqyrtuar aktualitetet fiskale dhe raportin e analizave të aktiviteteve ekonomike për periudhën fiskale 2009, të hartuar nga Njësia e raportimeve fiskale të Ministrisë së Financave.

Raporti i përpiluar nga MEF-i është i bazuar në metodat standarde të raportimit dhe metodën e krahasimit apo, si quhet, metoda e komparacionit, duke na pasqyruar të dhënat në krahasim me periudhat, periudhën e njëjtë të vitit 2008, që është një metodë më e lehtë për ta kuptuar raportin financiar nga deputetët.

Marrë në përgjithësi, raporti i plotëson të gjitha kushtet pasi që ka shifra që mund të bëhet një vlerësim i saktë lidhur me shpenzimet sipas njësive apo organizatave buxhetore. Marrë në përgjithësi, të hyrat për vitin fiskal 2009, që kalojnë shumën 1.160.000.000 euro, që krahasuar me shpenzimet e të njëjtit vit për 1.252.000.000 euro ka një tejkalim apo një deficit prej 92.251.000 euro, të cilat thjeshtë janë mbuluar nga mjetet rezervë.

Marrë në përgjithësi, mund të jemi të kënaqur me të hyra, pasi që shihet që edhe planifikimi për vitin 2009 ka qenë përafërsisht optimal dhe një qëllim i tillë është arritur, normalisht me ndërhyrjen edhe të Ministrisë për Financa, por edhe të politikave doganore dhe të Administratës Tatimore.

Ajo çka vlen të përmendet, është që në kontinuitet për tërë kohën tatimet kufitare, si quhen, janë ato dominuese që ndikojnë në plotësimin e buxhetit, në arkëtimin e buxhetit të Kosovës. Fjala është gjithmonë për TVSH-në në kufi, për akcizat e jashtme, taksat doganore e tjerë, që gjithsej janë diku 634 milionë euro. Kjo bien të nënkuptojmë se një gjendje e tillë ekonomike në Kosovë nuk po krijon mundësi më të mëdha të arkëtimit të të hyrave doganore.

Tatimet e brendshme nuk janë në rritje të theksuar, por megjithatë ka një tendencë të rritjes dhe janë të arkëtuara 181 milion, fjala ka të bëjë me tatimin e korporatave, tatimin në të ardhura, TVSH-në e brendshëm. Situatën këtu, si po duket e ka shpëtuar dividendat e PTK-së prej 200 milionë eurove, është fjala për dividendën e kërkuar nga Qeveria për vitin 2008, që është arkëtuar në vitin 2009. Në përgjithësi, dividendat nga ndërmarrjet apo korporatat është diku edhe plus 55 milionë, të cilat janë arkëtuar nëpërmjet të AKP-së.

Ka një rritje prej 5.500.000 euro nga të hyrat që i sigurojnë komunat, është domethënë në rritje në krahasim me vitin 2008, nuk është ndonjë rritje e madhe, por jep shenja të një përmirësimi të arkëtimit të komunave.

Sa i përket çështjes së shpenzimeve, ka një rritje në krahasim me vitin, unë gjithnjë po flas në kuptimin e krahasimit për të qenë më të kuptueshëm, ka një rritje prej 288.964.000. Gjithmonë, pjesa më e madhe e shpenzimeve ka të bëjë me paga për shkak të numrit të madh të shërbyesve civilë dhe të atyre që marrin mjete nga buxheti i Kosovës, por kur kësaj i shtohen edhe transferet për subvencionet për rastet sociale, atëherë bien për të kuptuar se shpenzimet nga buxheti i Kosovës sillen gati mbi 40%. Mallrat dhe shërbimet po ashtu kanë tendencë të rritjes, gjithmonë në krahasim me vitet paraprake prej 10.156.000 euro. Këtu mund të nënkuptojmë se kërkesat e Qeverisë janë shtuar, mirëpo nuk ka pasur ndonjë menaxhim të theksuar në kursimet e shpenzimeve nga Qeveria.

Ajo çka vlen për të theksuar që te investimet kapitale, që gjithmonë kemi menduar që kjo është ajo që ndikon në zhvillimin ekonomik, bile nga ajo pjesë e mjeteve buxhetore që ndikojnë në ekonominë e përgjithshme, është 406 milionë, domethënë ka pasur një rritje prej 54 milionë nga viti paraprak, mirëpo kjo bien të nënkuptojmë krejt këto mjete a janë investuar sipas një vlerësimi paraprak dhe a janë të qëlluara. Nëse Qeveria ka konstatuar se kanë shkuar sipas prioritetëve edhe planifikimeve që i ka hartuar, atëherë edhe ne mund të pajtohemi me këto investime në këtë sferë.

Mund të flasim për shpenzimet më saktësisht kur të kemi një auditim të përgjithshëm nga auditori gjeneral për të gjitha organizatat buxhetore, që është dashur ta trajtojmë në një mbledhje të ardhshme, kur do shohim thjeshtë performancën e Qeverisë sa iu përket edhe të hyrave, sidomos shpenzimeve. Ajo që unë e konsideroj që ky Parlament është dashur të ketë informata të veçanta nga pasqyrat financiare, qoftë të hyrave apo të shpenzimeve, është dashur të kemi një raport apo një të dhënë për gjendjen ekonomike në përgjithësi.

Kjo nuk është e obligueshme as me Ligjin e menaxhimit të financave, por ministri për Ekonomi, konsideroj që është dashur një ditë t'i drejtohet me një raportim Kuvendit për gjendjen e përgjithshme në ekonomi.

Si do të ndikojë në investimet kapitale, sidomos për investimet kapitale të mëdha, të cilat do të jenë ato burime financiare që do të shfrytëzohen për mbulimin e këtyre shpenzimeve të investimeve kapitale, cilat janë paralogaritë që janë bërë dhe si do të ndikojnë këto investime kapitale në një buxhet, i cili mund të themi ... stabil, nuk ka ndonjë progres të dukshëm. Konsideroj që është dashur t'i drejtohet ministri Parlamentit edhe me një strategji të zhvillimeve, një strategji të joshjes të investitorëve të jashtëm, me çfarë politikash fiskale do të bëhet Kosova një treg interesat për investitorët e jashtëm dhe cili do të jetë këtu roli i KEK-ut në këtë drejtim, për arsye se Qeveria për çdo vjet po ndanë mjete të konsiderueshme për KEK-un dhe në bazë të Ligjit mi auditimin e jashtëm, ne asnjëherë nuk kemi mundur ta kemi një pasqyrë të saktë të këtyre ndërmarrjeve publike lidhur me menaxhimin e këtyre mjeteve, kur e dimë që KEK-u është një motor i cili kishte për të ndikuar në përgjithësi në ngritjen apo në zhvillimin e potencialit ekonomik të Kosovës.

Poashtu, kërkoj falje që pak po dal prej shpenzimeve, por e kam me qëllim që ministri është këtu. Duhet edhe një ditë të bisedojmë se cili është roli i AKP-së në zhvillimin ekonomik të Kosovës, a e ka AKP-ja rolin vetëm të shitjes të pasurisë shoqërore, të një përfitimi apo është qëllimi që të vë në lëvizje, të rivitalizojë ekonominë e Kosovës në përgjithësi. Thjeshtë, kemi nevojë për një debat për gjendjen ekonomike dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë, në mënyrë që kishte për të ndikuar drejtpërsëdrejti në të hyrat buxhetore, në ndikimet e buxhetit dhe normalisht edhe në shpenzimet më racionale të Qeverisë.

Marrë në përgjithësi, konsiderojmë që raporti i plotëson të gjitha nevojat e parapara në standarde dhe Grupi Parlamentar do ta aprovojë këtë raport, duke mos u zhytur në detajizime të pozicioneve veç e veç për të nxjerrë ndonjë konkluzion. Në përgjithësi, raporti do të votohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kush e do fjalën? Fjalën e ka deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Sot para vetes e kemi Raportin vjetor të buxhetit për vitin 2009, i cili në bazë të dispozitave të Ligjit për menaxhimin e financave publike, nenit 46, nuk i plotëson kriteret e raportimit pasi që këtij raporti i mungojnë pjesë të tëra të raportimit në relacion me atë çka parasheh neni 46, pika (a) dhe (b).

Këtij raporti i mungojnë pjesë dhe detale mbi shpenzimet sipas kategorive veç e veç, por i mungojnë në veçanti tabelat që tregojnë për investimet kapitale edhe në nivelin lokal edhe në nivelin qendror. Mungojnë komplet pra këto të dhëna, që lidhen me tabelën 2a dhe 3a dhe si të tillë, prandaj nuk e konsiderojmë raport të plotë dhe që i plotëson kriteret e raportimit. Por, në bazë të këtij raporti, na mund të nxjerrim edhe disa konkluzione që flasin për nivelin ose dinamikën e të hyrave edhe pse ato janë të sintetizuara dhe të shpenzimeve që po ashtu janë të grupuara. Kështu si është dhënë në këtë raport edhe disa të dhëna që janë pasqyruar në te, përveç që mungojnë disa të dhëna, disa tjera që janë prezent, aty nuk janë prezantuar në disa tabela nuk janë reale dhe për këtë i rekomandoj që na të presim edhe raportin e auditorit të përgjithshëm, i cili pritet që të vijë dhe të shqyrtohet në Kuvend, në shtator të këtij viti.

Sido që të jetë, përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave, e ka nënshkruesi i vërtetësisë së të dhënave që janë dhënë në këtë material. Nga pasqyra e të hyrave që na janë prezantuar, shohim se të hyrat totale kanë qenë për 10 milionë euro nën parametrat e buxhetit. Unë po flas për të

hyrat e rregullta dhe po i lë anash të hyrat e njëhershme, të hyrat nga devidentat që janë vetëm me një vendim të njëhershëm dhe nuk përsëriten në vazhdimësi. Pra, të hyrat e rregullta janë për 10 milionë euro nën parashikimet e buxhetit për vitin 2009. Në veçanti bie në sy dështimi në grumbullimin e të hyrave edhe pse ka një paqartësi në krahasim me buxhetin e rishikuar, kthimet a janë nënkuptuar kthimet edhe nga doganat apo vetëm nga Administrata Tatimore, të hyrat e realizuara nga të hyrat vendore brenda vendit, pra nga Administrata Tatimore, janë 18.5 milionë më të ulëta se sa që ka paraparë buxheti. Domethënë janë realizuar 182 milionë, kurse janë paraparë me buxhet 200 milionë. Pra, kemi 10% nën parashikimet e buxhetit. Unë nuk e di ku i ka marrë ministri të dhënat që thotë ka një rritje esenciale në të hyra.

Po ashtu, edhe të hyrat nga doganat, janë diku në nivelin e të hyrave të parapara me buxhet, por janë shumë pak ose marrë në tërësi janë nën nivelin e të hyrave të vitit 2008 dhe diku barabartë me nivelin e të hyrave 2007, dhe sa për të qenë në nivel të komunikimit, mund t'i them ministrin se, me qenë se na thirri në krahasim me mandatin e kaluar, në mandatin e kaluar të hyrat janë rritë nga viti 2005, në vitin 2007, 100%, kurse nga viti 2008, në vitin 2010, nuk janë rritur as 1%, janë në të njëjtin nivel që ka qenë në vitin 2007. Nuk po i nënkuptoj të hyrat e njëhershme, dividendat. Po bëj përjashtim, po e citoj që të jem korrekt dhe mendoj që dështimi në rritjen e të hyrave qëndron në disa ndërhyrje që janë bërë në ndërrimin e stafit në Administratën Tatimore, për çka nga ky vend, i kemi bërë tërheqje vëmendjes Qeverisë që të mos të ndërhyjë në stafin e përgatitur mirë që është investuar në përgatitjen profesionale të atyre njerëzve. Në vitin 2009, ka pasur disa ndryshime me ndërhyrje politike dhe pikërisht kjo, është dështimi në të hyrat, në këtë institucion shumë të rëndësishëm. Mua më vjen keq që ka ndodhur ajo, dhe po ashtu është pjesa tjetër për të cilën kemi bërë vërejtje me rastin e shqyrtimit të buxhetit për fitin 2009, kur kemi tërhequr vërejtjen se në qoftë se nuk vihet një kontroll më i rreptë në pikat 1 dhe 31 në veri të Kosovës, atëherë do të kemi dështim në të hyrat e realizuara nga të hyrat ... në kufi dhe për këtë, kemi marrë si përgjigje një buzëqeshje ironike të kryeministrit.

Ma vonë, vetë kryetari i Kuvendit, ka deklaruar publikisht se nga dështimet në këtë pikë e kontrollit të të hyrave të mallrave, kemi një evazion fiskal që më duket ka qenë pak e mbivlerësuar 500 milionë euro, ndoshta nuk janë 500 milion, ju keni të dhëna sigurisht për shkak të pozitës që e keni, ndoshta të besueshme, por unë besoj që të paktën gjysma e tyre qëndrojnë.

Sa për korrektësi, dua të them se në raport janë evidentuar edhe mjetet e bartura nga viti 2009, në vlerë prej 383 milionë dhe më vjen shumë mirë, jashtëzakonisht mirë që ky raport është detyruar t' i prezantojë 475 milionë, të cilat disa herë në këtë Kuvend i kam potencuar që janë të hyra që duhet të evidentohen dhe të barten në buxhet, Qeveria nuk i ka bartur ato, por në raport është detyruar me i prezantuar dhe të barten në buxhet, Qeveria nuk i ka bartë ato, por në raport është detyruar me i prezantuar dhe më vjen shumë mirë që sot janë prezantuar dhe i kemi para vetes dhe i dëshmojmë insistimin tim që ato para të evidentohen. Por nuk janë futur në buxhetin e vitit 2010 dhe për këtë kemi ende dilema deri në raportin e Auditorit Gjeneral.

Nga raportet periodike, e dimë që kemi pasur 266 milion mjete të buxhetit, mjete të pastra të buxhetit që janë depozituar jashtë vendit si letra me vlerë. Po ashtu, e dimë që kemi pasur edhe 200 milionë dividenda të postës që nuk janë tërhequr nga bankat afariste, që përafërsisht bëjnë 466 milionë, të depozituara mjete të buxhetit në banka jashtë buxhetit, por për këto 466 milionë për një vit, Qeveria ka realizuar vetëm 5 milionë euro interesa. Po jua përkujtoj që një vit më parë, me shumë më pak mjete të depozituara, Qeveria ka realizuar 17.200.000 euro

interesa, kurse në vitin 2007, 12.000.000, kurse në vitin 2009, me 500 milionë gati mjete, vetëm 5 milionë, llogariteni çfarë interesi ka realizuar Qeveria.

Një pjesë e këtyre mjeteve janë ende të depozituara sipas raportit në bankat afariste diku në Kosovë, dhe pjesërisht jashtë. Dua të them që në përgjithësi raporti i të hyrave dhe i shpenzimeve, është për diku 92 mijë, e përmendi edhe kolegu Osmani, domethënë shpenzime më tepër se sa të hyra dhe kjo tregon se Qeveria në vitin 2009, ka punuar me një deficit buxhetor, pra deficit nga të hyrat neto, por ka pasur rezerva të bartura nga viti i kaluar, viti paraprak dhe i ka mbuluar normalisht.

Kemi shumë çështje teknike, për të cilat kisha dëshiruar të kem një përgjigje nga vet ministri, për shembull, i kemi te tabelat që lidhen me këtë raport, që nuk përputhjen shifrat. Në raport janë thënë se janë bartur 25 milionë, kurse në raportin e vitit të kaluar i kemi pasur diku 45 milionë të hyra të bartura. Ku kanë mbetur këto mjete? Ose e kemi në faqen 9, tabelën te mjetet e bartura një shifër 188.000.000, që Zoti e din ku është marrë, le gjejë. Kisha pasur qejf të kem përgjigje këtu në Kuvend, sepse është një shifër ose e imagjinuar ose është gabim. Jo të lutem, zotëri ministër, në faqen 9, merre raportin e juaj dhe më tregoni ku e keni marrë atë shifër 180 milionë, kisha pasur qejf ta shoh. Ka edhe disa gjëra, për shkak të mungesës së kohës, unë kisha dashur vetëm të them 400 milionë të investuara, në të hyjnë edhe 2 milionë e gjysmë.... (ndërprerje nga regjia)

KRYEETARI: Edhe një minutë!

VAZHDON HAKI SHATRI: ... Në investimet kapitale, është një shifër 2 milionë e gjysmë vendime gjyqësore, çfarë investime kapitale janë vendime gjyqësore? Pa hyrë në atë, se ato 400 milionë a janë shkuar në destinacion a jo, për atë do ta marrim raportin e Auditorit Gjeneral. Pastaj kemi edhe disa çështje tjera që do t'i themi, faturat e papaguara, mjetet e bartura që kurrkund nuk përputhen dhe në fund, unë mendoj që ky raport është mirë t' i japim afat Qeverisë që ta kompletoj edhe pas nja dy javësh, do ta kishim rishqyrtuar. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deklarimi im nuk ishte pjesë e raportit. Pastaj unë nuk kam folur vetëm për dy pikat doganore. Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Grupi Parlamentar i AKR-së ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Buxhetit të Kosovës për vitin 2009, duke marrë parasysh se raporti është bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik, unë do të nisem pikë së pari duke u bazuar në pasqyrën e të hyrave të cilat, në mënyrë shumë të saktë bien në kundërshtim me të dhënat në të cilat na i prezantoi ministri sot në seancë. Thuhet se nga doganat janë diku 634.246 milionë euro, ndërsa në vitin paraprak të hyrat nga doganat, kanë qenë 604.196 milionë euro, në një vend ku të gjitha të hyrat për buxhet mbledhen nga doganat, atëherë të jep për të treguar mjaft mirë se në çfarë zhvillimi ekonomik është kah shkon vendi ynë, zotëri ministër!

Çështja e dytë, është çështja e Administratës Tatimore. Duke marrë parasysh se Administrata Tatimore duhet të ketë rëndësi shumë primare në çështjen e mbledhjes së buxhetit të konsoliduar të Kosovës, që janë paratë e qytetarëve tanë, Administrata Tatimore ka rënie edhe

pas ndërrimit të tre drejtorëve të njëpasnjëshëm në atë administratë. Të hyrat të cilat janë dhënë këtu, janë diku 181.659, që do të thotë -9.5%, e njëjta situatë çdo vit, pra nuk e di pse. Para, do të thotë se në vitin 2008, të hyrat nga Administrata Tatimore kanë qenë më të larta.

Do ta potencoj se të gjitha të hyrat në buxhetin e vitit 2009, kanë qenë 1.146.817.000, ndërsa të dalat janë shumë më të mëdha. Kalojmë te tabela tjetër, ku paraqiten të dalat për vitin 2009, paga dhe mëditje. Këtu mund të shihet se në krahasim me vitin paraprak, ka rritje menjëherë, që do të thotë se diku janë 16.4%. Te mallra dhe shërbime, prapë kemi rritje, ministër! Nuk e di çka duhet të kemi rritje në mallra dhe shërbime aq shumë, me përjashtim tash i kemi edhe Ministrinë e Integrimeve, ndërsa subvencione dhe transfere mirë, kjo çështje është për arsye të situatës ekonomike çfarë e ke, duhet të parashihihen edhe këto subvencione dhe transfera. Ndërsa në rast se ndalemi të shpenzimet kapitale, mund të them se për shpenzimet kapitale kanë qenë të planifikuara diku 498.489, ndërsa janë realizuar diku 400.380 milionë euro, që do të thotë se diku 80% janë realizuar, mirëpo me një vend ku shpenzimet kapitale merren nga buxheti i atij vendi direkt mund të them se ai vend nuk ka një të ardhme shumë të mirë dhe do të thotë se ne kemi mungesë të investimeve direkt.

I gjithë buxheti i vitit 2009, të vitit paraprak, sipas pasqyrave të cilat identifikohen në këtë material, shihet se shpëtim për to ka qenë devidenda e PTK-së, ndërsa në këtë material prapëseprapë shihen edhe të gjitha avanset të cilat janë të paarsyetuara sipas organizatave buxhetore 2009, ku në këtë rast kisha për ta përshëndetur ndoshta vetëm Kuvendin e Kosovës, i cili në këtë rast është pozitiv, ndërsa të gjitha tjerat kanë mungesë në, apo më mirë të them anën negative për mbylljen e avancave.

Duke marrë parasysh të gjitha këto të dhëna që janë në këtë raport dhe duke marrë parasysh subvencionet që bëhen për KEK-un dhe akoma nuk janë kthyer edhe kreditë të cilat janë dhënë për KEK-un nga viti 2008, zotëri ministër, me gjithë mirëkuptimin edhe ne për ju si ministër i këtij dikasteri shumë të rëndësishëm në të cilën mbledhen taksat e qytetarëve tanë, unë mund të them se nuk mund të përkrahë këtë raport, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Është mirë që fillimisht u reflektua edhe si kërkesë edhe e disa deputetëve, respektivisht e grupeve parlamentare që sot kemi të bëjmë me një raport që nuk është i kompletuar, derisa ministri në njërën anë i prezantoi se në këtë raport janë specifikuar realizimi i objektivave të kësaj qeverisjeje në vitin 2009. Kjo mbetet vetëm një deklaram, derisa në anën tjetër nuk ka ofruar materialin e nevojshëm që ta kuptojmë se sa është përqindja e realizimit të këtyre objektivave në kuptimin e investimeve kapitale dhe projekteve që i ka projektuar kjo qeverisje në projektbuxhetin për vitin 2009. Pra, kemi të bëjmë me një gjysmë raport, i cili nuk është i plotë dhe për herë të parë po na ndodhë që në Kuvendin e Kosovës, të mungojë pjesa e projekteve për të cilët është zotuar kjo qeverisje me rastin e miratimit të projekt-buxhetit. Prandaj, do të ishte mirë që ky raport fillimisht të kompletohet në mënyrë që edhe debati të orientohet në projekte konkrete dhe në atë çfarë ka projektuar dhe ka premtuar kjo qeverisje për një vit fiskal si do ta realizojë. Por, derisa jemi këtu, atëherë lirisht mund ta themi se Qeveria e Kosovës nuk ka dalë t'i mbajë fjalët për uljen e shpenzimeve buxhetore të cilat, këto fjalë janë projektuar dhe janë lansuar vazhdimisht nga ana e kreut të Qeverisë.

Por, në anën tjetër kemi të bëjmë me shpenzime të cilat janë rritur pothuaj se në të gjitha kategoritë buxhetore dhe më së shumti në mallra dhe shërbime dhe pavarësisht prej rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar për uljen e shpenzimeve në këto kategori. Mirëpo, ajo çka për ne do të duhej të ishte brengë permanente, se baza tatimore në Kosovë po zvogëlohet, pra kemi në vitin 2009, më pak tatimpagues se në vitin 2008. Ndërsa në anën tjetër, krejt buxheti mbulohet do të thosha apo është projektuar nga të hyrat në dogana, çka është një lajm i keq dhe një porosi jo e mirë për qëndrueshmërinë buxhetore të vendit.

Shqetësues është fakti se çdo fillon me një ankim dhe me një pakënaqësi institucionale kinse Kosova nuk ka buxhet të mjaftueshëm për të zbatuar projektet e parapara, mirëpo gjithmonë ndodhë që në fund të kemi një suficit që është vërtet një realitet shqetësues. Kjo dëshmon për mosefikasitetin qeveritar, kjo dëshmon për jo posedimin e projekteve konkrete, të cilat do të duhej të financohen dhe kjo dëshmon për vetë faktin se nuk kemi vizion të qartë se si duhet të zbatohen projektet konkrete në kohë.

Është obligim i çdo qeverie forcimi i shtetit ligjor dhe luftimi i korrupsionit dhe jo formalitetit, por gjithnjë është e nevojshme që qeverisja me performancën e vet çfarë do të duhej të tregonte të përmirësonte sistemin e qeverisjes në të gjitha nivelet, çka tek ne nuk po ndodhë dhe përkundrazi nuk jemi në një ambient të favorshëm dhe lirisht ta quajmë edhe miqësor në kuptimin e thithjes së investimeve dhe zhvillimit të një ekonomie normale, por në Kosovë ndodhë e kundërta, dhe krimi i natyrës ekonomike viteve të fundit, siç po shihet, është forcuar mjaft.

Kolegët e thanë, parafolësit në fjalë se shpenzimet të cilat janë raportuar për mallra dhe shërbime nuk po njohin kufi në kuptimin e rritjes, derisa kemi pasur edhe deklarime publike për zvogëlimin e luksit qeveritar duke aluduar në adresë të qeverive të mëhershme se kanë shpenzuar në mënyrë enorme dhe në mënyrë të pakufizuar, duke i rritur shpenzimet për telefon, për karburante, për qira dhe kështu me radhë. Dhe, në anën tjetër në vitin 2009, siç po shihet, kemi shpenzime shumë më të mëdha se në vitin 2008.

Po i marr vetëm shërbimet e telekomunikacionit, derisa në njërën anë gjithmonë kemi zbritje çmimesh, për shkak të konkurrencës që krijohet në Kosovë, në anën tjetër, është paraparë këtu, siç është paraqitur, kemi rritje të këtyre shërbimeve në krahasim me vitin 2008. Ajo çka dy herë përsëriten në dy kategori të shpenzimeve janë shërbimet kontraktuese. Dhe, shikoni, kemi shpenzime kontaktuese të cilat në kuadër të saj janë futur shërbimet për AITI, dikush mund t'i shohë të arsyeshme, mirëpo të njëjtën pozicion kemi edhe shërbime për mirëmbajtjen e serverëve. Kur hynë në një kategori që do të duhej të trajtohen në mënyrë pothuajse të njëjtë dhe në anën tjetër nuk po flas për shpenzimet tjera të cilat i thanë parafolësit, mirëpo ajo çka do të duhej të adresohet në kuadër të këtij Kuvendi si për debat dhe të bindet se pse duhet të përkrahet një projekt i tillë apo një raport i tillë, atëherë do të jemi shumë të fuqishëm në qoftë se përpara do ta kemi raportin e plotë, do ta kemi raportin e auditimit, do t'i kemi edhe raportet e Prokurimit publik dhe atëherë do të kemi një përgjigje të plotë për zhvillimet dhe performancat e Qeverisë për vitin që e kemi lënë pas.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, nuk e përkrahim këtë raport, duke konsideruar si të mangët dhe një performancë të dobët të cilët ka treguar Qeveria për vitin 2009. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtari i Kryesisë, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Ju faleminderit! Grupi Parlamentar “7+”, Myfera Shinik

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim,
Bugün burada Kosova Cumhuriyeti 2009 yılı Finansı Raporu görüşülmektedir. Aynı zamanda bu Raporu Bütçe komisyonunda görüşmüştük, eklemeleri , uyarıları orda sunduktan sonra gene 7+ Parlamenter Grubu olarak Raporu görüştük, görüştükten sonra da uygun olduğunu gördük ve 7+ Parlamenter Grubu olarak Raporu kabul etmekteyiz. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Grupi Parlamentar SLS, urdhëroni, Mursel Halili e ka fjalën.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem, gospodine predsjedavajući!

Gospodo ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala ovaj izveštaj i upoređujući cifre prihoda i rashoda, naravno sve to u kontekstu da li je poboljšana uopšte ekonomska slika Kosova, smatramo da ovaj izveštaj ispunjava uslove i mi ćemo podržati ovaj izveštaj. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Grupi Parlamentar për Integritet, kush është, kush ka për të folur? Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala na datu reč!

Mi smo kao grupa pažljivo razmatrali Izveštaj budžeta za 2009. godinu, i smatramo da sam izveštaj moramo da kažemo da ima velike nedostatke. Ovo radimo iz razloga da ukažemo na velike nedostatke iz razloga da bi se poboljšala struktura izveštaja, ne samo budžeta, nego i ostalih svih institucija na Kosovu.

Kada je budžet u pitanju, mi smo izveštaj čuli od strane ministra, čuli smo brojke koliko je ukupan prihod-rashod. Čuli smo parlamentarne grupe, ali to što hoćemo mi kao grupa da damo do znanja, moramo da kažemo da izveštaj ima nedostatke kada je u pitanju Zakon knjigovodstva. Zašto ovo kažem? Zato što Zakon o knjigovodstvu, ovaj izveštaj mora da ima paralelnu formaciju uporedivu sa prethodnim godinama i prenosnu informaciju, kao i planirani i ostvareni budžet da bi mi poslanici, da bi bio prikladan radi analize, jer mi ga dobijemo da ga analiziramo po strukturalnoj osnovi na centralnom i lokalnom nivou.

Budžetske linije nisu jasne i jako je važno, neću da ponavljam sve što su do sada kolege rekle, ali hoću da kažem da ovaj budžet nema aktivu i pasivu. Zašto kažem to? Nema izveštaj o fondovima, dva jako važna fonda, koja su prenešena kao što je Fond agencije za privatizaciju i uopšte Kosovske agencije za privatizaciju i Fond penzijskog invalidskog osiguranja, to jest Trusta. Ova dva fonda nemaju prenosno stanje, nemamo pravu sliku fondova. Kada gledamo koji su fondovi prenešeni, vidimo da u agenciji za, ustvari u Kosovskoj agenciji za privatizaciju, vidi se jasno da je u 2008. godini krenula sa sredstvima od 590, to smo imali pre neki dan izveštaj, a sada vidimo da u tom fondu da imamo samo 383 miliona i isto tako i Penzijski trust koji ima nedostatak i prazninu.

Vidimo gde su sredstva uložena po inostranim bankama, vidimo da je samo 5 miliona bilo dividendi, ako se uložilo, ova praznina od da kažem 170. i ... miliona, da se uložilo po jedan posto u ostalim ovim bankama na čuvanje, možemo svi da izračunamo koja bi to dividenda bila. Prenesena dividenda na ime pošte je 200 miliona, mi znamo da smo suficit imali 211 miliona iz 2007. godine, i mislim da i ovde pregled od 168 miliona koji su raspoređeni od strane pošte po bankama, da opet ima jedna praznina koja nas opet stavlja u nekoj dilemi da razmišljamo.

Ovo su velike brojke koje sam ja dala i mislim da je vreme da svi ovde potegnemo jedno pitanje i da kažemo da su velike praznine u ovom izveštaju.

Jedno što nas dosta zabrinjava, jeste kada je u pitanju servisiranje duga gde nije jasno, moguće je biti jasno samo ekonomistima, gde nije stavljeno da kažem početnom azbukom, razumnom azbukom koliko imamo na ime duga obaveze Kosovo, 381. milion vidimo, nije raščlanjen dug koji je to tu prenesen, dali smo se mi zadužili u toku dve, tri, pet godina, nema starosnu godinu dug i da znamo da je od toga 120. miliona vraćeno, 43. miliona od budžeta Kosova i 89. miliona od donatora. Ne znamo da li su ovih 89. miliona opet sa kamatom, pod kojim su uslovima uzeti i kako su dati, kako su data donatorska sredstva, znači nemamo pravu sliku i mislimo da na ove komponente mora da se obrati velika pažnja zato što su to sredstva, kada kažem, kada je fond za privatizaciju, na primer ovaj izveštaj nema izveštaj o fondovima, gde moramo da imamo Fond za socijalno i invalidsko osiguranje, te moramo više da pravimo Fond za stambeno osiguranje, gde moramo više da pravimo Fond za razvoj i ja sam slušala pažljivo gospodina ministra, rekao je da smo u pozitivu i mi ne vidimo uopšte da smo u pozitivu, da imamo da kažem izvoz gde se zarađuje, gde se dolazi do suficita, do suficita u bilansu u poslovnoj godini, tako da moramo na sve ove fondove i na ove sve stvari koje sam ukazala, dosta sam žurila, da bi bila precizna i tačna. Ja ovo činim u ime Grupe i u svoje ime radi boljeg samog ovog stanja na Kosovu i radi bolje preglednosti kada je bilans u pitanju.

Mi ćemo ovaj izveštaj da podržimo, jer znamo puno puta i bilo da ne podržimo nešto, usvaja se, tako da smo u dilemi samo oko ovih stvari koje sam ja navela. Kada su u pitanju troškovi, vidimo da se troškovi povećavaju, znači i dalje nema politika štednje i tu hoćemo da damo isto primedbu i mislim da će ovo jedan doprinos biti od strane naše grupe. Toliko od nas. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Tani në radhë janë deputetët. Deputeti Rexhep Hoti e ka fjalën.

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja e zotërinj,

Meqë sot nuk e keni shfrytëzuar foltoren, shfrytëzova rastin ta bëj unë dhe më vjen keq që sot nuk kemi qenë në opozitë, ta shkundim një herë, sepse buxheti është gjithmonë ditë e shënuar.

Ndër prioritetet e institucioneve të Kosovës, pas shpalljes së Pavarësisë, mund t'i cekim realisht 6 prioritetet me të cilat krenohet edhe opozita dhe pozita

1. Menaxhimi i pavarësisë, është një fakt i njohur për të cilën të gjithë e pranojmë.
2. I dyti është menaxhimi i buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe i parasë publike,
3. Kisha të them funksionalizimi i institucioneve të Kosovës dhe autonomia e tyre,
4. Integrimi i një pjese të rëndësishme të minoriteti serb në institucionet e Kosovës,
5. Formatizimi dhe strukturimi i ligjeve, pra puna e juaj në kuptimin sasior dhe në kuptimin cilësor në pajtim me Bashkimin Evropian, dhe
6. Avancimi i demokracisë dhe i parlamentarizmit, në veçanti në Kuvendin e Kosovës.

Në lidhje me raportin vjetor të financave, kisha me thënë se është me rëndësi t'i cekim tri momente. Momenti i parë, me të cilin ne e shikojmë punën e këtij raporti, është kriza globale, domethënë, ne po e shikojmë një raport në një qastë kur kemi një krizë globale, kur kemi shtete të Bashkimit Evropian të bankrotuar realisht, madje ka qenë propozim ekstrem deri aty sa është propozuar që një shtet i Bashkimit Evropian, ndoshta të shitet. Moment tjetër i rëndësishëm për mendimin tim që vlen të theksohet është, për herë të parë buxheti i

konsoliduar i Kosovës nga viti 2008 e këndeje, është buxhet i prekshëm për çdo qytetarë të Kosovës. Më në fund çdo qytetarë i Kosovës e ka kuptuar se Kosova ka një buxhet, ka para për të investuar dhe për të ecur përpara. Kjo shihet në shumë drejtime, veçmas në infrastrukturën e rrugëve të arsimit dhe në aspektet tjera, po deri edhe te rritja e punësimit, domethënë është një element shumë i rëndësishëm i dytë në kontest për të cilën ne mund të flasim për buxhetin, raportin financiar për vitin 2009. Është edhe një element tjetër shumë pozitiv për mendimin tim, është tehu tepër kritik i opozitës apo edhe deputetëve të cilët themi nuk kanë anësi, por kanë mbetur pezull, e të cilët e kanë një hapësirë të pakufishme të flasin gjithçka.

Menaxhimi i politikave të tilla në një shtet të formuar vetëm dy vjet e diçka, do të thotë se Kosova është shtet i pjekur, realisht, është shtet që mund të menaxhohet realisht, është shtet që kontrollon parane e vet realisht, është shtet që e kontrollon policinë e vetë realisht. Madje në mënyrë shumë të argumentuar e dëshmon se institucionet e Kosovës kanë autonominë e vet në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe misioni i EULEX-it, i cili është në këtë kuptim për sundimin e ligjit, ka gjithë hapësirën e nevojshme për të vepruar, pavarësisht ndonjëherë nga tendencat dashamirëse ose dashakeqës të mediave, të cilat improvizojnë edhe pyetje se çfarë na ndodhë sikur kështu, çfarë na ndodhë sikur kështu, nuk do të ndodhë asgjë. Kosova ka 100 vjet që e kërkon shtetin e vet dhe ka vajza dhe djem shumë serioz të cilët e respektojnë shtetin, në këtë rast edhe parane e saj.

Tash, si të gjithë ju, ne mundemi t'i lexojmë disa të arritura në kuadër të raportit vjetor financiar. Shtimi i të hyrave për 22% dëshmon se megjithatë në krahasim ne kemi mësuar se hartimi i raporteve vjetore gjithmonë bëhet në krahasim me vitet paraprake, një. E dyta. Ekzistojnë rregullat e caktuara që nuk i kemi caktuar, nëse çka mund të thuhet në raport, pavarësisht se disa njerëz që dëshirojnë të kenë shumë më tepër, kërkojnë edhe hollësi tjera, por ne duhet ta kuptojmë brenda rregullave të lojës se sa mund të paraqitet një raport. Vetë fakti se përjashtohen dy segmente, të darkave dhe të, nëse nuk gaboj të udhëtimeve. Të gjitha aspektet tjera në kuadër të hyrjeve dhe daljeve...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hoti! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Raporti financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009, sipas vlerësimit tim është dashur të shqyrtohet në Kuvend para dy muajve, sepse Ligji për financat publike dhe përgjegjësitë, në nenin 46.1, kërkon që jo më vonë se më 31 mars të çdo viti kalendarik, ministri të përgatisë dhe t'i dorëzojë Qeverisë për miratim dhe dorëzim në Kuvend raportin përfundimtar të buxhetit. Ne jemi dy muaj pas, jemi më 10 qershor të vitit 2010 dhe jemi shumë vonë, realisht kemi thyerje të ligjit.

Tjetra është se pasqyrat financiare të dorëzuara, të cilat i dëgjova me vëmendje se si i paraqiti ministri, thashë që janë mrekullia vetë. Nga një mënyrë ashtu siç janë paraqitur, japin përshtypjen se janë përmbushur të gjitha kërkesat dhe standardet ndërkombëtare të raportimit të kontabilitetit për sektorin publik. Në të vërtetë, raporti është rutinor, ku tregohet mënyra e paraqitjes së pasqyrave financiare. Pra, me një fjalë, kjo është deklarata financiare.

Meqenëse nuk është shqyrtuar me kohë, propozoj që këto pasqyra financiare të Qeverisë së Kosovës të sillen në diskutim në Kuvend, në harmoni me nenin 47.1 të Ligjit për menaxhimin e financave publike, i cili përcakton dorëzimin e raportit në Kuvend nga ana e Auditorit të Përgjithshëm, që deklaratat financiare të organizatave buxhetore vërtetojnë a janë pasqyrë e vërtetë dhe e drejtë e financave të organizatave buxhetore.

Ky raport, pra, duhet të dorëzohet deri më 31 korrik, po ashtu edhe Raporti i Auditorit të Jashtëm të buxhetit, në pajtim me nenin 48 të Ligjit për menaxhimin e financave publike. Pasi që auditorët të japin mendimin e tyre, atëherë duhet të sillen në Kuvend raportet dhe nëse konstatimi i auditorëve thotë se raporti i Qeverisë është i përpiluar në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik, atëherë mund të aprovohet raporti i Qeverisë, por vetëm pasi të kemi raportin e auditorit.

Pra, sot propozoj që vetëm të shqyrtohet, por nuk mund të miratohet, sepse vërtetësia dhe saktësia e numrave të paraqitura duhet të vërtetohen nga auditorët. Kështu si janë, nuk janë të verifikueshme. Për shembull, janë shkruar se shpenzimet kapitale janë 406.382.000 euro. A janë këta numra të saktë, apo 383.000.000 euro para të gatshme në fund të vitit, pra kjo nuk tregon se a ka pasur kontrata të nënshkruara të papaguara.

Faturat e papaguara, aneksi 7, janë 4.101.619 euro, domethënë se janë në borxh që të dy nivelet, edhe niveli komunal, edhe niveli qendror. Prandaj, për arsyet të cilat i përmenda, sot nuk do ta miratoj raportin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj, nëse është këtu. Nuk është, atëherë deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministër i Financave,

Ministra të nderuar,

Sot po e shqyrtojmë raportin e shpenzimeve apo pasqyrat financiare për vitin 2009, t'ju thënë të drejtën edhe parafolësit edhe kolegu deputet Naser Osmani, e tha në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, por desha t'i ndajë disa pyetje, ndoshta me ministrin. Po të ishte kryeministri, do të ishte edhe më mirë, por sigurisht ato çka na preokupojnë edhe çka i shohim të arsyeshme t'i debatojmë sot.

Mbetet e qartë se shihet edhe nga raporti, por edhe nga viti fiskal të hyrat prapë më të mëdha mbesin nga doganat dhe, edhe pse një rritje e lehtë, domethënë me shumë edhe nga Administrata Tatimore, po prapëseprapë ky trend i zhvillimit pothuaj se po shkon në formë të njëjtë se mbushësit më të mëdhenj të buxhetit po mbesin nga doganat.

Edhe pse është e kënaqshme rritja e shpenzimeve kapitale prej 50.000.000, krahasuar me shifrat tjera, mbetet ndoshta m pak e dëshirueshme, duke marrë parasysh vetëm një shkas. Edhe në vitin 2009, për paga dhe mëditje kemi përafërsisht 300.000.000 euro të shpenzuara dhe në këtë rast akoma ne edhe si Kuvend edhe si Qeveri, nuk po mundemi ta bëjmë një harmonizim të pagave në institucionet tona. Kjo është parë edhe nga raporti, tash vetëm nga deklaratimet financiare që i ka bërë Ligji për deklarimin e pasurisë të zyrtarëve të lartë, sepse deri me tani ne shumicën e pagave të njerëzve kompanive të ndryshme publike dhe agjencioneve tjera që paguhet nga buxheti i Kosovës, vetëm tani i kanë bërë të qarta për publikun por edhe për Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe 172.000.000, që janë të tjera, po shpenzime, shërbime komunale që në total krahasuar me shpenzime kapitale prapë se prapë e mbulojnë dhe kjo mbetet për t'u përmirësuar, duke marrë parasysh që ne dëshirojmë një zhvillim ekonomik të vendit tonë.

E tha edhe ministri që në programin e Qeverisë, krahas programit të Qeverisë të miratuar këtu në Kuvendin e Kosovës, zoti i Qeverisë për racionalizim të shpenzimeve, të gjitha shpenzimeve.

Unë edhe nga tabelat e paraqitura por edhe ndoshta nga ndonjë shembull që mund ta marrim sepse nga ato dhe çka na u kanë afruar nga raporti sipas ligjit. Mallra dhe shërbime kemi një rritje edhe në buxhetin e vitit 2009, por edhe me rishikimin që e kemi bërë, dhe tash po e marrë vetëm një shembull të shpenzimet e marketingut. Ndoshta mund të jetë edhe shembull banalë por këtu është rritje dhe sigurisht është edhe nga një rritje për shembull mos ta përsërisë për festat zyrtare kryeministri i Kosovës në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në emër të ministrave ua uron qytetarëve ndonjë prej festave zyrtare. Cila është arsyeshmëria që çdo ministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, çdo kryetar komune t'ia urojë bajramin qytetarëve të Kosovës me nga një faqe në gazetë me fotografi të vet me emër e mbiemër e cila kushton duke marrë parasysh çdo gazetë edhe po ta bëjmë të total nga 250 euro faqja, 10 gazeta 2500 euro, 11 festa zyrtare, domethënë 30 mijë euro në vit. Pra, ky ka qenë shpenzim edhe mbetet për mua shpenzim i paarsyeshëm që në të ardhmen besoj, sepse i pari i Qeverisë flet në emër të Qeverisë dhe të ministrave, presidenti flet si president i vendit, dhe kryetari i Kuvendit në emër të gjithë deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës. Dhe ndoshta këtu duhet të shihet në të ardhmen një racionalizim apo ne do ta shohim të ardhmen, sepse nuk do të ketë nevojë për rritje në këtë aspekt për mallra dhe shërbime, sepse e kemi parë zotimin për këtë racionalizim të këtyre shpenzimeve dhe kemi pasur edhe tjetrin zotim, ndoshta që dikush ka qenë e nevojshme s'po ndalem ose të blerja e makinave ku ka ndodhur në vitin 2009 blerja e makinave nga disa ministra që nuk kanë pasur nevojë fare të blejnë makina.

Prandaj, këto mbeten, për diskutim në të ardhmen tash edhe shpejt vjen edhe përgatitja e buxhetit për vitin 2011 dhe sigurisht do ta kemi parasysh.

Unë e kam vetëm një pyetje, zotëri ministër, edhe kjo ka të bëjë me rritjen e të hyrave apo me atë që ne i quajmë mjete të pritura. Borxhet ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, nëse në fund do ta kesh rastin për përgjigje dhe sigurisht do ta kesh- cila është politika e Qeverisë, Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për mbledhjen e këtyre borxheve duke marrë

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Driton Tali

DRITON TALI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë,

Unë për shkak se shumë gjëra u thanë deri më tani, për të mos i përsëritur ato që u thanë, do të flas pak për efikasitetin e Qeverisë, gjithmonë duke iu referuar këtyre, këtij raporti që na është dhënë dhe atë që fillimisht e tha zoti ministër, por edhe zoti kryeministër e tha në raportin e tij para... që e bëri në mëngjes një të dhënë, lidhur me efikasitetin e Qeverisë me të mirat që i ka bërë Qeveria dhe shtrohet pyetja pse u ndërruan ministrat, por edhe atë që zoti ministër e tha në fjalimin e tij më vëri në dyshim se a i kemi raportin e njëjtë apo jo?

Sidoqoftë unë do ta marrë për të treguar raportin apo efikasitetin e Qeverisë apo edhe të ekonomisë, raportin e të hyrave doganore në të hyrat e përgjithshme apo edhe ato karshi Administratës Tatimore për të treguar se çka ka bërë Qeveria në përmirësimin e ekonomisë gri, por edhe sa ka pasur impakt rritja ekonomike realisht në buxhetin e Kosovës.

Po shohim se raporti i të hyrave në kufi dhe, siç e thashë, se më kanë humbur...! Po, do të shohim se përqindja e kontributit të doganave është i njëjtë nga viti 2007, në vitin 2009, ndonëse në vitin

e fundit kemi një ngritje prej 2.68% nga viti 2008, pra kur në vitin 2008 ishte 75.08%. Pra, del se në vitin 2009 përkundër rritjes ekonomike bizneset kosovare kanë paguar 2.68% më pak tatim, domethënë, nga 24.95%, sa ishte kontributi në vitin 2008, në vitin 2009 ra në 22.26%. Dhe këtë mund ta shohim edhe në faqe, domethënë, në vitin 2008 kemi 200 milionë e 834.000 euro të cilat i pagoi biznesi në ekonominë e brendshme, gjersa në vitin 2009, 181 milionë e 659. Dhe tash shtrohet pyetja se ky 4.4% a pat në realitet rritje ekonomike dhe kjo rritje ekonomike sa pat efekt në rritjen e buxhetit, sepse në rritjen ekonomike nënkuptohet rritja e intensitetit të aktiviteteve afariste dhe rrjedhimisht rritjen, domethënë, të profitit të ndërmarrjeve dhe kjo rritje e profitit të ndërmarrjeve është dashur të reflektohet në buxhet. Por nuk ka ndodhur kështu, madje-madje kemi edhe një ndryshim fiskal të cilin nëse e shikojmë transkriptin e 15 dhjetorit 2008, atëherë kur Qeveria me mish e me shpirt tentonte që të na binte se ndryshimi fiskal do të sjellë edhe përmirësime fiskale, domethënë, do të rritet buxheti bile, ndër të tjera, zoti ministër, po e citoj nga transkripti, është marrë nga faqja 43, pat thënë se ulja e tatimit në korporata do ta zgjerojë bazën tatimore dhe do t'i stimulojë bizneset që ato të paguajë më shumë tatim, por kjo nuk po del si e tillë. Dhe tash shtrohet pyetja se këto 400 milionë të cilat u investuan në infrastrukturën publike dhe ky ndryshim fiskal çfarë efekti pati në buxhet? Këtu nuk tregohet se ka pasur kurrfarë efekti, zoti ministër dhe është një diçka që ju duheni ta rishikoni strategjinë e juaj apo nëse e keni me qëllim që Ferronikelit edhe më tutje t'i bëni favore tash fiskale, edhe rrymën po ua japim pa para, por edhe tatim të paguajnë ata më pak, është çështje tjetër...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Tali! Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Unë nuk do ta zgjas shumë për shkak se do të mund t'i përsëris ato çka i thanë diskutuesit paraprak, kolegët deputetë, mirëpo raportin të cilin po e shqyrtojmë sot shihet se është i hartuar në përputhje të plotë me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë si dhe me standardet më bashkëkohore të kontabilitetit. Dhe, me këtë rast do të dëshiroja që ta përgëzoj Qeverinë e Republikës së Kosovës në përgjithësi dhe Ministrinë e Financave në veçanti për rritjen e performancës në menaxhimin e buxhetit dhe në akumulimin e tij. Ajo çka shihet dhe do të na përcjell edhe në të ardhmen është se pjesa dërrmuese e buxhetit akumulohet në dogana, kjo do të jetë edhe në të ardhmen për shkak të deficitit të madh tregtar që e ka vendi ynë, por që ka rritje në të gjithë sektorët e grumbullimit të buxhetit. Po ashtu, Qeveria apo Ministria ka treguar edhe një nikoqirllëk të mirë në menaxhimin e buxhetit dhe në shpërndarjen e tij. Kemi rritje të pagave në sektorin publik si në arsim, në shëndetësi, në polici, kemi investime të shumta në krahësim me vitet e kaluara, investime kapitale dhe mbase përherë të parë qytetarët e Republikës së Kosovës janë duke i parë mjetet e tyre të cilat janë duke iu kthyer, duke iu kthyer në kuptimin e investimeve, prandaj unë nuk do ta zgjas më shumë, raporti është shumë i pranueshëm dhe do të dëshiroja që Qeverisë dhe Ministrisë së Financave t'ia adresoj komplimentet dhe të vazhdojë me këtë rritje të performancës në menaxhimin e financave publike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj!

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje ministra,

Përshëndetje kolegë deputetë,

Vërtet ka për t'u thënë shumë në vazhdimësi kur është në pyetje shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës meqenëse është fjala për një shqyrtim para auditimit të këtij raporti, sa i përket mënyrën së menaxhimit dhe procedurave, sigurisht do të japë kontributin e vet auditori, mirëpo sa i përket shqyrtimit mbi shpenzimet dhe të hyrat vlen të theksohet një çështje.

Sa i përket sfidës së metodologjisë së ndërtimit të buxhetit të Republikës së Kosovës mendoj se me këtë buxhet, me këto pasqyra buxhetore që i kemi të 2009 e kemi kaluar sfidën e ndërtimit të buxhetit në aspektin e standardeve duke u mbështetur edhe në buxhetin që e bëjnë edhe vendet e tjera, andaj vlen për t'u përshëndetur në aspektin e ndërtimit, respektivisht aspektit formal të buxhetit. Në aspektin e sfidës kohore dhe në aspektin e sfidës së participimit këtu kemi përparime në krahasim me buxhetet paraprake, sepse edhe planifikimet në zërat e shpenzimeve edhe planifikimet që janë bërë në zërat e të hyrave janë më detale dhe në aspektin e pjesëmarrjes së agjencioneve buxhetore shihet se ka qenë mjaft i përafërt aspekti midis shpenzimeve të realizuara dhe shpenzimeve të planifikuara, çka do të thotë se të gjitha agjencionet buxhetore, duke përfshirë edhe ato që janë si agjencione të rregullta që nuk ka ndryshime në aspektin e shpenzimeve nga vitet e kaluara deri te ky vit shihet një përafrim shumë i madh midis atyre shpenzimeve të planifikuara dhe atyre të realizuara që vlen të përshëndetet ndërsa në aspektin e planifikimit të hyrave vërtet ende kemi një diskrepancë në raport midis të hyrave të planifikuara brenda Kosovës, respektivisht nga agjencionet dhe faktorët apo zërat e të hyrave apo administrata që realizon këtë komponentë brenda kufijve dhe të atyre të realizuar në kufi.

Edhe pse vlen të theksohet se 2009 në krahasim me periudhat e kaluara në aspektin e mbledhjes apo grumbullimit në kufi në raport me mbledhjet apo shfrytëzimin e kapaciteteve të Administratës Tatimore në Kosovë vlen të theksohet se ka përparime, prapë mendoj se buxhetin e konsoliduar të Kosovës prapë duhet ta preokupojë Ministrinë e Financave, respektivisht Administratën Tatimore ta preokupojë ky fenomen midis mbledhjes në kufi dhe mbledhjes brenda, duke marrë parasysh se këto mjete vërtet që mbledhen në kufi, qoftë nga TVSH-ja, qoftë forma tjera, në fakt janë financim që bëjnë bizneset kosovare e financojnë buxhetin e Kosovës në mënyrë anticipative, më përpara pa u krye apo pa u realizuar, qoftë si tregti, qoftë si prodhime, andaj këtu vlen për t'u dëshiruar. Në kuptimin e sfidës midis shpenzimeve kapitale dhe shpenzimeve për mallra, shërbime, paga e të tjera këtu veç është tejkaluar duke marrë parasysh se kemi shumë zëra të rinj të shpenzimeve, duke marrë parasysh numrin e ri që kemi pasur të ministrive, mandej zhvillimin e kapaciteteve në agjencitë buxhetore, qoftë në aspektin e rritjes së kapaciteteve tekniko- teknologjike që normalisht bartin shpenzime, qoftë në forma tjera del se treguesi apo raporti midis investimeve kapitale dhe investimeve të tjera është në vija shumë të lakmueshme në kuptimin e sugjerimeve që i bën sot Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Ndoshta edhe kjo është sfida më e madhe sot që ne kontrollohemi nga FMN-ja, duke marrë parasysh kërkesën gjithnjë në rritje të rritjes së të ardhurave personale të punëtorëve të administratës, të punëtorëve të agjencioneve në përgjithësi buxhetore që vërtet është e ulët, mirëpo në krahasim me rritjen ekonomike dhe buxhetin mjaft të varfër të Kosovës shihet se edhe këtu ka lëvizje pozitive që nuk kanë ndikuar fare negativisht në rritjen e shpenzimeve kapitale. Unë i preka vetëm disa çështje edhe pse

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit! Shumë gjëra u thanë por unë do të jem shumë konkret dhe i drejtpërdrejt, sepse ministri raportoi diçka që unë s'kisha për t'u pajtua me të, sepse raportoi se

kemi të hyra diku 20 e diçka për qind më shumë, që realisht nuk është e saktë. Të dhënat tregojnë se kemi 946.817.000, se dividendat e PTK-ës 200 milionë nuk mund të thuhet se është ndonjë kontribut i Qeverisë. Ato janë para të mbledhura nga djersa e punëtorëve vite me vite, ndoshta edhe një dekadë prej 10 viteve dhe tani janë deponuar ka rastësisë që do të ndodhë në vitin 2009. Me fjalë të tjera, është një manipulim para opinionit publik. Realisht, janë rritur të hyrat buxhetore për 0.4553%, as 0.5%. Domethënë, as 0.5%, ministër!

Pra, për t'u rritur autputi apo prodhimi duhet edhe imputet, imputet duhet të jenë më të ulëta se amputet për të pasur fitim apo efikasitet. Ministër, për efikasitete financiare duhet të njëjtën punë ta kryejmë sa më lirë që mundemi, ky është efikasiteti financiar. Këtu të dhënat tregojnë që e kemi të kundërtën, s'mund të flasim për efikasitet, sepse në rroga dhe paga kemi rritje 16.42%, që me fjalë tjera me më shumë njerëz, me më shumë burime njerëzore e kemi bërë, dhe 16.42%, gati 17% dhe kemi mallra dhe shërbime, me fjalë të tjera mjete, kemi rritje 8.89%. Me fjalë të tjera ke 0.45% rritje në imput me rritje në të hyra me energji të futur shumë më të madhe, me të hyra 17% në njerëz dhe 9% në mjete. Më shumë zarar se hair.

Po, edhe tash do të vazhdoj deri te faqja, kjo është kërkesë e drejtpërdrejtë që iu drejtohet juve, zoti ministër, në të njëjtën faqe ke letrat me vlerë për Qeverinë, i ke 266 milionë. Kisha kërkuar që të jeni shumë të saktë, shumë të saktë... Ku janë mbajtur dhe, ju lutem, të tregoni se me çfarë kuponash, çfarë janë investuar, në cilën ndërmarrje, shtet janë blerë, me cilat letra me vlerë, në cilin shtet apo cilën ndërmarrje, që të kemi ne më të lehtë të kontrollojmë se çka me të vërtetë po ndodh me paranë publike në qarkullim të Kosovës. Normalisht që Ministria e Financave dhe e Ekonomisë i ka marrëdhëniet e veçanta, ndoshta edhe ministri me drejtorin e Bankës Qendrore dhe, nëse Ministria nuk e di, Banka Qendrore sigurisht duhet ta dijë dhe ta shikojmë ne, sepse këtu nuk keni treguar, s'e keni futur asnjë cent kamatë. Prej 266 milionëve, ndonjë cent kamatë ndonjëherë është dashur të figuronte në pasqyrat financiare që na i keni paraqitur.

Gjithashtu, unë do të ndalem edhe shkurtazi në shpenzime, sepse vitin e kaluar kur kemi pasur telashe me kalimin e buxhetit, ju patët deklaruar publikisht se keni ftuar Komisionin për Buxhet dhe Financa në një drekë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe sigurisht se kjo drekë u pagua prej parasë prej buxhetit të Kosovës dhe ka ndikuar që vija buxhetore për drekë a për darka dhe për shpenzime tjera të rritet. Nëse veç ne tentojmë të instalojmë një qeverisje të mirë, atëherë këtu ishte dashtë të jetë e kundërta, të zvogëlohet... Edhe nëse ka paguar prej xhepi, s'kishte qenë mirë, sepse kishte për të qenë tendencë për korrupsion, kishte për të qenë e dënueshme kështu....

Dhe, gjithashtu ministër, unë do ta vë në diskutim, në aneksin që ju keni paraqitur të dhënat për trasnferet nga Fondi rezervë i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Këto "contingency planning", këto në fondet rezervë, këto para sigurisht nuk kanë destinim paraprakisht të ditur, unë jam shumë i sigurt që ju e keni ditur se dita e pavarësisë është më 17 shkurt dhe s'ka pasur nevojë të dalin prej fondit rezervë 150 mijë euro, se është ditë e shënuar dhe e kemi ditur se ne do ta festojmë. Gjithashtu, edhe nëpër të gjitha këto shpenzime që kanë ndodhur nga Fondi rezervë i ministrit, nga fondet që ju keni të drejtë, keni të drejtë të harxhoni, por me një arsyetim pse nuk kanë qenë të planifikuara fillimisht. Nuk kisha për t'i ngritur këto shqetësime sikur Qeveria e Kosovës mos të akuzohej publikisht dhe të ngriteshin shqetësime se janë keqmenaxhuar paratë gjatë menaxhimit të shpalljes së pavarësisë. Në një rast, kur dikush ngrit dyshime për keqmenaxhim të parasë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rrustemi! Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Raporti vjetor financiar i buxhetit për vitin 2009 është në përputhje me përkufizimet juridike që i jep Ligji mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi si dhe është në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik. Nga njëra anë ky raport ka adresuar nevojat e ekonomisë së vendit, ku ruajtja e nivelit të lartë të shpenzimeve kapitale synon krijimin e një ambienti stimulues për investime private, ndërsa nga ana tjetër është respektuar parimi i ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale. Kjo do të thotë se të hyrat e vlerësuara buxhetore janë mbledhur sipas parashikimit. Po ashtu është arritur që të ruhet bilanci i akumuluar bankar.

Raporti është punuar dhe dorëzuar në kohë ashtu siç parashikohet me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi. Po ashtu është i punuar sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, çka do të thotë se raporton për kriteret e klasifikimit organizativ, klasifikimit ekonomik dhe klasifikimit funksional. Në raport mund të shihet buxheti i aprovuar në fillim të vitit, rishikimi i buxhetit si dhe buxheti i cili është aktual në sistemin informativ të menaxhimit të financave në Kosovë.

Në raport është bërë po ashtu prezantimi i detajizuar i të hyrave të realizuara, shpenzimeve të realizuara për vitin 2009 si dhe shpenzimeve sipas karakterit ekonomik për kode ekonomike për vitin 2009. Pasqyra e granteve të donatorëve që kalojnë përmes buxhetit të konsoliduar të Kosovës si dhe raporti i pasqyrave financiare, këtë vit përmban edhe të dhënat e detajizuara lidhur me shpenzimet nga rezerva e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Nëse krahasohen të hyrat e përgjithshme të vlerësuara me të hyrat e realizuara për këtë periudhë është 99.2%, që është një realizim i kënaqshëm sipas planit vjetor për vitin fiskal 2008, të vlerësuara që të mbledheshin ishin 989.1 milionë, ndërsa të realizuara për periudhën janar-dhjetor 2008 ishin 942.5 milionë euro, krahasuar të hyrat e grumbulluara për janar-dhjetor të vitit 2008 me vitin 2009 gjendja është për 5% më mirë se sa në vitin 2008. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Basri Musmurati.

BASRI MUSMURATI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, fillimisht, po ministri paska dalë jashtë, po më duket, kisha për ta përgëzuar sikur këtë material që na e ka dhënë në raport ta kishin bërë si libër, do të ishte më mirë, ndoshta edhe në këtë drejtim kanë kursyer pak para publike.

Në këtë raport që e kemi sot për shqyrtim, është e vërtetë se është bërë një punë relativisht e mirë e Qeverisë në planifikimin e buxhetit, ashtu edhe në realizimin e tij dhe në shpenzimet adekuate që janë bërë.

Në këto pasqyra tabelare që janë këtu, ka besoj mjaft të dhëna, që flasin për grumbullimin dhe shpërndarjen e buxhetit në vitin 2009. Nëse buxheti i vitit 2009 është në rritje në krahasim me atë paraprak, atëherë mund të themi se është bërë një punë relativisht e mirë e Qeverisë në këtë drejtim.

Unë po ndalem në disa çështje konkrete. Për shembull, në dogana kemi një rritje të hyrave për vitin 2009, në krahasim me vitin 2008 diku për një 30 milionë, mirëpo është një disproporcion

mes planifikimit dhe realizimit, dallimi është diku rreth një 10 milionë euro. Edhe në shpenzimet kapitale ka defekt sa i përket raportit në mes planifikimit dhe realizimit. Edhe pse realizimi në 2009 krahasuar me atë të vitit paraprak është më i madh diku për 15.3% ose në milionë euro është 53 milionë, është një disproporcion në këtë drejtim dhe është dashur që kjo të mos të na ndodhë pikërisht të shpenzimet kapitale. Në këtë drejtim mendoj se faktikisht në bazë të planifikimit kanë mbetur pa u realizuar diku një 98 milionë euro, që nuk janë investuar në shpenzimet kapitale dhe kjo është mjaft e dëmshme dhe në këtë drejtim mendoj se ndoshta shpeshherë arsyetohen me pengesat e atyre procedurave që janë bukur të komplikuar të prokurimit.

Një çështje tjetër ka të bëjë me të hyrat vetjake të komunave dhe komunat në këtë drejtim kanë ecur mjaft mirë. Të gjitha komunat në raport me vitin paraprak kanë bërë një avancim shumë të mirë të hyrave të tyre vetjake me përjashtim të tri komunave që janë, aty kanë mbetur mbrapa Gjakova sa e di unë, është Mamusha dhe Obiliqi, ndërkaj për këto komunat me popullatë serbe atje, në pjesën veriore të Kosovës si janë: Leposaviqi, Zubin-Potoku dhe Zveçani atje fare nuk janë mërzitur që të sigurojnë diçka dhe të grumbullojnë mjete të tyre.

Një çështje tjetër që më duket se ende vazhdon të jetë prezentë në një pjesë të njerëzve tanë në institucione janë avanset e paarsyetuara në disa organizata buxhetore. E di se shpesh ka arsytet të ndryshme, ndonjëherë edhe me vend, por nuk duhet lejuar që kjo të bëhet shprehi graduale sikur se ka filluar të bëhet. Ma merr mendja se nuk është aspak e nevojshme që Ministria e Shëndetësisë në vitin 2009, t'i ketë të paarsyetuar 86 mijë euro të avansit për udhëtime zyrtare, ose Ministria e Punëve të Brendshme 27.343 euro, Ministria e Forcës së Sigurisë, 22.500 e diçka euro, dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 19 mijë e 69 euro. Këto janë avanse të cilat nuk janë arsyetuar. Unë i mora shifrat vetëm te ato njësi buxhetore, të ato organizata të cilat kanë mbi 10.000 euro.

Të nderuar kolegë deputetë, mendoj se ky raport vjetor financiar i buxhetit të Kosovës, jo i buxhetit të konsoliduar të Kosovës sikurse po e thotë dikush, më duket se është dhënë mjaft realisht, bile më duhet ta përgëzoj hartuesin me këtë rast Qeverinë që ka pasur kurajë të paraqesë gjendjen sa më të përpiktë, madje edhe duke i potencuar të metat evidente që janë të pranishme në këtë raport, sepse ata zakonisht, kur hetohen të metat ose i anashkalojnë ose i lustrojnë disi, i fshehin. Në këtë drejtim Qeveria ka bërë mirë që këto i ka paraqitur mjaft realisht.

Mendoj se perspektiva e Qeverisë është kryesisht atëherë kur....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sigurisht që shumica e vërejtjeve ose e vlerësimeve pozitive për raportin u dhanë nga parafolësit dhe jo shumë me gjuhën e profesionistit, por me gjuhën e një vrojtuesi veç të vëmendshëm vërehet se raporti në fjalë nuk mund të konsiderohet si raport i racionalizimit të një buxheti të varfër të një shteti të vogël dhe të varfër po ashtu, pastaj edhe kualifikimet që dha ministri për efektet, përkatësisht të ndikimit të krizës globale financiare dhe paprekshmëria e kësaj krize në ekonominë e Kosovës mendoj që nuk i shkon një profesionisti të flas kështu drejt dhe natyrisht unë e di që Qeveria flet fjalë afirmative për raportet e veta, por jo gjithherë pa mbulesë përmbajtësore profesionale.

Unë kam vërejtje të mënyra sepse zakonisht kemi dëgjuar fjalë nga Qeveria se kjo Qeveri po e racionalizon atë buxhet edhe ashtu të vogël dhe të varfër të Kosovës dhe ky raport që e kemi para veti nuk na jep një pasqyrë të tillë përkatësisht nuk na jep të drejtën me dalë me këso konstatimesh për mua janë shifrat për pajisje për shembull, në radhë të parë të shërbimet dhe mallrat, kemi rritje të shpenzimeve për udhëtime zyrtare shumë në vitin 2009, unë i kuptoj që shteti i Kosovës ka pasur nevojë të jetë më prezent jashtë, por jo për shumatat shumë të mëdha, sepse vështirë se është shpërndarë, janë shpërndarë këto shpenzime për të gjitha institucionet sipas nevojave si të them imperative që i ka pasur shteti i Kosovës të përfaqësohet jashtë, pra i bie që disa ministri dhe disa segmente të Qeverisë kanë shkuar shumë dhe disa fare pak ose hiq, pastaj qiraja prapë shënon një rritje edhe pse kjo Qeveri është zotua se do ta ulë dhe do ta bie në zero qiranë, mirëmbajtja prapë në kategorinë e shpenzimeve dhe mallrave do të thotë janë shuma të mëdha që jepen për mirëmbajtje e që nuk specifikohen shumë, jepet një referencë në fund por mjaft e përgjithësuar dhe po ashtu shqetësuese janë edhe shpenzimet kapitale që kanë rritje, shënojnë rritje të mëdha për do fusha që ne nuk i shohim shumë efektet përkatësisht nuk i prekim ato investime në objektet të cilat thuhet, për shembull të pajisjet e teknologjisë informative kemi gati trefishim të investimeve në vitin 2009 që për mua është mjaft indikative se me shumatat që janë prezantuar këtu ka mundësi që e gjithë Kosova të mbulohet me një rrjet të internetit dhe të ketë në njëfarë mënyre qasje në internet edhe në fushë edhe në livadh dhe prej ku të duash dhe jo që të thuhet se janë pajisur shkollat me internet sepse janë shuma shumë të mëdha dhe teknologjia informative, kostoja e saj, është në rënie. Domethënë si çmim.

Pastaj, te automjetet e transportit, mendoj që edhe qeveritë pararendëse edhe kjo Qeveri gjatë vitit 2008 ka investuar shuma të mëdha dhe po ashtu viti 2009 na del vit me shumë shpenzime në këtë kategori të shpenzimeve kapitale për të cilat s'mundemi me i quajt ndryshe veç jo racionalizim i mirë se Kosova nuk besoj që e ka luksin me i ndërrua veturat çdo dy vjet për derisa shtetet që na ka rënë me i vizitua që kanë ekonomi shumë të konsoliduar dhe të hyra dhe GDP shumë të lartë shërbehen me vetura dhjetë vjet të vjetra dhe janë krejt normale sepse i plotësojnë kushtet natyrisht me një mirëmbajtje të mirë.

Ajo që në një kategori jepen shpenzimet tjera kapitale ka një rritje domethënë prapë më shumë se 100% dhe që hyn, domethënë prapë shpenzime për të pa specifikuar mirë por mjaft të përgjithësuar jepen një ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes të gjithëve që jeni prezent këtu në sallë!

Sot kur po e trajtojmë raportin financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 padyshim mund të jemi mjaft të inkurajuar për të ardhmen e vendit tonë duke u bazuar në performancën e Qeverisë, në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit që e ka bërë gjatë vitit 2009.

Unë mund t'ju them se në vitin e krizës globale dhe recesionit ekonomik në botë Qeveria e Kosovës ka arritur t'i ruajë treguesit makro-ekonomikë, ekuilibrat socialë, të bëjë investime kapitale dhe të rrisë në këtë mënyrë shkallën e punësimit në Kosovë dhe duke u nisur nga këto dhe shumë suksese tjera, mund të themi se përkushtimi, kapacitetet profesionale të kësaj Qeverie nuk kanë munguar për vitin 2009.

Ajo që më impresionon mua si deputet i Kuvendit të Kosovës, është planifikimi dhe realizimi i buxhetit, realizimi mbi 99% i planifikuar i buxhetit për vitin 2009, të hyrat 22% më të mëdha se në vitin paraprak, ulja e taksave në pakon fiskale për 50% dhe megjithatë të hyrat buxhetore të jenë 22% më të mëdha, investimet kapitale 15% më shumë se në vitin paraprak, kjo do të thotë se në vitin 2008, përkundër krizës globale dhe recesionit ekonomik që ka mbretëruar në botë, pastaj ruajtja e treguesve makro-ekonomikë dhe asistenca sociale për personat, përkatësisht familjet në nevojë me mbi 250 milionë euro në vit subvencione të cilat e radhitin Kosovën përkrah shteteve perëndimore të cilat bëjnë përpjekje t'i zbusin problemet sociale në shoqëri.

Unë mund të ju them se këto subvencione në krahasim me buxhetin kaq të larta, megjithatë nuk janë të mjaftueshme për qytetarët e Kosovës, por si do qoftë qytetari i Kosovës e ka ndier dorën e shtetit gjatë periudhës që po e lëmë, përkatësisht gjatë vitit 2009 dhe shpresojmë se kështu do të jetë edhe në të ardhmen.

Duke pasur parasysh edhe rritjen e pagave në përgjithësi të të gjithë të punësuarve në Kosovë, me mbi 20% në total dhe 40 deri në 60% në sektorë të caktuar të administratës, mund t'ju them se këto janë shpresëdhënëse që në të ardhmen vazhdimisht do të shënojnë edhe progresë të reja në këtë drejtim. Subvencionimet për bujqësi si dhe subvencionimet për barëra esenciale që kanë qenë gjatë vitit 2009, gjithashtu shprehin gatishmërinë dhe përkushtimin e Qeverisë që të përmirësohet ndjeshëm jeta e qytetarëve.

Duke pasur parasysh pastaj edhe investimet e mëdha në infrastrukturën rrugore si dhe në infrastrukturën shkollore, unë mund të them se mjetet janë shfrytëzuar me nikoqirllëk dhe ka mbretëruar përkushtimi dhe profesionalizimi në harxhimin e parasë publike, kurse këtu na anatemuan disa herë shpenzimet publike, për rritjen e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, unë mund t'ju them se vëllimi i punëve i cili është rritur gjatë vitit 2009 dhe aktivitetet e shtuara të Qeverisë, si në planin e brendshëm, ashtu edhe në atë ndërkombëtar, pa dyshim kanë ngritur edhe koston e shpenzimeve në mallra e shërbime, por megjithatë shpresoj se, siç u thanë edhe disa vërejtje dashamirëse këtu, në këtë drejtim mund të bëhen ndoshta edhe pak përmirësime, ndoshta edhe shkurtime të këtyre shpenzimeve. Unë do të votoj me kënaqësi raportin. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në raportin vjetor financiar të Buxhetit për vitin 2009, në mënyrë të detajuar janë të paraqitur pasqyrat financiare. Raporti në fjalë është teknikisht i përgatitur mirë, ka një strukturë shumë mirë të ndërtuar, është përmbajtjesor dhe në mënyrë analitike paraqet të gjitha të dhënat e parasë së shpenzuar. Mënyra e planifikimit dhe realizimit të buxhetit paraqet performancën e të gjitha institucioneve të Kosovës gjatë vitit 2009, në fushën e menaxhimit të parasë së taksa paguesve kosovarë.

Në tabelat e paraqitura në raport në përgjithësi gjatë vitit 2009 shihet se kemi një progres apo ngritje substanciale të buxhetit krahasuar me buxhetin e vitit 2008. Sa i përket të hyrave shihet se kemi rritje në segmente të caktuara dhe tejkalim mbi planin e paraparë, të hyrat e realizuara kanë qenë 99.2% nga të hyrat e përgjithshme të planifikuar, pa i përfshirë edhe grandet nga donatorët.

Ndërsa, krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje të hyrave prej 22%, që kjo është progresive dhe inkurajuese edhe për vitet në vijim.

Nëse bëjmë një krahasim të të hyrave nga doganat administrata tatimore dhe komunat shihet se te doganat krahasuar me vitin e kaluar kemi 29 milionë e 959 mijë euro apo 5% më shumë, administrata tatimore 3% më shumë nga planifikimi mirëpo krahasuar me vitin 2008 kemi 19 milionë e 175 mijë euro apo 9.5% më pak. Dhe ajo që është shumë inkurajuese të hyrat në komuna janë duke u rritur prej vitit në vit. Gjatë vitit 2009 të hyrat në komuna janë 12.87% më të larta krahasuar me vitin paraprak.

Të hyrat nga gjobat dhe licencat në raport shihet se kanë shënuar një rënie. Ajo që shihet në raport është mirë se të gjitha shpenzimet nuk i kanë tejkaluar në asnjë vi parashikimet e buxhetit të planifikuar.

Në faqen 24 janë disa gabime teknike që nuk përputhen shifrat me totalin. Në raport shihet qartë se kjo qeveri në projeksionet buxhetore prej vitit në vit ka shënuar ngritje kualitative në kategorinë e investimeve kapitale që është inkurajuese për një zhvillim më të mirë i cili ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mirëqenies së tyre.

Synimi i Qeverisë çdoherë duhet të jetë një planifikim real i buxhetit, menaxhim i mirë dhe i drejtë i shpërndarjes së të mirave materiale, e po ashtu të arrijë që grumbullimi i të hyrave të rriten në masën më të madhe që është e mundur me qëllim që ato të përdoren në mënyrë sa më racionale për të sjell efikasitet më të madh në realizimin e objektivave dhe të misionit të saj dhe për këtë e përgëzoj Qeverinë për punën që po bën. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetë tjerë... Ministri i Forcës së Sigurisë e ka një sqarim, zoti Mujota.

FEHMI MUJOTA: I nderuari kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Unë e falënderoj shumë deputetin Basri Musmurati që ka ngritur dy çështje të cilat kërkojnë sigurisht një sqarim dhe më jep mundësinë që të bëj një prezantim për buxhetin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë.

E para, duhet t'ju bëj me dije se Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës për vitin 2009, në buxhetin e aprovuar ka pasur gjithsej një vlerë prej 21.767.163 euro dhe ato sipas kategorive në paga dhe mëditje 5.639.000, në mallra dhe shërbime 4.000.000, shpenzime komunale 423.000 dhe në shpenzime kapitale 11.623.000. Shpenzimet e buxhetit për vitin 2009 janë gjithsej në vlerë prej 13.878.000 ose shprehur në përqindje 64% krahasuar me buxhetin e aprovuar. Shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike janë afërsisht ose saktësisht këto sipas shifrave. Në paga dhe mëditje 4.657.000, në mallra dhe shërbime 2.471.000, shpenzime komunale 234.000 dhe në shpenzime kapitale 6.515.000.

Shprehur në përqindje, në paga e mëditje kemi shpenzuar 83% ose 17% më pak se sa që është planifikuar, në mallra dhe shërbime kemi shpenzuar 61% ose 39% kursime në shpenzime të shërbimeve dhe mallrave, në shpenzime komunale 55% ose 45% kursim si dhe në shpenzime kapitale del se kemi shpenzuar 56% të asaj që kemi planifikuar në krahasim me buxhetin por kemi arsyetime më poshtë që ka bërë plotësisht të realizueshëm planifikimin tonë si Ministri.

Për këtë duhet t'ju bëj me dije se për Forcën e Sigurisë së Kosovës nga zyra e ish trupës së mbrojtjes së Kosovës, nga zyra e koordinatorit në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 janë shpenzuar gjithsej 7.450.000 euro. Po ashtu, në paga dhe mëditje nga ky buxhet janë shpenzuar 3.850.000, në mallra dhe shërbime 1.119.000, shpenzime komunale 255.542, subvencione dhe transfere 4.000 dhe në shpenzime kapitale 2.220.000.

Gjithashtu, në Ministrinë e Forcës dhe Sigurisë së Kosovës janë përfituar edhe donacione nga Fondi i mirëbesimit, nga shtetet tjera në vlerë prej 21.377.000 euro.

Nga këto donacione të fituara nga shtetet e tjera, po i përmendi disa prej tyre. Nga ajo që nënkupton nga Fondi i mirëbesimit kemi pasur gjithsej 6.047.000 euro për infrastrukturë, 4.232.000 euro, kurse për pajisje kemi pasur 1.815.000 euro.

Nga donacionet e përfituara nga shtetet tjera po përmendi donacionin nga Finlanda prej 130.000 euro, donacionin nga Gjermania në vlerë prej 11.980.000 euro, dhe donacion nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vlerë prej 3.220.000 euro. Kështu që shpenzimet e përgjithshme në Ministrinë e Forcës së Sigurisë për vitin 2009 janë këto:

- Shpenzimet nga buxheti 13.878.000 euro,
- Shpenzimet nga Zyra e koordinatorit të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës 7.450.000 euro, dhe
- Shpenzimet nga donatorët 21.377.000 euro.

Dhe, kjo i bie që në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës gjithsej kemi pasur një buxhet të shpenzuar prej 42 milionë e 706 mijë euro.

Duke pasur parasysh se kemi pasur një buxhet prej 21 milionë e pak më tepër si buxhet të Republikës së Kosovës dhe kemi pasur një shpenzim prej 42 milionë euro, nënkupton se asnjë projekt kapital i cili ka qenë i planifikuar nuk ka ngelur i përealizuar, falë donacioneve, falë përkrahjes ndërkombëtare që kemi pasur dhe këtu janë kursyer dhe mund të thuhet kanë mbetur të pashpenzuara rreth 7 milionë euro nga ato që kemi planifikuar në Ministri.

Këto kanë një shpjegim të veçantë ndoshta. Ne e dimë që është mirë të planifikohet dhe shpenzohet buxheti 100%, por në situatën që ndodhet Ministria e Forcës së Sigurisë kemi qenë të orientuar në mbledhjen e donacioneve dhe përkrahjes ndërkombëtare më tepër, sepse në krizën globale është e mundur që të mos përfitojmë në vitin 2011 ato që i kemi pasur deri më tani.

Prandaj, nuk kemi mbetur prapa në realizimin e projekteve kapitale, kemi realizuar plotësisht ato që i kemi pasur si objektivë, kemi kursyer në shërbime dhe mallra, kemi kursyer në shpenzimet komunale dhe mbi të gjitha duhet ta falënderoj deputetin që ka ngritur çështjen e avancave të pambyllura, të cilat duket se janë të evidentuara edhe në Ministrinë e Forcës së Sigurisë.

Për sqarim, një pjesë e këtyre avancave të pambyllura në Ministrinë e Forcës së Sigurisë, ka ndodhur në fundin e vitit 2009, sepse ne kemi shumë oficerë dhe ushtarë që shkojnë në trajnime jashtë vendit dhe kthimi i tyre në vend ka qenë në kohën kur ka qenë e pamundur të mbyllet këto avance, prandaj këto kanë ndodhur në periudhën ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka për të sqaruar lidhur me debatin aq sa mundet, ministri i financave, zoti Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj singërisht për kontributin e secilit prej jush. Unë jam shumë i sigurt që edhe vërejtjet që u dhanë, të paktën ato që janë qëllimmira, kontribuojnë në përmirësimin e përhershëm që është synim ynë i të gjithëve, në përmirësimin e raportit, në përmirësimin e situatës në Kosovë dhe në ngritjen e cilësisë jo vetëm raportimeve, por edhe të shpenzimeve së parashë publike.

Unë dy- tri gjëra, unë i kam evidentuar për secilin deputet çfarë ka thënë, ku është bazuar dhe kam përgjigje, për të mos nxitur mbase debat, nuk do të përmend emra, por çështjet ... që do t'i theksoj, i kam grupuar në disa elemente dhe më lejoni që të jap disa sqarime.

Nën një, dua t'ju siguroj se të dhënat absolutisht janë të sakta ashtu siç janë prezantuar në Thesar, ashtu siç janë evidentuar nëpër njësitë buxhetore. Këtë si ministër i Ekonomisë dhe Financave mund t'ju siguroj, sepse kam besim të plotë në stafin tim dhe në drejtorin e Thesarit dhe profesionalizmin e tij.

Nën dy, mund t'ju siguroj se të gjitha të dhënat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar. Atyre që vënë dyshim në këtë do t'iu kisha lutur të përcjellin ndonjë trajnim, mbase kanë mbetur me të kaluarën ose kanë probleme për t'i kuptuar avancimet e standardeve në raportimet financiare.

Dhe duke konstatuar këtë më lejoni të sqaroj tani disa nga çështjet që u ngritën.

U tha se mungon një pjesë dhe si i tillë nuk mund të aprovohet raporti, sidomos në pjesën e kapitaleve. Unë dua të them se në aneksin II të këtij raporti për vitin 2009, faqe 41, paraqiten në mënyrë përmbledhëse shpenzimet e investimeve kapitale për secilën organizatë buxhetore, prandaj nuk qëndron konstatimi se ky nuk është i kompletuar dhe do t'iu kisha lutur ata që e ngritën ta shikojnë mirë atë dhe do të binden, pa kryeneçësi, pa inat argumentet janë të forta vetë.

U ngrit një çështje që kërkon sqarim dhe dua ta sqaroj. Shpenzimet 2,4 milionë euro nga vendimet gjyqësore, mbase pjesa më e madhe e tyre është pagesë e kësaj qeverie për gabimet e qeverive të kaluara. 2,4 milionë euro janë paguar dënime për shkak se ju keni bërë gabime në vendimet dhe gjyqi, duke besuar që vendimet, gjyqi është i pavarur dhe gjyqi është i saktë, ne kemi paguar 2,4 milionë, 2,4 milionë, ndoshta nuk janë të gjitha nga qeveritë e kaluara, por shumica prej tyre janë nga qeveritë e kaluara, këtë e dini ju për të cilat po flasim. Shikoni më saktë.

Në faqen 9, u ngrit një çështje e një konfuziteti sa i përket ... Interesant është, sa herë që vijnë këtu, edhe udhëheqës të institucioneve, të këtij institucioni që unë sot e udhëheq dalin me thënie bombastike se diçka u zhdukën parat, u zhdukën 100 milionë, 200 milionë, 400 milionë, thua ti ku ta di çka u bë këtu. Nuk është fer, singërisht po ju them, dhe është antiprofesionale të konstatosh diçka që nuk ekziston. Ose e keni gabuar faqen, të nderuar kolegë dhe posaçërisht i nderuar deputet atje që e ngrite çështjen se s'po dua t'ia përmend emrin se tani ka replikë, por në paraqitjen në vitin... 187 milionë u ngrit atje, 187 milionë e 133 mijë euro. Ajo është shpjegim për vitin 2008 nuk është i buxhetit të vitit 2009 dhe në të shikoni pak më lartë shkruan shumë

qartë, janë fondet e donatorëve, të hyrat vetjake, huaja e pashfrytëzuar e KEK-ut, shuma e pa shpenzuar për servisimin e borxhit, i keni shumë të qarta dhe janë në kolonën e vitit 2008 jo të vitit 2009. Këtu ja dikush po do me konfuzion me qit popullin ja s'po di me i lexuar, po më vjen keq në qoftë se s'dini për t' i lexuar, por në qoftë se do të bëjë me popullin konfuzion...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju lutem, zgjatjani fjalën edhe pak zotit ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit zoti kryesues, shumë faleminderit!
Do të shkoj deri te disa elemente tjera që u ngritën këtu dhe do të përpiqem të jem i shkurtër.

U ngrit një çështje, e kam shkruar, më shumë zarrar, se hair, ngritja e rrogave.

(Reagim)

Në vitin 2007 kemi 208 milionë rroga, vitin 2008 kemi 228 milionë rroga dhe vitin 2009 kemi 268 milionë rroga, faktikisht fond. Unë nuk e konsideroj zarrar në qoftë se në punëtor i arsimit, në qoftë se një punëtor i shëndetësisë, në qoftë se një, kushdo qoftë, një shërbyes civil, nëse është ngritur për herë të parë në vitin 2009 në rroga që do të shkojë në ngritjen e cilësisë për performancën e matit neve kemi shkruar që t'i stimulojmë së pari në mënyrë që arsimtari mos të del me punua me karroca dhe kemi pasur një ngritje prej 47% të rrogave. Unë nuk e kuptoj këtë zarrar. Ai që e kupton zarrar, më vjen keq, a. Dhe vetëm edhe një çështje desha. Sa i përket, u ngrit prapë çështja e investimeve të letrave me vlerë dhe u kërkua nga Qeveria që të jep sqarime. Unë si ministër mund të lexoj raportet e bankës qendrore ashtu siç i lexoni edhe ju. Institucioni i Bankës Qendrore është një institucion i pavarur si ministër me ligjin ende ekzistues, drejtori i thesarit është një nga anëtarët e bordit në Bankën Qendrore dhe ju i keni aprovuar anëtarët e Bankës Qendrore. Dakord. Dhe, investimet në vitin 2005, 2006, 2007 është shumë e vërtetë që efikasiteti i investimeve përkatësisht të hyrat nga ato investime kanë qenë më të mëdha. Ju lutem për ata që i lexojnë, përcillen SNN-in, përcillen Blombergun, përcillen cilin doni nga gazetatat profesionale, interesi në bonat e Thesarit nga viti 2005 në vitin 2009 ka rënë drastikisht dhe sot në qoftë se investon në bonat e Thesarit është 0,1, kamatat për herë të parë në Angli që nga 1600 nuk ka kamata më të ulëta, e dinë ata që kanë jetuar në Angli dhe kanë studiuar. Dakord...! Kështu që...

KRYESUESI: Zoti Tali, zoti Tali, të lutem askush s'ju ka penguar në diskutim!

MINISTRI AHMET SHALA: Në qoftë se doni të bëni politikë, urdhëroni, por argumentet janë këto. Më vjen keq në qoftë se vërtet nuk dini t' i lexoni të paktën shifrat ose përcillni ekonominë globale. Unë jam i bindur që ka mundësi për me përmirësuar, por faktet janë këto. Dhe do t' ju kisha lutur që mos t' i shtrembëroni faktet dhe po e përmbylli duke konsideruar se vërejtjet që u dhanë sa u përket përmirësimit të kualitetit të shpenzimeve unë jam i sigurt që ka ndonjë gabim teknik dhe kërkoj falje në emër të ministrisë time, sepse është pjesë e jetës, i kam vërejtur edhe disa vetë, por sa i përket prezencës kualitative, përmbajtjes, saktësisë së shënimeve unë si ministër konsideroj që raporti ka një kërcim kualitativ si përgatitje, si strukturë, ndërsa shpenzimet janë ato të cilat i kanë arritur institucionet e Kosovës bashkë me juve dhe mund të them, më vjen mirë që auditori gjeneral është këtu prezent duke na dëgjuar, unë jam shumë i bindur që disa nga raportet e auditimit kanë dalë në vitin 2009 shumë më mirë se sa në vitin 2005, 2006 edhe nga ata udhëheqës që i kanë u udhëhequr vetë këtë institucion e dinë mirë, faktet janë, web-sait i auditorit gjeneral është, klikoni dhe shikoni, kështu që gjithsesi unë i

falënderoj shumë të gjithë ato këshilla qëllimmira dhe si ministër i Ekonomisë dhe Financave zotohem se do t'i inkorporoj të gjitha në raportet e ardhshme në mënyrë që ju dhe u tha nga disa njerëz që marrin vesh në raportet, raporti është shumë më cilësor se sa në vitet e kaluara, jep elemente krahasuese, jep elemente zbërthyes më të lehta për opinionin dhe periudhën për t'i lexuar. Shumë faleminderit dhe shihemi në seancat tjera.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Tani sipas radhës kemi votimin e raportit. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim, votojmë tani:

Në sallë janë 62 deputetë, kemi kuorum për të votuar.

Faleminderit! “Për” kanë votuar 44 deputetë, “kundër” 9 dhe 3 abstenime. A ka ndonjë pa kartelë? Nuk ka!

Konstatohet se miratohet Raporti financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2009

Komisioni funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandimet për shqyrtim dhe miratim.

Sipas radhës së diskutuesve fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional, zoti Haki Shatri apo raportuesi i Komisionit, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po e shfrytëzoj rastin të them që në sallë janë më pak se 60 vetë që votuan. Ju lutem! Megjithatë...

KRYESUESI: Më fal, sepse e the një të pavërtetë!

HAKI SHATRI: Jo s'e thashë të pavërtetë, por e thash të vërtetën. Numëroi!

KRYESUESI: Unë nga regjia, tash po, kanë dalë pas votimi. 62 vetë i ka sjellë regjia, unë nuk jam numëruar këtu.

HAKI SHATRI: Nuk ka ndodhur ajo vjet, por para dy minutave. E po, të lutem! Janë kartelat, ka njerëz këtu.

KRYESUESI: Dhe kanë votuar, e drejta nuk është e përcaktuar me Rregullore me votua secili. Në sallë kanë qenë 62 deputetë.

HAKI SHATRI: Po, por janë kartelat pa njerëz. Në rregull, veç le ta konstatojmë se s'janë qysh the ti.

KRYESUESI: Vazhdo, zoti deputet! Në qoftë se do të ishin 60 unë nuk do ta lejoja votimin, zoti deputet!

HAKI SHATRI: Nuk janë, o njeri, s'janë!

KRYESUESI: Tani s'janë, por më parë ishin! Vazhdo, në rregull!

HAKI SHATRI: Faleminderit! Tash për pikën e radhës, e shohim, mund të verifikohet kjo me elektronikë, nuk është problem.

Themelimi, kompetencat dhe obligimet e Auditorit të Përgjithshëm janë të përcaktuara me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm. Raportimi për punën vjetore të këtij institucioni të pavarur është obligim ligjor. Ky është raporti i dytë pas atij të vitit të kaluar që na paraqet Auditori i Përgjithshëm. Raporti i performancës së auditorit të përgjithshëm për vitin 2009 sipas rregulloreve përfshin sezonin e auditimit që quhet sezon i auditimit dhe fillon nga shtatori i vitit 2008 deri në shtator 2009, pastaj sezoni i ri fillon po ashtu në shtator deri në shtatorin e vitit vijues.

Raporti është përpiluar në pajtim me rregullat e raportimit, pra standardet e raportimit dhe auditimit intosai që quhen dhe është shpërndarë me kohë, sipas përcaktimeve të ligjit.

Treguesit e rezultatit të punës së Auditorit të Përgjithshëm pasqyrohen përmes rritjes së numrit të auditiveve nga 26 në sezonin e kaluar në 71, në se zonin raportues. Po ashtu, mbulueshmëria e auditimit është rritur dhe sillet 80% të shpenzimeve buxhetore dhe 95 të hyrave. Opinionet e dhëna dhe afatet kohore po ashtu janë vlerësuar. Do të donim që performanca e auditorit të përgjithshëm të avancojë dhe mos të ndodhë që për një organizatë buxhetore raporti i Auditorit të Përgjithshëm të ketë opinione të pakualifikuara që janë pozitive, e në anën tjetër të jenë objekt hetimi i organeve të drejtësisë për keqpërdorime, apo organizatat buxhetore të cilat përkundër vendimeve të Kuvendit shpallin tender dhe financojnë projekte me pronësi të padefinuara, kurse Auditori i Përgjithshëm me rastin e auditimit nuk i sheh dhe nuk i raporton në raportet vjetore.

Mendojmë që do të jetë mirë që stafi, auditorët duhet të lirohen krejtësisht nga ndikimet jo principiele dhe politike dhe ta kryejnë punën e vet si auditor të pavarur dhe profesionistë.

Është inkurajuese se Auditori Gjeneral, pas vendimeve të vitit të kaluar ka rekrutuar edhe 30 auditorë të rinj dhe të cilët po vazhdon t'i aftësojë dhe tani shpresojmë që numri i auditorëve i afrohet numri të nevojshëm për të kryer punën e vet auditori, ashtu siç është paraparë me ligj.

Auditori i përgjithshëm është i rëndësishëm së veçantë për vendin tonë, prandaj Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave është i mendimit që ky institucion duhet të mbetet financiarisht, të mbështetet me vëllimin dhe me mënyrën që garanton pavarësinë e plotë në ndikimin e punës së tij dhe po ashtu t'i krijohen kushte për vendosje në hapësira pune të mjaftueshme. Është e njohur loja me vendosjen e këtij institucioni në hapësirat qeveritare dhe mungesa e buxhetit për të paguar qiranë e këtij viti, pra deri në mesin e vitit auditori gjeneral do të mbetet pa hapësira dhe pa buxhet për të paguar qiranë. Është një lloj presioni politik mbi auditorin e përgjithshëm.

Shpresojmë që më në fund do të mbyllet odisiada rreth auditimit të Auditorit të Përgjithshëm dhe do të krijohen kushte për diskutimin edhe të arsyeve financiare të bashkëngjitura këtij raporti.

Me qëllim që Auditori i Përgjithshëm t'i përmbushë obligimet e veta ligjore për auditimin edhe të ndërmarrjeve publike, kërkojmë që menjëherë të iniciohet procedura e ndryshimit të Ligjit për ndërmarrjet publike në kapitullin që ka të bëjë me auditimin e tyre.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave kërkon që ky raport të aprovohet së bashku me rekomandimet për mbështetje institucionale Auditorit të Përgjithshëm dhe ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike. Presim që në shtator të kemi raportin gjithëpërfshirës të buxhetit 2009 të Auditorit të Përgjithshëm dhe raportet individuale të organizatave buxhetore për vitin 2009, me ç'rast do të kemi pasqyrë të ekonomisë, efikasitetit dhe ligjshmërisë së shpenzimit të parash publike në vitin e kaluar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryetar i komisionit. Sipas renditjes pyes kryetarët e komisioneve të tjera a e kërkojnë fjalën? Nuk ka në emër të komisioneve asnjë. Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e performancës për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm dhe me rastin e shqyrtimit ka konstatuar se Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, për herë të parë, domethënë edhe pse është raporti i dytë, e bie me kohë dhe në konform legjislacionit në fuqi, konform Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe kjo duhet të respektohet, sepse herëve tjera ka qenë e pamundur që raporti të vijë me kohë.

Në tërësi Auditori i Përgjithshëm në Kosovë ka kryer 58 auditime të detyrueshme të rregullsisë, duke përfshirë edhe Raportin e buxhetit të Kosovës. Nga ky aspekt shihet se janë rritur në mënyrë të konsiderueshme auditimet e kontraktuara dhe kjo nënkupton që për çdo ditë po kuptohet drejt që edhe auditimet e kontraktuara e kanë efektin e tyre pozitiv dhe ndikojnë pozitivisht që auditimet në Kosovë të jenë të rregullta. Ndoshta, një herë e përgjithmonë edhe ne edhe të gjithë të tjerët që po na dëgjojnë duhet të marrim guximin që të pranojmë si reale dhe t'i pranojmë si të vërteta dhe së paku të kemi besim në raportet që na vijnë nga këto institucione të cilat i kemi zgjedhur vetë dhe ua kemi dhënë besimin.

Prandaj, mos t' i besojmë performancës, të mos iu besojmë raporteve të auditorit të përgjithshëm, unë e konsideroj që me të vërtetë është diçka jo e mirë, jo e qëndrueshme dhe jo reale.

Në anën tjetër, në këtë vit, nga raporti që e kemi para vetes kemi parë se ka auditime të kontraktuara edhe nga jashtë dhe nëse e shohim në përgjithësi diku kanë qenë 31 auditime që janë bërë nga dy kompani dhe natyrisht që këto auditime e kanë pasur edhe koston financiare që ka qenë diku përafërsisht 150 mijë euro, prandaj edhe kjo performancë ne konsiderojmë që është pozitive, sepse iu ka dhënë mundësia që edhe organizatat të cilat janë të specializuara për auditim, ta bëjnë auditimin dhe të dalin me raporte publike të cilat mandej i kemi ne këtu në raport para vetes. Vlen të përmendet se auditimet në të gjitha organizatat e adresuara në buxhetin e Kosovës kanë mbuluar diku 80% të shpenzimeve të përgjithshme dhe 90% të hyrave, prandaj në aspektin e përgjithshëm mund të dalim me konkludim se performanca e auditorit të përgjithshëm ka qenë e bazuar në standardet bazike të auditimit që janë të njohura edhe në vendet me traditë për auditimin, por edhe të njohura në bazë të standardeve evropiane.

Vlen të përmendet një fakt i cili ndoshta në të ardhmen duhet të kihet kujdes. Entitetet e audituara më herët nuk kanë arritur t'i zbatojnë rekomandimet të cilat apo këshillat të cilat kanë dalë nga auditori. Janë zbatuar një pjesë e tyre, mirëpo megjithatë ka mbetur edhe një pjesë e

pazbatuar, domethënë nuk kanë sjell një gatishmëri që këshillat e auditorit të përgjithshëm të zbatohen të gjitha, prandaj në të ardhmen sugjerojmë që entitetet të cilat auditohen dhe rekomandimet që dalin nga auditori duhet të zbatohen sepse ato janë në të mirë të organizatave të tyre buxhetore dhe në të mirë të institucioneve në Kosovë.

Fakti tjetër që konsiderojmë që performanca e auditorit të përgjithshëm duhet të respektohet është nga vetë fakti që buxheti për vitin 2009 nga auditori është shfrytëzuar në një masë shumë më të mirë, domethënë 88.9% në krahasim me vitin 2008, që ka qenë 71% dhe ju e dini që ka qenë një prej faktorëve që buxheti i vitit 2009 për auditorin ka qenë më i vogël nga arsyeja, sepse në vitin e kaluar nuk e kanë shfrytëzuar buxhetin dhe mos shfrytëzimi i buxhetit ka ndikuar ndoshta negativisht që edhe performanca e auditorit të jetë pozitive në shumë sfera të auditimit.

Një aspekt pozitiv të cilin Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e konsideron për Zyrën e Auditorit është edhe bashkëpunimi me mekanizmat apo me ekspertët e fushave të ndryshme që vijnë për auditimin nga shtetet më demokratike duke filluar nga: Britania e Madhe, Holanda, Sllovenia dhe natyrisht praktikrat e mira të cilat i kanë këto vende, i ka marrë edhe auditori jonë dhe shpresoj që performanca në vitet e ardhshme do të jetë më e mirë se në këtë vit. Dhe krejt në fund konsiderojmë edhe auditorët të cilët po punojnë në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, mandej edhe stafi mbështetës nga raporti shihet se kanë një përgatitje profesionale e cila garanton që raportet e auditorit edhe në të ardhmen do të jenë me një performancë të dëshirueshme dhe në të ardhmen konsiderojmë që edhe performanca në vitin 2010 do të jetë në interes jo vetëm për institucionet në Kosovë, por edhe për vetë institucionin e auditorit të përgjithshëm do të jetë shumë më e respektuar nëse respektohet përgatitja profesionale e auditorëve dhe nëse ruhen nga ndikimet politike.

Në fund Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet raportin dhe me dëshirën më të madhe i jep mbështetje auditorit të përgjithshëm që në të ardhmen të punojë dhe sjellë raportet siç ka bërë edhe deri më tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Përpara kemi një raport që për herë të parë e trajtojmë, është raporti i performancës i cili paraqet aktivitetet dhe të arriturat e Zyrës së Auditorit Gjeneral. Ndoshta, për ne si deputetë do të ishte më interesant të kemi edhe kërkesat e këtij institucioni në kuptimin e asaj që të njoftohen deputetët për nevojat e këtij institucioni që të jetë një institucion i respektuar, një institucion i pavarur, një institucion për të cilin Kuvendi i Kosovës ishte dashur të përkujdeset me një seriozitet më të madh, sidomos në plotësimin e kushteve për të mund Zyra e Auditorit Gjeneral të kryejë funksionin e vet.

Nuk mund të përdorim këtu sikur të raporti i shpenzimit të financave me atë metodën e krahasimit për arsye se nuk do të ishte e drejtë, sepse ky raport duhet shikuar në një analizë më të thellë se sa që do të ishte metoda e krahasimit prej vitit në vit. Edhe që nuk është e obliguar të bëhet auditimi i performancës, megjithatë kemi dy auditime të performancës, që janë trajtuar edhe në Komisionin për Mbikëqyrje të Shpenzimeve Publike, thjesht është fjala për performancën e auditimit që është bërë për listën esenciale të barnave dhe për skemën pensionale dhe për personat me aftësi të kufizuara.

Konsideroj që Kuvendi i Kosovës duhet të ketë një qasje më serioze Komisionit, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e raporteve të audituara që është Komisioni për Mbikëqyrje Financiare dhe që

mund të them si anëtar i këtij komisioni vetëm falë angazhimit të kryetarit të këtij komisioni është duke qëndruar, mirëpo mungon ajo mbështetja e qëndrueshme e Kuvendit që një komision aq i rëndësishëm të kryejë funksionet e veta për të cilat edhe është themeluar.

Konsideroj se ky raport është i mirë vetëm sa për të marrë informacione për aktivitetet dhe përgjegjësitë e auditorit të përgjithshëm për arsye se atë që e thash në fillim këtu nuk kemi mundësi të shqyrtojmë cilat janë nevojat e mëtutjeshme për këtë institucion, mirëpo ajo që është dashur të jetë esenciale është dashur që politika të jetë sa më larg të institucionit.

Ne kemi pas auditime kur edhe si deputet edhe si komision kemi qenë mjaft të shqetësuar nga frika që mos do të na dalë nga dora ky institucion dhe do të jetë nën ndikimin e personave me ndikime politike dhe kjo ka ndodhë një herë me auditimin që është bërë Radiotelevizionit të Kosovës.

Duke mos dëshiruar që të kemi përsëri raste të ngjashme dhe jemi në pritje të auditimit të përgjithshëm të buxhetit të konsoliduar të Kosovës konsideroj që duhet përkrahur maksimalisht këtë institucion duke i dhënë përkrahje që të jetë në aspektin profesional shumë i pavarur dhe të jemi në gjendje që ta ngrisin në këmbë të qëndrueshme edhe në aspektin profesional, të jetë një institucion që duhet ta ketë tretmanin e një institucioni serioz dhe për këtë konsideroj që Kuvendi i Kosovës është përgjegjësi kryesor.

Auditori gjeneral, zoti Ollafson me këtë performancë që na e ka pru para neve, ka paraqitur seriozitetin e një menaxheri, një udhëheqësi të këtij sektori shumë të ndeshëm, kemi besimin në ta por shpresoj se Kuvendi duhet ta mbështetë maksimalisht që të jetë në funksion të zhvillimeve pozitive në përgjithësi në Kosovë.

Atë që e ngriti kryetari i Komisionit zotëri Shatri që ka të bëjë me mospërputhjen e auditiveve dhe gjendjes faktike në menaxhim në institucionet e Qeverisë së Kosovës është shqetësuese, ndoshta është mungesë e ligjit për të treguar cila është forca ekzekutive e auditorit, ne kemi parasysh që një kopje i shkon prokurorit, mirëpo në performancën e paraqitur ne nuk kemi asnjë rast kur është ngritur ndonjë çështje dhe ka rezultuar me propozimet me të gjeturat që është sanksionuar ndonjë institucion apo individ për keqpërdorim apo menaxhim të paautorizuar të mjeteve financiare.

Në përgjithësi Grupi Parlamentar i LDK-ës do ta përkrah këtë performancë edhe që them se nuk është e obligueshme që të trajtohet në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së nuk është paraqitur askush. E ka kryer dhe llogaritet që e ka kryer deputeti Shatri. Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së deputeti Riza Smaka është paraqitur.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

I nderuar ministër, Mujota,

Deputetë të respektuar,

Fillimisht të theksoj se Aleanca Kosova e Re e mbështet Auditorin Gjeneral, Zyrën dhe angazhohet që ta ketë një pozicion krejtësisht të pavarur dhe një akomodim adekuat, në mënyrë që ta ushtrojë funksionin e tij auditori, të saj të Zyrës në mënyrë kompetente. Po në këtë kontekst disa konkludime, po ndër tjera synime themelore të Auditorit të Përgjithshëm janë siguri i shfrytëzimit të drejtë konform me parimin e ekonomisë, të efikasitetit dhe të efektivitetit, tri e-e-e. Siguri i menaxhimit të financave publike në funksion të destinimeve të objektivave të

definuara dhe të specifikuara që më parë, sigurimi i promovimit afirmativ të standardeve optimale të transparencës, përgjegjësisë dhe të integritetit në menaxhimin financiar dhe në performancën e administratës publike. Ndërkaq, nga vetë ky raport vjetor i performancës së auditorit gjeneral për vitin 2009 po këto objektiva nuk janë performuar sa e si duhet. Rrjedhimisht, së paku deri sot konform me Kushtetutën dhe me Ligjin për auditimin gjeneral, nuk është bërë auditimi i auditorit gjeneral, i Zyrës së auditorit gjeneral. Tash s'po hyjmë në ato pse nuk është bërë, nuk është bërë. Unë jam në rrjedha por nuk po e shoh të rrugës për të thënë këtu.

Po ashtu, sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike Auditori Gjeneral do të duhej ta kishte, a nuk e ka, një auditor intern për revizionimin e menaxhimeve administrative. Nuk ka raport së paku. Thuhet se është siguruar po nuk është, nuk ka raport.

Deri sot nuk është audituar Trusti Pensional i Kursimeve, posta, KEK-u, Aeroporti. Mediat e sotme zotëri kryesues shkruajnë varg e vi se ndër të tjera, po e zëmë posta nuk i përfill rekomandimet e Qeverisë referuar pagave dhe kompensimeve të bordistëve, a nuk është audituar. Në qoftë se do të kishte pas eventualisht pengesa ligjore ishte dashtë që në këtë raport të ishin disa propozime se çfarë do të duhej bërë, çfarë ndryshimi do të duhej bërë në mënyrë që së paku në aspektin legal të mos ketë, eventualisht t'i quajmë që nuk ka pengesa. Në raportin vjetor të performancës të Auditorit Gjeneral për vitin 2009 ndër të tjera ngritët problemi i Zyrës së Auditorit Gjeneral për akomodim. Aktualisht, ju lutem, të nderuar, paguhen 17.000 rentë mujore për ato zyre të cilat i kemi problematizuar edhe më parë a ndër kohë kërkohet akomodim adekuat e tjera, e tjera, është çështje pak për meditim.

Edhe ky problem duke, edhe ky problem duhet të zgjidhet shpejt e mirë në funksion tani të parimit të ekonomisë. Raporti teknikisht është përgatitur mirë, në letër cilësore, por nuk përmban konkluzione kritike me masat për zgjidhjen efikase, eficiente të rasteve deficiente. Në parim siç e thash edhe në fillim e mbështesim këtë raport me aludim që do të duhej të bëhej më mirë sa i përket edhe më i precizuar dhe më konciz sa i përket vërejtjeve që i shtruum këtu. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së nuk është paraqitur askush. Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati. Paraqituni, ju lutem, se pastaj po thoni...!

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Dozvolite da pozdravim minsitra Mujotu i kolege!

Mi smo takođe zadovoljni da smo u prilici da po prvi puta vidimo godišnji izveštaj koji je urađen, kako su i kolege navele, nezavisno i od lica koje je međunarodni predstavnik, tako da smatramo da je ova dobra praksa, slažemo se sa kolegama da možda ima određenih primedaba kada su u pitanju neki detalji i tako dalje, međutim mi ovo smatramo boljim nego što je to do sada bilo, nadajući se da će u buduće ovaj nezavisni, ja bih rekao ova nezavisna institucija još profesionalnije i detaljnije da se bavi ovom važnom problematikom.

Mi, kao Parlamentarna grupa, podržavamo ovaj izveštaj i preporučujemo ga da se on usvoji. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar SLS, deputeti Mursel Halili.

MURSELJ HALJILJI: Gospodine predsjedavajući,

Uvaženi gospodine ministre,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala ovaj izveštaj o radu kancelarije Generalnog revizora za 2009. godinu i smatra da je pozitivan i mi ćemo iz tog razloga i prihvatiti izveštaj, međutim slažemo se sa navodima funkcionalne komisije da je kompletni izveštaj mogao da bude u slučaju kada bi i javna preduzeća mogla biti obuhvaćena ovim izveštajem i smatramo da je neminovno potrebno da se izvrši izmena Zakona o javnim preduzećima, u delu revizije, jer sama institucija Generalni revizor trebalo bi da vrši reviziju svih subjekata, a u ovom slučaju to nije bio slučaj.

Prema tome, mi ćemo podržati ovaj godišnji Izveštaj o radu Generalnog revizora. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

I mi smo kao Grupa za integraciju pažljivo razmatrali Izveštaj Generalnog revizora. Smatramo da je tehnički dobar, da ima performansu knjigovodstvenu i vidimo da ista ta kancelarija Generalnog revizora ima 116 zaposlenih osoblja, da je imala budžet od 1 milion i 106 hiljada evra i da je praktično mogla da funkcioniše u svojoj delatnosti. Veliku zamerku imamo kada je u pitanju ova kancelarija, u ovom izveštaju se mnogo bavi sa sobom, sa svojom strukturom, međutim nije se bavila sa delatnošću koja je namenska, nije vršila reviziju, smatramo, u onim segmentima kada su u pitanju javna preduzeća, javne institucije od same skupštine, od centralnog do opštinskog nivoa, nije se aktivno bavila sa terenom. Ovo kažemo iz razloga da Generalni revizor i ova kancelarija ne postoje zbog sebe, nego postoje zbog tržišta koje imamo i zbog subjekata na tržištu. Nema adekvatnu analizu kada su u pitanju ovi segmenti tržišta gde bi mi mogli da budemo informisani o jednom aspektu sa tog tržišta, gde bi mogli kao Skupština da budemo funkcionalni da razmatramo... Nema, na primer, onu moć kao nezavisan organ, nigde ne vidimo da je pokrenula neki, da kažem, postupak, istražni postupak što je u delokrugu te kancelarije i Generalnog revizora. Znači, mora da postoji koordinacija i organizacija posla kada je u pitanju ova kancelarija, da je nezavisna, da namenski postoji zbog nadgledanja. I jedno što je jako bitno i što je našu pažnju posebno zainteresovalo, to je na primer tabela 10 kada je u pitanju struktura zaposlenih. Kada su u pitanju zajednice, što moram da dam do znanja, gde sama kancelarija daje do znanja da je od 116 zaposlenih samo 4 osobe iz srpske zajednice i 1 osoba iz ostalih, što znači 5 u odnosu na 116. Kada to procentualno izrazimo, to nije ni 2,9%, i ako znamo zbog balansa i zaposlenosti, u Zakonu za zaposlenje manjina mora da postoji jedan balans najmanje od 10%. Ovo dajem do znanja da bi svaka institucija na Kosovu funkcionisala, mi moramo početi od institucija skupštinskih, opštinskih sve do lokalnih nivoa kada je u pitanju zapošljavanje i zbog balansa i zbog kvaliteta posla u svim segmentima ovde na Kosovu. Ovo dajem iz jednog jako važnog razloga. Mi moramo strukturalno da se raspoređujemo, kvalitetno, obrazovno, gde ova institucija daje do znanja da ima kvalitetne kadrove, kao što je imala obuku kadrova kada su u pitanju tehničari računovodstva, sertifikovane računovođe i sertifikovani revizori. Ovde apelujem da kada je u pitanju ova kancelaria, mora da se vodi računa ne samo struktura zapošljavanja kada su u pitanju zajednice, nego i kada je u pitanju obrazovanje i kvalitet, pošto sam sama ekonomista, mora da postoji jako, jako, da kažem interesovanje za dobar kadar, koji može da nadgleda i kontroliše sve institucije da bi stvorili jedno zdravo ekonomsko društvo.

Naša će grupa da podrži ovaj izveštaj i ove smo primedbe dali sa namerom da se malo više potegne ovo pitanje pregleda revizije na terenu od, ja kažem od skupštinskih do opštinskih struktura. Jedino što hoću ponovo da ukažem, jeste i da se revizija bavi i sa štednjom i tamo gde

su budžeti trošeni sa budžetskim linijama, sa kontrolom, sa segmentima koje velike mogućnosti ima ova kancelarija da obavlja.

Nadamo se da će kancelarija i svake godine da bude što uspješnija i povoljnija, jer to je jedina kancelarija koja može da uštedi i budžet Kosova i da ga usmeri u jednom dobrom pravcu i da onemogući zloupotrebe pojedinaca. Toliko od naše grupe, mi ćemo podržati izveštaj, ali ove segmente smo posebno naglasili da bi bili kao, da kažem, jedna naša dobrobit za dobro poslovanje. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e kanë deputetët e paraqitur. Si zakonisht, i pari Rexhep Hoti e ka fjalën.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Tamam, unë kam përshtypje se me të njohshëm kjo, se kaq shpejt s'e prita këtë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

I nderuar auditor gjeneral,

Duke ditur se misioni i Zyrës së Autorit të Përgjithshëm duhet të kontribuojë në për një menaxhim të suksesshëm financiar në administrimin publik për shfrytëzimin e drejtë dhe efikas të fondeve publike, më lejoni t'ju paraqes disa mangësi.

1. Qe dy vjet nuk është bërë auditimi në vetë institucionin përkatës, pra në ZAP. Edhe pse është obligim sipas Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, neni 6.
2. Kush e vlerëson punën e ZAP-it? Pra, metodologjinë, efikasitetin, profesionalizmin. Deri më tash askush!
3. Për auditimin e komunave të Kosovës ZAP ka kontraktuar kompani private, kurse vetë komuna e Prishtinës nuk është audituar, ku edhe pas këtyre auditiveve nuk kemi më konkluzione. Jepet arsytimi, i mungesës së prezantimit të paqartësive në lidhje me pjesët materiale te pasqyra financiare.
4. Sipas informacioneve që kam ZAP edhe pas këtyre viteve dhe investimeve të bëra ende ka nevojë për zhvillime profesionale të kapaciteteve humane.
5. Në raportin vjetor të performancës thuhet se kemi krijuar komunikim të rregullt me Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të brendshëm dhe kemi marrë pjesë në mbledhjen vjetore të drejtorëve të auditimit të brendshëm që ka qëllim zhvillimin e auditimit të sektorit publik në Kosovë, ku sipas informacioneve që kam në atë takim ka pasur plotë akuza nga ana e drejtorëve të auditimit të brendshëm për mos bashkëpunim dhe jo profesionalizim nga ana e ZAP-it dhe deklarimin nga vetë kreu i ZAP-it se ZAP-i nuk i beson raporteve të auditorëve të brendshëm.
6. Në raportin vjetor të performancës ZAP-i prezantoi, citoj: “Një mbulim të mirë të detyrimit për auditim, cilësi në përputhje me qasjen moderne për cilësinë e auditime të tjera”, kurse raporti i progresit thotë, të kundërtën, citoj: “Sistemet adekuate përcjellëse mbi auditorin e jashtëm dhe rekomandimet kanë mangësi. Në

përgjithësi ka pasur një përparim modest në këtë fushë, zhvillimin në kontrollin publik të brendshëm dhe auditorit të jashtëm, janë në fazën fillestare”.

7. Vazhdimisht në media flitet për korrupsion, andaj si ka qenë raporti i komunikimeve zyrtare ose bashkëpunimi i ZAP-it me organet kompetente në luftimin e kësaj dukurie kur dihet se ZAP-i për çdo vit ka qenë në auditim për të gjitha institucionet?

Siç dihet, sipas nenit 4.9 të Ligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së auditimit të Kosovës, citoj: “Auditori i Përgjithshëm nuk do të publikojë ose zbulojë në një raport publik çfarëdo informate të cilat janë klasifikuar me ligj informata sekrete konfidenciale”. Pra, sipas këtij ligji, neni 4.10, thotë: “Nëse në përputhje me paragrafin 9 të këtij neni, Auditori i Përgjithshëm nuk i përfshin disa informata në raport publik, atëherë Auditori i Përgjithshëm, pas kërkesës nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës duhet të përgatisë dhe t’i dorëzojë Kryesisë së Kuvendit një raport sekret i cili identifikon informatat e pa përfshira në raport si dhe jep arsyetimet për mos përfshirjen e tyre”. Pra, Kuvendi mund të kërkojë informata sekrete të klasifikuara nga Auditori i Përgjithshëm gjatë punës së tyre në institucion publik, sepse në këtë mënyrë bëjmë funksionalizimin institucional, transparent dhe efikas. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi!

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryesues!

Unë, fillimisht kisha pasur dëshirë që të ngre një çështje, një brengë timen se pse, a thua e kemi marrë këtë raport ta diskutojmë tani, është raport i vetëm një zyre, i vetëm Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Sugjerimi im do të ishte dhe ata e kanë ditur më mirë se unë, kur e kanë dorëzuar raportin më mirë kishte me qenë që t’i bashkëngjitet raporti për zbatimin e buxhetit të shtetit, ashtu siç kërkohej edhe me Kushtetutën e Kosovës, sepse Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është obligative që t’i dorëzojë Kuvendit një raport për zbatimin e buxhetit të shtetit.

Kuvendi i Kosovës me u marrë me një raport, me një organizatë buxhetore, si me një pikë e vetme e rendit të ditës, nuk po më duket edhe aq substanciale. Po e them me të drejtë, nuk jam duke e përulur institucionin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, por nuk ka shumë për çka të flitet, sepse këtu janë disa faqe që më shumë ky raport i përngjet, thuaja se është një organizatë që e ka shtypur prej ueb-faqes në ndërmarrje për prodhimin e deterxhentëve, si për shembull si duket organizata jonë nga jashtë, me disa fotografi nëpër trajnime, nuk është shumë politike. Dhe më mirë kishte me qenë me i kursyer këto para që janë përdorur për shtypjen e këtij raporti, i vetmi që ka përfituar këtu, sepse ne e kishim lexuar edhe në fletë të bardha qysh e bëjnë institucionet tjera në Kuvend që i bien raportet. I vetmi që ka mund me përfitue është shtypshkronja “Blendi”, që e ka shtypur me një peshë mjaft të madhe specifike të fletëve, se përndryshe për raportin brenda s’ki çka me diskutua për të, s’ka pas asnjë arsye.

Prandaj, raportin, i sugjeroj Auditorit të përgjithshëm që t’ia bashkëngjit këtë raport atëherë kur t’ia dorëzojë Kuvendit raportin për zbatimin e buxhetit të shtetit, sepse atje është ajo çka ne diskutojmë. Mirëpo, që diskutojmë për disa vija buxhetore të një institucioni, nuk po e shoh shumë të arsyeshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Driton Tali!

DRITON TALI: Të them të drejtën, s'desha as të flas, por veç ta plotësoj parafolësin çka tha. Me të vërtetë, të paktën duke iu referuar pasqyrës financiare këtu, faqe 4, te përshkrimi i shpenzimeve thuhet se botimet e publikimeve kanë kushtuar 10.000 euro dhe shpresoj se kjo ka kushtuar 10.000 euro për publikim. A s'paska mund zyra e nderuar të na kursejë ato 10.000 euro? Unë e respektoj entuziazmin e kësaj zyre dhe pedanterinë, por ashtu siç tha edhe parafolësi, më shumë jemi të interesuar të bisedojmë për raportin lidhur me zbatimin e buxhetit të Qeverisë, dhe këto informata me dy faqe ka mund Zyra e Auditimit të na njoftojë brenda atij farë raporti, për çka po them edhe një herë, edhe qytetarët e Kosovës janë të interesuar më shumë.

Sigurisht se ne jemi përgjegjës apo Zyra e Auditorit të Përgjithshëm na përgjigjet neve Kuvendit me Kushtetutë. Mbase një vërejtje sa i përket zyrës dhe po e shoh se udhëheqësi i kësaj zyre nga emri është skandinav. E pashë se përqindja e të punësuarve këtu nuk është bërë, po them, për një skandinav po më duket jo arsyeshëm. Pjesëmarrja e femrave është më pak se 30%. Ai duhet të paktën ne të na tregojë, neve ballkanasve, se barazia gjinore duhet të respektohet në përputhshmëri. Hiqe këtë kritikë, mendoj s'kemi çka të flasim tjetër send këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti, Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Shumë shkurt, meqë ne jemi deputetë dhe përfaqësojmë edhe zona të ndryshme, edhe qytete të ndryshme, më lejoni veç ta them një konstatim, që u tha nga një deputet këtu, e që nuk qëndron se „në komunë të Prishtinës nuk u bë auditimi”. Auditimi i vitit 2008, që është bërë për Komunën e Prishtinës është dorëzuar, kuptohet, në vitin 2009 dhe nga Raporti i Auditorit ka qenë vlerësuar se kjo komunë është më e mira prej të gjitha komunave për të gjitha pasqyrat financiare. E para.

E dyta, auditimi po ashtu është bërë në muajin mars të këtij viti, të vitit 2010, për vitin 2009. Janë dhënë vërejtjet dhe mendimet nga drejtorët dhe pritet raporti përfundimtar i Zyrës së Auditorit.

Prandaj, nuk është mirë të thuhet diçka që s'është e vërtetë, në këtë rast, për një komunë.

Po flasim për kryeqytetin dhe kemi obligim të themi si është drejt. Dhe, kush dëshiron, mund ta shoh, në ueb-faqe është edhe ky raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tjerë të paraqitur, nuk ka. Prezentë janë 61 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe të votojmë tani për ta miratuar Raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Votojmë tani:

Në sallë janë 61 deputetë.

Faleminderit! Me 55 vota “për”, 4 “abstenime”, 1 “kundër” Kuvendi miratoi Raportin e punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2009. Kaq.
Mirë u pafshim në seancat e ardhshme të Kuvendit të Kosovës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës